ISSN 1857-6443

Investimet

Shkenca në margjinat e buxhetit

Fq.4

FONDET PËR KULTURË

Ansambli shqiptar aktivizon Tanecin

Fq.5

Njukasëll shfaq interesim për Rashicën



Fq.19

www.koha.mk

Koha

Refugjatët, skllevërit modernë

Fq.13

E PËRDITSHME INFORMATIVE · Viti XII · Numri 3242 · e martë 12 dhjetor 2017 · 0°c | +6°c · 15 DEN

FORUM

Labirintet e ëndrrave të zotit Daçiç

Njohja e shtetit të pavarur të Kosovës nga Madagaskari, këto ditë u shoqërua nga deklarata e insinuata, copy-paste, sikurse është bërë zakon tashmë, të zotit Ivica Daçiç. Sikur ato të ishin të vetmet e tij, ndoshta nuk do t'u kthehesim në këtë shkrim. Është vijimësia e tyre e njohur, linja e njëjtë që ato ruajnë. Ish-ministri i djeshëm i garniturës së Millosheviçit, aktualisht zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme... Fq.10

RAJON

Haga kërkon 28 vjet burgim për Sheshelin ose rigjykim

Fq.14

GLOBI

Jerusalemi, çfarë merr në këmbim Presidenti?

Fq.15

TË HËNËN FILLOI PROCEDURA NË LEXIM TË DYTË E LIGJIT PËR GJUHËT

SHQIPJA DREJT FUNDIT

Deputetët e shumicës parlamentare - LSDM dhe BDI me shumicë votash miratuan Rendin e ditës me pikën e vetme - miratimin e Ligjit për gjuhët, me çka filloi të rrjedhë afati treditor për debat në komisionin amë, në këtë rast në Komisionin për çështje evropiane

Fq.3

Frikë gjithandej, qentë endacak s'ka kush i ndalë

Shkup, 11 dhjetor - Banorët e Çairit dhe rrethinës frikësohen nga sulmet eventuale të qenve endacak. Ngjarjet e fundit, të cilët u regjistruan nëpër lagje dhe komuna të ndryshme brenda qytetit të Shkupit, kanë ngjallur reagime edhe nga banorët e Komunës së Çairit. Vërejtjet më të shpeshta të cilat mund t'i hasësh nëpër rrjetet sociale, por edhe përmes njoftimeve që kanë arritur deri te redaksia jonë, kanë të bëjnë me prezencën e madhe të qenve endacak përreth institucioneve edukativo-arsimore. Tufat e qenve endacak, njëkohësisht paraqesin rrezik edhe për kalimtarët e rastit. Me këtë situatës, siç mund të lexohet nëpër rrjetet sociale, më së shpeshti ballafaqohen ata qytetarë, të cilëve orari i punës ju fillon në orët e para të mëngjesit. Përkundër faktit se problemi me qentë endacak është riakutalizuar ditëve.... Fq.7

NË FOKUS

EUROPA DHE NE TË TJERËT

Branko MERXHANI

Koha jonë, kohë pleonasmash dhe produksioni të tepër, është mbushur edhe nga Profetë, që profetizojnë "Fundin e Evropës". Vallë? Kaq shpejt? Po kur u-plak dhe po jep shpirtin djali i djeshmë? Gjurmat e para të jetës së saj nuk e kapërcejnë shekullin XII. Po dita e vërtetë e lindjes së saj është më e afërme. Mund të na e kallëzojë edhe fantAzia më e varfër e brezit më të parë. Besimi i "Perëndisë-Njeri" që erdhi dhe iku si ndonjë "VISION" këtu e njëzet shekuj më parë, po mbretëron akoma edhe sot. Bizanti, ky emër mizor dhe për të qarë, qëndroi më se njëmijë vjet. Vetëm hija e tij rrojti pesë shekuj. Po Evropa? Mbaroi? E rreme! Në rrezat e Uraleve po gjëmon zëri i saj. Shpirti i saj sapo arriti në fushat mëkatare të Azis së harruar. Evropa hyri në Azi këtu e një shekull e gjysmë më parë. Tani që ikën, që ecën praptazi, tani pikërisht hyn në 'të. Evropa u-fut thellë në kryet, në gjakun, në shpirtin e robërvet të saj të djeshmë. Atje ku ata hynë horizonti ndroi menjëherë. Në stepat e thata pa an'e krye po mbijnë pemë që shtien hije aq sa qielli i kaltërt i vendit të prallës dhe të ëndërës po mbushet me tym të zi, që lëshon një Perëndi e re: MAQINA.

Një shekull e gjysmë Azia plakë, ky djep i feve dhe i Theokrative, po lozte me shakat e saj. Dora e saj, e hollë dhe sentimentale po shkruante vjersha dhe bënte lodra. Nuk deshi të ndrojë me fuqin e Maqinës. Trembesh nga armët më të mbaruara dhe nga dituria më e lartë e zaptonjësit si nga ndonjë mëkatë. Kërkoi shpëtimin e saj nga mohimi i duruar dhe i pambaruar i Theokratisë. Atje brenda e kishte burgosur shpirtin e saj. Po turpi i saj mbeti jashtë. Kështu, duke fshehur shpirtin dhe duke lënë jashtë trupin, pandehte se do të shpëtonte. Shpëtoi sa mund të shpëtojë edhe ai zog i varfër që fsheh vetëm kryet brenda në rërë që të shpëtojë nga plumbat e gjahtarit!... Shtrenjt e pagoi Azia verbërinë e saj. U bë skllave. Njëqind e pesëdhjetë vjet shkuan sa të zgjohet Azia. Ballët e saj i ndriti tej-për-tej nga një flakë e bardhë. Pasioni i saj është pa fre, i egër, hakmarrës. Po Theokratët u-vogëluan. Tashmë ajo kërkojn Maqinën, beson Maqinën - me atë dashuri, me atë pasion që besonte gjer dje hallet e saj të mëndafshta dhe vazot e saj t'ergjenta. Merr pastaj maqinismën idololatrike dhe e shkrin mirë-e-mirë brenda në flakën e të dhëmburavet të saj njëqind e pesëdhjetë vjet me rradhë. Ka edhe ajo nostalgji për Qytetërimin dhe për Teknikën e madhe të sotme, jo vetëm me syrin e dobisë, po sidomos me vendimin e çlirimit kombëtar. Në Rusi, në Turqi, në Persi, në Hind, po zien nostalgjia e shpëtimit të Aziarit. Azia vjen në vete - për hir të Evropës.

"EVROAZIA" bredhëse e Trubeckoj-it, kjo copë dhe në mes të Evropës dhe Azisë, ç'bëhet? - Popujt e saj po marin frymë thellë. Demokratitë e saj po shtohen. Është shenjë që edhe ata hynë në periodën e zierjes së brëndëshme. Karta shoqërore dhe ekonomike e popujve të vegjël të ndryshme, që nga ujërat e shqetësuara të Egjeut gjer në buzëdetin e vërtetë të Filandisë, po sillte gjer dje të nxirat e një rënieje të heshtur. Mirëpo arritën në periodën më karakteristike të mundimeve të tyre të gjata: në periodën e REALITETEVET KOMBËTARE. - Të huajt u-hoqën pothuaj vetë, pasi humbën robet e tyre të verbër. Po djemt e robërvet, të ritur në pikëllim dhe në mizori, përpiqen të ngulin flamurin e jetës së re mbi gërmadhat e errëta të kullës së neveritur. Sepse besojnë në dynamismën dhe në produktivitetin e popujve të tyre. Evropa na zbrazi xhepin, po na mbushi shpirtin. *(Botuar në vitin 1934)*

27-VJETORI I PARTISË DEMOKRATIKE

"Sot 27 vite më parë lindi Partia Demokratike, forca që ndryshoi Shqipërinë dhe jetët e miliona shqiptarëve një herë e përgjithmonë, forca që i priu shembjes së diktaturës komuniste, dhe rrugëtimit tonë drejt Evropës dhe zhvillimit. Me respekt dhe mirënjohje të thellë për themeluesit, për qëndrestarët dhe për të gjithë mbështetësit, militantët dhe anëtarët e Partisë Demokratike ju ftoj të mblidhemi bashkë në Pallatin e Kongreseve në shenjë nderimi por edhe përgjegjësie për atë që kemi përpara: Përmbushjen e idealeve tona për liri, demokraci dhe mirëqenie për të gjithë shqiptarët", shkruan në profilin e tij në FB, kryetari i PD-së, Lulzim Basha.

TË MBYLLUR SI KAFSHË NË KAFAZ

"Dy milionë qytetarë të mbyllur si kafshë në kafaz për shkak të inateve politike, ose për shkak se, ndonëse nisur nga qëllimi fisnik - kanë mundur të bien në lajthitje. Por hipokrizia më e madhe në këtë mes është se disa nga këta që po bëjnë lojëra politike me këtë punë nuk e kanë problem lirinë e lëvizjes - i kanë siguruar pasaportat për vete e për familje, ose të Shqipërisë, ose të Norvegjisë, ose të Britanisë, ose të Zvicrës... Qytetarët do të kishin arsye të besonin në sinqeritetin e tyre nëse të njëjtit do të dilnin publikisht dhe t'i shqyenin pasaportat e shteteve të tjera dhe ta mbanin vetëm pasaportën kosovare, si shenjë solidarizimi e bashkëvuajtjeje me qytetarët, të cilëve po thonë se iu shërbejnë. Të urojmë që përfundimisht edhe një herë ndër shqiptarët të mbisundojnë arsyeja e vizioni. Që pas çlirimit e pavarësimit, të vijë edhe liria e lëvizjes! Në të kundërtën do të ishte marre për ata që e bllokojnë! Për të mos thënë diçka edhe më shumë!", shkruan gazetari Adriatik Kelmendi në FB.

NJË ZYRË PËR MËRGIMTARËT

"Komuna e Gostivarit lajmëron se në datën 15 dhjetor do të hapet për herë të parë ZYRA PER MERGIMTARET. Kjo zyrë do të funksionojë në formën e një sporteli dhe do të jetë efektive nga ora 08.00 e mëngjesit deri në orën 20.00. Hapja e kësaj zyre bëhet me qëllim që të lehtësojmë për të gjithë mërgimtarët tanë në maksimumin e mundshëm procedurat administrative pranë Komunës, Policisë rajonale apo Gjykatës. Kjo zyrë do të qëndrojë e hapur deri në 15 janar të vitit 2018 për t'u rihapur sërish në kohën e verës kur është sezoni i fluksit të mërgimtarëve. Zyra do gjendet pranë Qendrës Informative të Komunës. Mirë se vini në shtëpi mërgimtarë!", shkruan kryetari i Gostivarit, Arben Taravari.

KOT TENTOJNË

"Kot regjimet tentuan dhe tentojnë, t'ua presin krahët poetëve. Këta shkretanë nuk e mësuan, mbase dhe nuk do e mësojnë asnjëherë, se, poetët ngjiten lartësirave të papara,me të fluturuarit me Zemrën e tyre madje dhe pa krahë...", shkruan gazetari Skender Raufi në profilin e tij në Facebook.

MEDIACitate

Rusia ka filluar aksionin e ndihmave për fëmijët serbë të fshatrave serbe të Kosovës në jug nëpërmes Kishës së Graçanicës. Përfaqësuesit serbë të fshatrave ndihmën ua atribuojnë "lidhjeve të thella", që serbët e Kosovës kanë tradicionalisht me Rusinë, ndërsa shqiptarët vlerësojnë se Rusia në këtë mënyrë po futet gjithnjë e më thellë në brendi të Kosovës me qëllime të caktuara. Disa organizata humanitare të Rusisë, të cilat veprojnë në veri të Kosovës e për të cilat vlerësohet se nuk merren vetëm me ndihma humanitare, kanë shtrirë aktivitetin e vet edhe në jug të vendit.

(Zëri, 11 dhjetor)

Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka pranuar sot kredencialet e ambasadorit të Tunizisë, Seif Alah Rezheba, të cilit i shprehu mirënjohjen për qëndrimin e këtij vendi për mosnjohjen e Kosovës. Duke përshëndetur diplomatin tunizian, kreu i shtetit serb theksoi se marrëdhëniet diplomatike midis dy vendeve u krijuan 60 vjet më parë dhe se Serbia dhe Tunizia kanë ndërtuar një miqësi të fortë gjatë viteve, bëri të ditur zyra për media e Vuçiqit.

(Klan Kosova, 11 dhjetor)

Kreu i shtetit Ilir Meta, i pyetur nga gazetari i Top Channel, Thimi Samarxhiu për çështjen e kryeprokurorit tha se duhet zbatuar Kushtetuta, dhe dialog mes aktorëve kryesorë.
"Sikurse ju e dini kjo është një përgjegjësi ekskluzive e Kuvendit të Shqipërisë. Si president unë dua të nënvizoj, derisa kemi të bëjmë me një çështje të rëndësishme të një institucioni kyç të drejtësisë, që duhet respektuar Kushtetuta dhe fryma e saj. Është e rëndësishme që të ketë midis aktorëve kryesorë një dialog të shpejtë, të përgjegjshëm dhe të bazuar mbi standarde transparente për zgjidhjen e kësaj çështjeje, pasi çdo hap i njëanshëm nuk do t'i ndihmonte konsolidimit të pavarësisë së institucioneve dhe rritjes së besimit të institucionet e reja të drejtësisë", është shprehur Meta.

(Top Channel, 11 dhjetor)

NËSE NUK E KENI DITUR...

ZANAFILLA E ELBASANIT

Të dhënat arkeologjike sugjerojnë se historia e trevave të Elbasanit e ka zanafillën në shekullin II para Krishtit. Besohet se emri i pare i Elbasanit ka qene Mansius që do të thotë vend-qëndrim. Shumë arkeologe besojnë se vendburimi me i madh arkeologjik i qytetit antik mund të jetë në zonën lindore të Elbasanit pranë rrapit të Mancës, për shkak të ngjashmërisë midis emrave dhe rrënojave. Në shekullin II qyteti nisi të njihej me emrin Skampius e më vonë me emrin Skampi dhe ishte në varësinë administrative të Durrahut (Durrësit). Duke qenë i vendosur në kryqëzimin e rrugëve Veri-Jug dhe Lindje-Perëndim, ai ka shërbyer si pikë e rëndësishme kalimi dhe si stacion i rëndësishëm, duke u përmendur në vijimësi si qendër urbane, ushtarake e peshkopale. Njohu lulëzimin e tij më të madh kur perandoria romake ndërtoi Via Egnatia një rrugë me strategji ushtarake dhe ekonomike që lidhte Romën me Kostandinopojën.

Deputetët e shumicës parlamentare - LSDM dhe BDI me shumicë votash miratuan Rendin e ditës me pikën e vetme - miratimin e Ligjit për gjuhët, me çka filloi të rrjedhë afati treditor për debat në komisionin amë, në këtë rast në Komisionin për çështje evropiane

TË HËNËN FILLOI PROCEDURA NË LEXIM TË DYTË E LIGJIT PËR GJUHËT

SHQIPJA DREJT FUNDIT

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 11 dhjetor - Nga e hëna (dje) fillon të rrjedhë afati treditor për debat në Komisionin për çështje evropiane lidhur me miratimin e Ligjit për gjuhët me çka filloi edhe leximi i dytë i këtij ligji të rëndësishëm për shqiptarët në Maqedoni. Deputetët e shumicës parlamentare - LSDM dhe BDI me shumicë votash miratuan Rendin e ditës me pikën e vetme - miratimin e Ligjit për gjuhët, ndërsa deputetët e VMRO-së nuk morën pjesë në mbledhje. Megjithatë, pas miratimit të rendit të ditës kryetari i Komisionit, Artan Grubi, anuloi vazhdimin e mbledhjes për shkak të mosprezencës së propozuesit të ligjit, në këtë rast ministrit të Drejtësisë, Bilent Saliji, apo përfaqësuesve tjerë nga kjo ministri. "Ministri i Drejtësisë më njoftoi se është në Letoni, ndërsa ne e presim zëvendësin. Duhet të ketë përfaqësues të Qeverisë, i cili do të prononcohet për 90 amendamentet që janë parashtruar për Ligjin. Për vazhdimin e saj do të informojë gjatë ditës së sotme apo nesër", deklaroi Grubi. Kjo qasje e kryetarit të Komisionit nga shumë media u interpretua si skenarë i qëllimshëm për të shmangur debatin për amendamentet e propozuara nga LSDM dhe Lëvizja BESA për faktin se për Ligjet me shenjën BE-së, nuk mund të zgjatë më shumë se tre ditë debati në Komision gjatë leximit të dytë. Por ishte LSDM që votoi Rendin e ditës - shenjë kjo se kjo parti mund të lejojë të kalojë ky ligj pa debat për amendamentet ndonëse ka dorëzuar katër për të plotësuar propozim-ligjin për gjuhët. Ndryshe do të ishte nëse LSDM sot nuk do të merrte pjesë në Komision dhe i njëjti nuk mund të fillonte me punë pa miratimin renditë të ditës. Ndërkaq kryetari i Komisionit, Artan Grubi, bëri paralele me procedurën parlamentare për Buxhetin, ku debati është i kufizuar. Gjatë një konference për shtyp të kërkuar nga gazetarët, Grubi tha se nuk bëhet fjalë për asnjë skenarë, por se sipas tij, skenari i vetëm është miratimi i Ligjit për gjuhët. "Kemi rast të ngjashëm sikur me Buxhetin ku debati është i kufizuar dhe gjithçka shkon sipas Ligjit. Këtu s'kemi të bëjmë me kurrfarë skenari, skenari i vetëm është që të miratohet sa më shpejtë Ligji për gjuhët", tha Grubi. Vonesën e deritashme për sjelljen e Ligjit në lexim të dytë, deputeti i BDI-së e arsyetoi me agjendën e ngjeshur për ligjet që prekin reformat në gjyqësor. "Pas kalimit në lexim të parë u desh që pas shtatë ditëve, më 22 nëntor të thërras mbledhje të Komisionit, por atë e shtyva për shkak të agjendës reformuese për ligjet që duhej të miratohet në Parlament si ai për verifikimin e fakteve, ligji për Këshillin Gjyqësor dhe ligji për dëshmitarët e mbrojtur dhe për këtë, u detyrova të shtyj thirrjen e mbledhjes", theksoi Grubi. Në pyetjen çka nëse as të mërkurën nuk do të jetë prezente askush nga Qeveria, Grubi tha se ka biseduar më herët me ministrin e Drejtësisë dhe se ai personalisht ka shrehur dëshirë të prezantojë Ligjin për gjuhët. "Jam i bindur se të mërkurën - nëse jo sot apo nesër, do të jetë prezent edhe ministri i Drejtësisë, Bilent Saliji. Ai më herët ma ka shprehur dëshirën që vetë të jetë prezent për të prezantuar ligjin për gjuhët", tha Grubi. Në pyetjen tjetër se për këtë ligj, siç po vepron kryetari i Komisionit, po shmanget debati për opinioni publik, Grubi tha se opinioni publik ka 15 vite që debaton për gjuhën shqipe, dhe se tani ka ardhur koha të përmbyllet njëri nga kapitujt kryesor të Marrëveshjes së Ohrit. Nga LSDM nuk deshëm të deklarohen, ndërsa thanë shkurt se rreth Ligjit për gjuhët duhet pyetur deputetin e BDI-së, Artan Grubi. Ndryshe BDI insiston të mbetet drafti i njëjtë bazuar në marrëveshjen politike mes LSDM-në kur lidhën koalicioni qeveritar, ndërkaq kjo e fundit ka propozuar katër amendamente me të cilët kërkon futjen gjuhës së komuniteteve tjera në paragrafin 4 të nenit 2 dhe uljen dënimeve për institucionet që refuzojnë të zbatojnë këtë ligj nga 4 deri në 5 mijë euro në 1 mijë deri në 2 mijë euro. Amendamente ka propozuar edhe Lëvizja BESA që kanë të bëjnë me emërtimin e ligjit, ku kërkojnë që të quhet "Ligji për gjuhë shqipe" jo siç është propozuar tani - "Ligji për gjuhët". Ndërsa VMRO ka propozuar amendamente me theks tek heqja e gjuhës shqipe si gjuhë dytë zyrtare, por kjo të zëvendësohet me përkthimin e gjuhës shqipe në shkresat zyrtare në të gjitha organet e pushtetit qendror.

XHAFERI: TË RREGULLOHET ZBRAZËTIRA JURIDIKE PËR HEQJE TË IMUNITETIT

Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, të hënën e hapi çështjen për zbrazëtirën juridike që lajmërohet mes pranimit të letrës me kërkesë për heqje të imunitetit të personave të emëruar dhe të zgjedhur nga Gjykata dhe momentit të vendimmarrjes nëse do t'i hiqet imuniteti. Xhaferi konsideron se kjo duhet të rregullohet në mënyrë që të parandalohen keqpërdorimet. "Bëhet fjalë për situatë prej momentit kur do të jepet urdhër për shoqërim, për sigurim të personit bartës të imunitetit, të mos lidhet vetëm për deputetët sepse ka edhe persona të tjerë me imunitet... prej momentit kur do të jepet urdhri, deri në momentin për vendimmarrje që është caktuar në procedurë adekuate në Rregulloren për punë të Kuvendit, në atë zbrazëtirë që bëjmë me njeriun. Duhet të rregullohet kjo zbrazëtirë sepse ajo është hapësirë për keqpërdorim përkatësisht për interpretim tjetër", thotë Xhaferi në deklaratë për MIA-n. Ai shtoi se nuk pretendon të përzihet në kompetencën e institucionit përkatësisht të relacionit pushtet-gjyqësi, por se do të duhej të mendohet se cila do të ishte mënyra më e mirë që të mbushet kjo zbrazëtirë, që të mos keqpërdoret e drejta e disave dhe e drejta e të tjerëve.

ZAEVI SOT NË KOSOVË

Kryeministri i Maqedonisë, Zoran Zaev, sot (e martë) do të qëndrojë për një vizitë zyrtare njëditore në Kosovë. Zaevi do të takohet me homologun e tij kosovar, Ramush Haradinaj, me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi si dhe me kryetarin e Parlamentit, Kadri Veseli. Gjatë qëndrimit të tij në Kosovë, kryeministri i Maqedonisë do të takohet me përfaqësuesit e komunitetit të biznesit maqedonas - kosovar. Në delegacionin që do të udhëhiqet nga kryeministri Zaev do të jenë edhe ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi, ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Goran Sugareski, ministri i Kulturës, Robert Alagjozovski, si dhe ministri pa portofol përgjegjës për Diasporën, Edmond Ademi. Vizita e Zaevit është vizita e parë zyrtare e një kryeministri të Maqedonisë në Republikën e Kosovës.

SEANCA ME SHQIPËRINË, MË 15 DHJETOR NË POGRADEC

Qeveria e Maqedonisë dhe ajo e Shqipërisë do të mbajnë seancë të përbashkët ndërqeveritare më 15 dhjetor në qytetin e Pogradecit. Në seancë, siç kumtoi shërbimi qeveritar për media, do të bisedohet në shumë tema, me qëllim që të përmirësohet aktiviteti i përbashkët bilateral dhe dialogu politik për përforcimin e bashkëpunimit në të gjitha sferat. Duke i pasur parasysh angazhimet e ndërsjella nga bashkëpunimi rajonal, të orientuar ndaj Bashkimit Evropian, Procesit të Berlinit, qëllimeve të projektuara në Samitin e Kartës së Adriatikut në Trieste dhe krijimi e zonën rajonale ekonomike, në fokus të seancës ndërqeveritare do të jetë avancimi i lidhshmërisë dhe infrastrukturës së ndërsjellë, lehtësimi i këmbimit të mallrave dhe shërbimeve dhe përforcimi i bashkëpunimit në sferën e sigurisë. Kjo është seanca e parë e përbashkët ndërqeveritare midis qeverive të Maqedonisë dhe të Shqipërisë.

PAK PARA PËR KËRKIME SHKENCORE

SHKENCA NË MARGJINAT E BUXHETIT

Pjesën më të madhe të buxhetit të MASH-it, 2.845.495 euro e harxhojnë institutet shkencore (për rroga, mirëmbajte dhe shpenzime të ngjashme). Një sasi tjetër e konsiderueshme e këtij buxheti mbi 813.000 euro (50.000.000 denarë) janë për përkthimin e librave, ndërsa për kërkimet shkencore janë planifikuar 1.544.715 euro (95.000.000 denarë)

Koha Laura PAPRANIKU

Shkup, 11 dhjetor - Siç edhe është konfirmuar zyrtarisht - mjetet financiare të cilat do të ndahen nga buxheti i vitit 2018 për kërkime shkencore do të jenë jo më shumë se 2 për qind e buxhetit të përgjithshëm të Arsimit dhe Shkencës. Në propozim-buxhetin, i cili është në fazën e miratimit në Parlament, për shkencën janë planifikuar rreth 7.366.000 euro (425.998.000 denarë) edhe atë vetëm 5.203.220 euro (319.998.000 denarë) nga buxheti bazë. Ndërkaq, 1.577.235 euro (97.000.000 denarë) janë planifikime nga të ardhura të siguruara nga aktivitete të vetëfinancimit, kurse 146.341 euro (9.000.000 denarë) janë pjesë e planifikimeve të buxhetit nga donacionet. Në total, buxheti i vitit të ardhshëm për arsim dhe shkencë, sikurse është bërë e ditur, kap vlerën e 406.555.211 euro, respektivisht 25.002.838.000 denarëve. "Për shkencën dhe institutet shkencore janë planifikuar 2 për qind e buxhetit", ka pohuar ditë më parë ministria Renata Deskovska. Sipas informacioneve që ka dhënë ministria, më pak se sa shkenca do të kenë vetëm shërbimet administrative (1.8 për qind) dhe financimi i projekteve (1 për qind).

Në fakt, ajo që bie në sy sa u përket investimeve të pakta që bëhen për shkencën në Maqedoni, 5.203.220 euro (nga buxheti bazë) është niveli i ulët edhe i atyre mjeteve vizavijë kërkimit shkencor. Pjesën më të madhe të këtyre mjeteve - 2.845.495 euro e harxhojnë institutet shkencore (për rroga, mirëmbajte dhe shpenzime të ngjashme). Një sasi tjetër e konsiderueshme e këtij buxheti mbi 813.000 euro (50.000.000 denarë) janë për përkthimin e librave, ndërsa për kërkimet shkencore janë planifikuar 1.544.715 euro (95.000.000 denarë). E parë më përqindje, i bie që për kërkimet shkencore të mos ndahen as 30 për qind e buxhetit të planifikuar komplet për shkencën dhe kjo padyshim që vë këtë të fundit në pozitë inferiore, ndërsa vetë kërkimi shkencor në margjinat e buxhetit. Pavarësisht rritjes së përgjithshme që ka pësuar buxheti i MASH-it për vitin 2018 dhe që sipas ministres Deskovska është për 5 për qind më i lartë se buxheti i njëjtë i vitit 2017, investimet në shkencë mbeten në nivele të ulëta. Ky nuk është viti i parë që shkenca mbetet në këtë stad, pasi edhe vitin e kaluar ishte e njëjta histori. Nga 2016-ta deri tani, MASH kishte rritur gjithashtu për rreth 8 për qind buxhetin e investimeve dhe shpenzimeve për të gjitha nivelet dhe aktivitete që kanë të bëjnë me sferën e arsimit. Pra, nga mbi 383 milionë euro sa ishte në 2016-ën buxheti në fjalë, në 2017-ën ky buxhet ka shkuar në mbi 414 milionë euro, pra ka shënuar një rritje prej 7.8 për qind. Por pavarësisht kësaj, hulumtimi dhe kërkimi shkencor pësuan rënie. Për më tepër, shkenca ishte i vetmi aktivitet i MASH-it që kishte pësuar rënie në vitin 2017, çdoherë e krahasuar me një vit para saj. Nëse në 2016-ën, MASH kishte planifikuar 8.855.000 euro (546.325.000 denarë) me buxhetin e 2017-ën për të njëjtin qëllim janë ndarë 8.352.000 euro (513.662.000 denarë). Pra ka një rënie prej minus 6 për qind. Vetëm me hulumtimin dhe kërkimin shkencor, MASH po tregohet dorështrënguar sa i përket planifikimit të shpenzimeve me buxhetin përkatës. Këtë vit, propozohet që buxheti i MASH-it për 2018-ën të jetë 25.002.838.000 denarë, respektivisht 406.555.211 euro dhe që paraqet buxhet 5 për qind më të lartë se ai i vitit 2017. Rritje më të mëdha janë shënuar në shpenzimet e planifikuara për bllok-dotacionet në arsim fillor dhe të mesëm, pasi nga viti tjetër do të ketë rritje rrogash prej 5 për qind për të gjithë të punësuarit në shkollat e këtyre dy niveleve.

> **Rritje më të mëdha janë shënuar në shpenzimet e planifikuara për bllok-dotacionet në arsim fillor dhe të mesëm, pasi nga viti tjetër do të ketë rritje rrogash prej 5 për qind për të gjithë të punësuarit në shkollat e këtyre dy niveleve**

KSHZ mbetet pa tre anëtarë

Shkup, 11 dhjetor - Kryetari i Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), Aleksandar Çiçakovski deklaroi se ka parashtruar kërkesë për dorëheqje nga posti i kryetarit të Komisionit. Dorëheqja, tha Çiçakovski, është akt i tij personal. Çiçakovski paraqiti dorëheqjen pasi që në opinion u zbulua se anëtarët e KSHZ-së kishin marrë kompensime të larta për ciklet e fundit të zgjedhjeve dhe një peticion në internet për dorëheqjen e anëtarëve të Komisionit. Dorëheqje kanë dhënë edhe dy anëtarët tjerë të KSHZ-së, Igor Milev i VMRO-së dhe Violeta Duma e LSDM-së. Mandati i këtij komisioni do të përfundojë në vitin 2020. Çiçakovski është njeriu i parë i KSHZ-së që nga viti 2015 pas arritjes së Marrëveshjes së Prizhinës.

Dorëhiqet Gruevski, garë mes Mickovskit dhe Popovskit

Shkup, 11 dhjetor - VMRO-DPMNE do të zgjedhë kryetar të ri të partisë më 22 dhe 23 dhjetor, pasi që Nikola Gruevski parashtroi dorëheqje të parevokueshme në mbledhjen e së dielës mbrëma të Komitetit Qendror të partisë. Në Kongresin e jashtëzakonshëm në Vallandovë, sipas sekretarit të përgjithshëm Hristijan Mickovski, do të marrin pjesë 544 delegatë të cilët do të zgjedhin pasardhësin e Gruevskit. Megjithëse për momentin nuk ka konfirmim zyrtar, kandidatët më seriozë për pozitën e kryetarit të VMRO-DPMNE-së, sipas burimeve të partisë, janë Hristijan Mickovski, Nikola Poposki, Antonijo Miloshoski dhe Ilija Dimovski. Sekretari i Përgjithshëm, Mickovski para mbledhjes së Komitetit Qendror konfirmoi se nuk përjashtohet mundësia që ai të jetë kandidat për lider partiak. Ndërkohë, Miloshoski tha se ende nuk kishte vendosur nëse do të kandidonte për pasardhësin e Gruevskit. Sipas tij, është e rëndësishme që të kemi një kongres transparent. "Më pak i rëndësishëm është emri i ri për kryetarin e partisë, më i rëndësishëm është koncepti i ri i veprimtarisë së partisë si një opozitë e shëndetshme", theksoi Milloshoski.

Ballkani të vihet në fokusin strategjik të BE-së

Bruksel, 11 dhjetor - Parlamenti Evropian në raportin e vet vjetor për zbatimin e politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë e theksoi nevojën që BE-ja "fokusin e vet strategjik" sërish ta vendos në Ballkanin Perëndimor, lajmëroi "Tanjug". BE duhet të vazhdojë me ambiciet e saj në rajon, duke dhënë kështu dinamikë të re politikës së besueshme të BE-së për zgjerim, thuhet në raportin e BE-së, në të cilin mbikëqyrje kishte agjencia serbe e lajmeve. Raportin vjetor, të cilin e ka përbërë kryesuesi i Komitetit për punë të jashtme, Dejvid Mekalister, PE-ja do ta miratojë të mërkurën, 13 dhjetor, në sesionin plenar në Strasburg. Në raport, theks është vendosur në faktin se "siguria e qytetarëve të BE-së, integriteti i territorit të BE-së, si dhe stabiliteti i fqinjësisë, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor janë kushtet kyçe për stabilitet të BE-së". Theksohet nevoja për fokus të serishëm strategjik për Ballkanin Perëndimor me njohje të fakteve se BE-ja do të duhet të vazhdojë me ambiciet e saja në rajon duke dhënë me këtë rast nxitje të re për besueshmërinë nga politika e BE-së për zgjerim. "Besojmë se stabiliteti i Ballkanit Perëndimor duhet të mbetet prioriteti më i lartë", thuhet në dokument. Parlamenti Evropian bën thirrje më shumë përpjekje të investojë në përmirësimin e kushteve sociale-ekonomike dhe politike në rajon. "Duhet të mbesim të përkushtuar në kujdesin e shoqërive të larta efikase politike në rajon", qëndron në tekstin e Raportit vjetor të PE-së për Politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së. PE-ja me atë raport gjithashtu përsërit se dera e BE-së është e hapur për anëtarësimin e shteteve të Ballkanit Perëndimor pasi do t'i plotësojnë kushtet për këtë. Vëmendje e veçantë dhe mbështetje duhet të jepen për zbatimin e reformave kyçe institucionale dhe politike të Ballkanit Perëndimor. "I bëjmë thirrje KE-së për të shqyrtuar ndarjen e mjeteve të reja në Instrumentin për ndihmë parainkuadruese si një prej mekanizmave më të rëndësishme për mbështetjen e proceseve të theksuara reformuese", konkludohet në pjesën e raportit të dedikuar Ballkanit Perëndimor.

2018, FOND EKSTRA PËR ANSAMBLIN SHTETËROR

ANSAMBLI SHQIPTAR AKTIVIZON TANECIN

Nëse miratimi nga ana e Qeverisë për themelimin e një ansambli shqiptar të këngëve dhe valleve pritet të jepet javën e ardhshme, ansambli tjetër shtetëror "Tanec" kërkon një fond ekstra për rimëkëmbjen. Në buxhetin e vitit të ardhshëm është parashikuar vetëm një fond prej 800 mijë euro për realizimin e projektit për një ansambël shtetëror shqiptar, ndërsa për të sanuar problemet e "Tanec" - do të lëvrohen fonde ekstra

Koha — Evis HALILI

Shkup, 11 dhjetor - Sigurimi i kushteve për funksionimin e ansambleve do të vendoset në fokus të aktiviteteve në sferën e kulturës për vitin e ardhshëm. Nëse miratimi nga ana e Qeverisë për themelimin e një Ansambli shqiptar të këngëve dhe valleve pritet të jepet javën e ardhshme, ansambli tjetër shtetëror "Tanec" kërkon një fond ekstra për rimëkëmbjen. Në buxhetin e vitit të ardhshëm është parashikuar vetëm një fond prej 800 mijë euro për realizimin e projektit për një Ansambël shtetëror shqiptar, dhe vetëm në rast se buxheti i shtetit do të jetë në një kondicion të mirë, do të mund të sanohen problemet e "Tanec". Kështu ka premtuar ministri i Kulturës, Robert Allagjozovki në një vizitë në këtë institucion, ku ndër të tjera iu prezantua gjendja e keqe në të cilën gjendet jo vetëm ndërtesa, por edhe problemet për mirëmbajtjen e instrumenteve, kostumet e vjetra, e të tjera. Ministri ka bërë me dije se situatat me çatitë që pikojnë janë evidentuar në mbi 20 institucione të kulturës dhe sanimi i tyre do të bëhet sipas kritereve të urgjencës, por edhe të buxhetit që është në dispozicion.

"Si ministri dhe Qeveri angazhohemi që t'i zgjidhim problemet dhe të përmirësojmë kushtet në të cilat krijojnë artistët dhe prandaj nuk do të merrmi me projekte kapitale, por me rikonstruktimin e projekteve ekzistuese. Nëse buxheti do të jetë në një kondicion të mirë financiar gjatë 2018 do të mundohemi të sanojmë problemet e 'Tanec'-it", ka thënë ministri. Drejtori Stojançe Pavllovski po ashtu ka kërkuar edhe punësime, kryesisht kuadro të rinj, rinovimin e instrumenteve, mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre, kostume të reja, e të tjera. Nga ana tjetër, dy vjet pas shpalljes së iniciativës për themelimin e një Ansambli shqiptar shtetëror dhe dy javë pas vendimit të Ministrisë, nuk ka asgjë konkrete. Madje, as sa i takon vendndodhjes së tij, permanente, apo provizore.

Sekretari shtetëror Valmir Aziri pohon se presin që javën e ardhshme Qeveria të miratojë vendimin për themelimin e Ansamblit. Buxheti që do t'i akordohet këtij projekti do të jetë rreth 800 mijë euro, para këto që do të përdoren për investimet fillestare, pajisja me kostume, instrumente, rroga mujore, e të tjera

Sekretari shtetëror Valmir Aziri pohon se presin që javën e ardhshme Qeveria të miratojë vendimin për themelimin e Ansamblit. Buxheti që do t'i akordohet këtij projekti do të jetë rreth 800 mijë euro, para këto që do të përdoren për investimet fillestare, pajisja me kostume, instrumente, rroga mujore, e të tjera. Aziri ka pohuar se kanë ndërmarrë hapa konkretë për themelimin e Ansamblit, bazuar tek kërkesat e shoqërive që veprojnë prej vitesh. Edhe kuadrot që do të punësohen në Ansamblin shtetëror supozohet se do të merren nga ansamblet dhe shoqëritë e tjera shqiptare. "Ende nuk e kemi gjetur godinën ku do të vendoset ky ansambël, për momentin jemi në pritje të miratimit nga Qeveria të këtij vendimi", thotë Aziri. Iniciativa për themelimin e një Ansambli shqiptar u prezantua nga Ministria e Kulturës gati dy vjet më parë, në një takim me përfaqësues në ansambleve dhe shoqërive kulturore artistike në Komunën e Çairit. Sipas tyre, themelimi i një ansambli do të zgjidhte problemin e madh të financimit, duke mos lejuar funksionimin e tyre vetëm në baza vullnetare, por edhe do të ngrinte në një nivel më profesional kultivimin e kulturës, traditës dhe folklorit. Nga Ministria e Kulturës ende nuk kanë asnjë detaj lidhur me numrin e punonjësve, profilet, e të tjera. Nëse si model do të merret "Tanec", buxheti i këtij ansambli është 50 milionë denarë, ndërsa numëron rreth 90 punonjës.

30 ditë paraburgim për Fetah Alimin

Shkup, 11 dhjetor - Pjesëtari i sigurimit të Parlamentit, njëherësh i punësuar në DSK, Abdylfetah Alimi, i njohur edhe si shpëtimtari i deputetit Ziadin Sela, të hënën nga Gjykata Penale e Shkupit i është caktuar masa e paraburgimit 30 ditor. Jo zyrtarisht, Alimi, të hënën pasi që në GJPSH është paraqitur me avokaten e tij, me vendim të gjykatësit në procedurë paraprake, nën shoqërimin e policisë ai është dërguar në burgun hetues të Shutkës. Prokuroria Publike për krim të organizuar deri më tani nuk ka dhënë asnjë sqarim zyrtar se për cilat arsye Alimi dyshohet për vepër penale "terrorizëm", gjegjësisht për ngjarjet e dhunshme të 27 prillit. Megjithatë, sipas raporteve të mediave, Alimi thuhet se i ka poseduar çelësat e dyerve të Parlamentit, të cilët më vonë i janë marrë nga shefi i sigurimit të ish-kryeparlamentarit Trajko Veljanovski dhe nga deputeti Kërste Mukovski, i cili dyshohet se personi kryesor i cili ua ka hapur dyert protestuesve të dhunshëm. Emri i Abdylfetah Alimit për opinionin më të gjerë u bë i njohur pas lajmin se ai së bashku me disa kolegë të tij, kanë kontribuar më së shumti që kryetari i Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela, të mbetet i gjallë natën e 27 prillit.

KRONIKË

Vjedhje në një lokal për ceularë

Natën mes datës 9 dhe 10 të këtij muaji, deri më tani persona të panjohur kanë kryer një vjedhje në shitoren për shitjen telefonave celularë e pajisjeve për telefona celularë "Atomik", e lokalizuar në kompleksin "Lovec" në Tetovë, pronë e 53-vjeçarit me iniciale N.I nga fshati Gllogjë. Pasi kanë thyer dritaren e derës hyrëse të objektit dhe me forcë kanë larguar dryrin, kanë hyrë brenda dhe kanë marrë 7 telefona celularë, 4 kuti prej kartoni të cilat brenda kanë pasur këllëf telefoni, bizhuteri, një karrocë dore, si dhe gjësende të tjera të cilat kanë qenë brenda objektit të shitores, pas çka pa u vërejtur nga askush janë larguar nga vendi i ngjarjes. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe po vërtetohet vlera e përgjithshme e gjësendeve të vjedhura, dhe po punohet në zbulimin e autorëve të kësaj vjedhjeje përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet të jetë rreth 1000 denarë.

Kontrolle në 7 lokale hotelerike

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë stacioni policorë në Gostivar kanë kryer kontroll ku janë përfshirë 7 objekte hotelerike, të lokalizuara në rrugët "Zhivko Brajkovski", në rrugën e "Ilindenit" dhe "Beliçica" në Gostivar. Pas kontrollit nuk janë konstatuar kundërvajtje të natyrës së prishjes së rendit dhe qetësisë publike, si dhe thyerje të ligjit për konsumim të duhanit.

Aksidenton dy vetura

Në rrugën "Banjeshnica" në Gostivar, një veturë e tipit "Reno Megan" me targa të Gostivarit, të cilën e ka drejtuar 34 vjeçari me iniciale T.B, ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe për pasojë ka goditur dy vetura të tjera, të cilat kanë qenë të parkuara edhe atë një veturë të tipit "Shkoda" me targa të Shkupit, një "Smart" me targa të Gostivarit. Nga dalja prej rrugës dhe goditja e veturave në fjalë, fatmirësisht nuk ka të lënduar, përderisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet që të jetë rreth 100 mijë denarë. Sipas të dhënave fillestare që bazohen në ekspertizën e kryer në vendin e ngjarjes si shkak për këtë aksident është mos përshtatja e shpejtësisë si dhe mos mbajtja e anës së djathtë gjatë drejtimit të automjetit, njofton Sektori për punë të brendshme në Tetovë përmes një kumtese me shkrim. (U.H)

SHOQATA E TURISTËVE DHE HOTELERIVE KËRKON NDRYSHIME LIGJORE

Shoqata e turistëve dhe hotelerive kërkon ndryshimin edhe të Rregullores për subvencionim për sjelljen e turistëve të huaj, sepse procedura për pagesë është voluminoze dhe e komplikuar. Shoqata bën me dije se ende nuk është zgjidhur problemi edhe me të ashtuquajturit njerëz-agjenci

Të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikës, tregojnë se nga muaji janar deri në fund të muajit shtator të vitit 2017, drejt Maqedonisë kanë udhëtuar 509.538 turistë të huaj, duke lënë në Maqedoni 255 milionë dollarë

TË ELIMINOHEN KONKURRENCAT JO LOJALE

Koha — Zejnulla VESELI

Shkup, 11 dhjetor - Zgjidhja e vetme për tejkalimin e problemeve, me të cilat po ballafaqohen agjencitë turistike dhe objektet e hotelerive, është të ndryshohet Ligji për turizëm dhe objekteve hotelerie si kusht për rritje më të mëdha në turizëm dhe më shumë të hyra në ekonominë e vendit. Shoqata turistike dhe hotelerive pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë, kërkojnë të ndryshohet Ligji, me qëllim që në të ardhmen transportuesit e udhëtarëve të mos mund të punojnë si agjenci turistike, ndërsa agjencitë që posedojnë licencën B, të mos mund të shesin aranzhmane, por këtë të drejtë ta kenë vetëm agjencitë turistike që kanë licencën A dhe garancia bankare të jetë dokument i vetëm serioz i agjencive turistike e jo si deri më tani polisa e sigurimit. "E patjetërsueshme është të ndryshohet kategorizimi dhe në vend të licencës A dhe B, të ketë edhe kategori tur-operator, që do të merren vetëm me organizmin e udhëtimeve dhe agjenci turistike si agjentë shitës të aranzhmaneve. Propozojmë ndryshime të Ligjit për veprimtari turistike dhe hotelerive, që të eliminohen të gjitha parregullsitë e deritanishme dhe të vendoset rend në veprimtarinë turistike dhe hotelerive. Nga 519 agjenci turistike të regjistruar në Maqedoni, 100 prej tyre si veprimtari kryesore e kanë "transportin e udhëtarëve", deklaroi Sllave Siraçevski, nënkryetar i Shoqatës së turistëve dhe hotelerive, duke shtuar se licencat e agjencive turistike duhet të ripërtërihen në çdo dy apo tre vite, e jo të vlejnë në mënyrë të pakufizuar. Ndërsa Asim Mexhidoviq, anëtar i Shoqatës së turistëve dhe hotelerive kërkoi gjithashtu ndryshimin e Rregullores për subvencionim për sjelljen e turistëve të huaj, sepse procedura për pagesë është voluminoze dhe e komplikuar. Shoqata bën me dije se ende nuk është zgjidhur problemi edhe me të ashtuquajturit njerëz-agjenci.

"Do të ishte mirë të përgatitet rregullore e re për subvencionim, siç e kanë vendet tjera apo si Turqia që zbaton modelin e financimit dhe subvencionim e fluturimeve çarter dhe për çdo fluturim të këtij lloji paguan 6.000 euro. Nevojitet vetëm marrëveshje më kompaninë ajrore", tha Mexhidoviq. Shoqata njëherit kërkon luftë më të ashpër nga ana e inspektorëve për konkurrencën jo lojale në veprimtarin e hotelerive. "Janë të kategorizuara vetëm hotelet, motelet dhe pansionet, por jo edhe objektet për bujtje apo apartamentet dhe se ende nuk është zgjidhur problemi me të ashtuquajturit njerëz-agjenci. Në këtë drejtim, kërkojmë që kompetentët të kenë ingerenca më të mëdha në mënyrë që të mund të dënohen këto objekte të pa kategorizuara në vend. Lidhur me objektet turistike, si restorante nacionale janë të regjistruara 88 objekte, ndërsa këtë veprimtari e ushtrojnë mbi 1.378 subjekte si restorante, 112 subjekte janë shërbime ketering dhe 910 subjekte tjera punojnë si klube për kafe ", tha Asim Mexhidoviq nga Shoqata e turistëve dhe hotelerive. Të dhënat zyrtare të Entit Shtetëror të Statistikës, tregojnë se nga muaji janar deri në fund të muajit shtator të vitit 2017, drejt Maqedonisë kanë udhëtuar 509.538 turistë të huaj, duke lënë në Maqedoni 255 milionë dollarë, ndërsa për 9 muajt e parë të këtij viti janë realizuar 1.063.209 bujtje, që është për 22 për qind më shumë se vitin e kaluar. Më shumë turistë kanë ardhur nga Serbia, Kroacia, Shqipëria, Kosova, Gjermania, Bullgaria, Polonia dhe Greqia. Si subvencione për agjencitë turistikë që kanë sjell turistë në Maqedoni nga viti 2010 e deri në vitin 2017, shteti ka paguar 11.9 milionë euro.

ODAT E AVOKATËVE NGA RAJONI

Bashkëpunim për qeverisje të drejtë

Shkup, 11 dhjetor - Odat e avokatëve të Maqedonisë, Serbisë, Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës dhe Kosovës, (BRRLN), në Shkup mbajtën takim, në të cilin i shqyrtuan mundësitë për vazhdim të projekteve rajonale mision i të cilëve është kontributi drejt qeverisjes së të drejtës, demokracisë dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut përmes përforcimit të pavarësisë dhe efikasitetit të avokaturës dhe odave të avokatëve. Për kryetar të ri të Rrjetit ballkanik rajonal për qeverisje të së drejtës nga nëntori i vitit 2017 është kryetari i Odës së Avokatëve të RM-së, Nikolla Dodevski. "Projektet të cilët deri tani u implementuan u treguan si të suksesshëm, por në të ardhmen shpresoj për sukses më të madh. Rrjeti u vendos për shkak të përmirësimit të kapacitetit të Odave përmes avancimit të pavarësisë së profesionit, përmirësim të qasjes deri te ndihma juridike dhe cilësia e përfaqësimit në lëndët penale, mbrojtja e të drejtave të njeriut", theksoi Dodevski në takimin që u mbajt këtë fundjavë. Liza Ruso, eksperte juridike e ABA ROLLI, duke e potencuar rëndësinë e rolit të avokaturës në një shoqëri theksoi se njerëzit të cilët i bëjnë ndryshimet në një shoqëri nuk janë anëtarë të Qeverisë, por avokatët të cilët i avancojnë të drejtat e njeriut. Duke përdorur analizë komparative për problemet praktike të mbrojtjes në procedurën praktike si bazë, themeluesit e rrjetit BRRLN përcaktuan pesë sfera kyçe ku mund të përmirësohet përfaqësimi i mbrojtjes edhe atë ndihmë juridike dhe ex officio mbrojtje, trajnim dhe arsim, kapacitete të odave, e drejtë penale dhe media dhe ngritje e vetëdijes publike. Grupi i punës i përbërë nga anëtarë nga secila nga pesë vendet-anëtare të BRRLN-së u formua rreth secilës nga këto sfera esenciale.

OSE MË SHUMË MJETE, OSE PADI PËR "EKO-GJENOCID"

Shkup, 11 dhjetor - Nisma qytetare "Koalicioni O2" për ajër të pastër" kërkon që Qeveria ta rrisë buxhetin për mbrojtjen e mjedisit të jetesës për vitin 2018 prej 0,4 për qind nga BPV, sa është planifikuar, në të paktën 2,5 për qind. Në të kundërtën, prej atje paralajmërojnë ngritjen e procedurës kundër Republikës së Maqedonisë për shkeljen e konventave të ratifikuara, Kushtetutën, të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, me parashtrimin e padive dhe ankesave deri te institucionet ndërkombëtare kompetente, por edhe protesta radikale. Lartësia e mjeteve të parapara

për mbrojtjen e mjedisit të jetesës, uljen e ndotjes dhe ndërprerjen e minierave, sipas kësaj nisme qytetare, nuk e pasqyron seriozitetin e gjendjes dhe tregon përkushtim të pamjaftueshëm drejt zgjidhjes së këtij, siç thonë, problemi serioz i barabartë në "ekogjenocid". Tatijana Çakulev nga Nisma qytetare në konferencën e sotme për shtyp theksoi se Republika e Maqedonisë në vazhdimësi i shkel dhe nuk i respekton të drejtat e ndërlidhura me mjedisin e jetesës. "Serioziteti i gjendjes në të cilën ndodhet Maqedonia në pikëpamje të ndotjes dhe degradimit të mjedisit të jetesës, sasia e problemit, të mbledhura për shkak që injorimi i tyre shumëdekadësh kërkon përkushtim maksimal dhe përfshirje për eradikim të burimit të problemit dhe sanimit të pasojave", tha Tatijana Çakulev nga Koalicioni për ajër të pastër. Prej atje paralajmëruan se nëse kryeministri Zoran Zaev nuk i respekton kërkesat e tyre do t'i ndërmarrin të gjitha hapat juridike të cilat i kanë në dispozicion për ngritjen e procedurave kundër Republikës së Maqedonisë për shkeljen e konventave të ratifikuara, Kushtetutën, të drejtat e njeriut dhe të fëmijës dhe do të ngritin padi në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe protesta radikale në mbarë shtetin.

Përfaqësuesit e Koalicionit pasdite do të takohen me Zoran Zaevin, të cilit do t'ia dorëzojnë kërkesat. Pas takimit, siç potencuan, do të dihet nëse ka gatishmëri për ballafaqim me këtë problem, i cili i rrezikon jo vetë gjeneratat e tashme, por edhe të ardhshme.

TËRBOHEN QENTË ENDACAK

FRIKË NË ÇDO RRUGË

Përkundër faktit se problemi me qentë endacak është riakutalizuar ditëve të kaluar, për banorët e lagjes Fushë Tophanë, Çair, Xhon Kenedi e rrethinë, kjo situatës vazhdon të mbetet e njëjtë për vite të tëra

Koha Omer XHAFERI

Shkup, 11 dhjetor - Banorët e Çairit dhe rrethinës frikësohen nga sulmet eventuale të qenve endacak. Ngjarjet e fundit, të cilët u regjistruan nëpër lagje dhe komuna të ndryshme brenda qytetit të Shkupit, kanë ngjallur reagime edhe nga banorët e Komunës së Çairit. Vërejtjet më të shpeshta të cilat mund t'i hasësh nëpër rrjetet sociale, por edhe përmes njoftimeve që kanë arritur deri te redaksia jonë, kanë të bëjnë me prezencën e madhe të qenve endacak përreth institucioneve edukativo-arsimore. Tufat e qenve endacak, njëkohësisht paraqesin rrezik edhe për kalimtarët e rastit. Me këtë situatës, siç mund të lexohet nëpër rrjetet sociale, më së shpeshti ballafaqohen ata qytetarë, të cilëve orari i punës ju fillon në orët e para të mëngjesit. Përkundër faktit se problemi me qentë endacak është riakutalizuar ditëve të kaluar, për banorët e lagjeve Fushë Tophanë, Çair, Xhon Kenedi e rrethinë kjo situatës vazhdon të mbetet e njëjtë për vite të tëra. Qytetarët, të cilët jetojnë në këto pjesë të qytetit, nëpërmjet formave të ndryshme të reagimeve thonë se në rast se komuna dhe autoritet përkatëse nuk ndërmarrin masa për largimin e këtyre qenve nga rruga, atëherë ato vetvetiu do të organizohen.

Autoritet e Komunës së Çairit kur flasin për këtë problematike, thonë se çështja e trajtimit të qenve endacak është kompetencë ligjore e Qytetit të Shkupit dhe NP "Higjiena Komunale", të cilët i posedojnë të gjitha mekanizmat trajtimin e tyre. "Ne si institucion komunal nuk kemi asnjë kompetencë ligjore që të veprojmë. Mirëpo, ne si komunë jemi në shërbim të qytetarëve, me të cilët kemi bashkëpunuar në të ardhmen rreth kësaj çështje, respektivisht për ta parandaluar dhe zgjidhur këtë problematike, ne edhe tutje ndërmjetësojmë në çdo denoncim të qytetarëve që na adresohet neve si komunë. Nëse banorët e Çairit dhe lagjeve tjera të komunës tonë hasin në qen endacak, krahas organeve përkatëse, ato mund të na drejtohen edhe ne, me çka shqetësimin dhe brengën e tyre do ta paraqesim deri te institucionet relevante". Meqë kohëve të fundit janë regjistruar raste të ndryshme të qenve endacak, nga Komuna e Çairit apelojnë deri te banorët e tyre që të kenë kujdes dhe mos të hedhin materie helmuese apo substanca tjera të rrezikshme, pasi ekzistojnë mekanizma ligjore për zgjidhjen e kësaj problematike. Për të pasur një pasqyre më reale se si qëndron çështja e trajtimit të qenve endacak dhe se a ekziston ndonjë plan gjithëpërfshirës në NP "Higjiena Komunale" për mbledhjen e këtyre qenve, gazeta KOHA nuk arriti të marrë përgjigje nga ky institucion. Sidoqoftë, pavarësisht thirrjeve që prezenca e madhe e qenve endacak të paraqitet dhe denoncohet në organet përkatëse, qytetarët e Çairit theksojnë se këto denoncime janë të kota, gjegjësisht çdoherë kur i kanë paraqitur sulmet apo prezencën e qenve endacak, shërbimet komunale nuk kanë dalë në vendngjarje ose fare nuk janë përgjigjur. Ndryshe, siç raportuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, ditë më parë në lagjen Aerodrom të Shkupit, është regjistruar një sulm nga një qen, i cili ende nuk është vërtetuar se bëhet fjalë për qen endacak apo i njëjti ka qenë pronë e ndonjë qytetari. Nga policia e Shkupit kanë potencuar se në rast të vërtetimit se qeni i cili për momentin është internuar në kampin për qenë endacak "Vardarishte" është pronë e ndonjërit, atëherë ndaj personit përgjegjës do të ngrihet padi penale. Në pajtim me dispozita te Kodit Penale, dënimi varion nga 6 deri në 5 vite heqje lire. Njëkohësisht, pas sulmeve të njëpasnjëshme të qenve, siç është rasti në Aerodrom, Lisiçe e Gazi Babë, qytetarët kanë reaguar në mënyrë radikale dhe i kanë helmuar mbi 20 qen endacak, në mesin e të cilëve edhe mace.

PSP KA PASUR TË DREJTË NË RASTIN E EDMOND THEMELKOS

Shkup, 11 dhjetor - Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë më 6 nëntor të këtij viti solli aktvendim me të cilin e zbut Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë i dorëzuar nga Prokuroria Speciale Publike, ndërsa me të cilin është konfirmuar se me vendimin e Këshillit Penal të Sektorit për krim të organizuar dhe korrupsion pranë Gjykatës Themelore Shkupi 1, lidhur me privimin nga liria të Edmond Themelkos, është shkelur ligji në dobi të të akuzuarit, njofton PSP në kumtesën e djeshme. Sipas PSP-së, me aktvendimin e Gjykatës Supreme është konfirmuar vendimi i gjykatësit të procedurës paraprake nga 12 shkurti i vitit 2016, me të cilin është konfirmuar se është e ligjshme urdhëresa e kësaj Prokurorie Publike për privim nga liria të Themelkos. Njëherësh, Gjykata Supreme gjeti se PSP është kompetente për rastin konkret, se ka autorizime të japë urdhër për privim nga liria, të udhëheqë me procedurë para-hetuese, t'ua orientojë aksionet organeve kompetente dhe se e ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjithashtu, me aktvendimin vërehet se është i gabueshëm qëndrimi i Këshillit Penal se urdhër për privim nga liria mund të caktojë vetëm gjykata kompetente, por saktëson, se e drejtë themelore dhe detyrë e prokurorit publik është që t'i ndjekë kryerësit e veprave penale dhe t'i ndërmerr masat dhe aksionet e nevojshme. Si përkujtim, më 12 shkurt të vitit 2016, me urdhër të prokurorit publik të PSP-së, Themelko është privuar nga liria, ndërsa gjykatësi i procedurës paraprake është kërkuar të shqiptohet masë paraburgim. Gjykatësi ka konfirmuar se është i ligjshëm privimi nga liria i Themelkos, megjithatë nuk ka shqiptuar masë paraburgimi, por masë kujdesi. Ndaj këtij vendimi të gjykatësit të procedurës paraprake mbrojtja e Themelkos dorëzoi ankesë, ndërsa Këshilli Penali të njëjtës gjykatës

më 19 shkurt të vitit 2016 e pranoi ankesën dhe e shfuqizoi vendimin e gjykatësit të procedurës paraprake duke konfirmuar se është i paligjshëm privimi nga liria.

Derivatet shtrenjtohen për gjysmë denari

Shkup, 11 dhjetor - Derivatet nga e hëna në mesnatë shtrenjtohen për gjysmë denari për një litër, vendosi sot Komisioni Rregullator për Energjetikë (KRRE). Me vendimin bëhet rritje e çmimeve rafinerike dhe për shitje me pakicë të derivateve të naftës në mesatare për 1.09, gjegjësisht për 0.74 për qind. Çmimi i ri me pakicë i EUROSUPER BS-95 është 66 denarë për një litër, EUROSUPER BS-98 do të sitet për 67.5, EURODIZEL (D-E V) për 54.5, ndërsa Vaji ekstra të lehtë për amvisëri (EL-1) për 43 denarë për një litër. Me vendimin e KRRE-së për 0,02 denarë për një kilogram ulet çmimi për shitje me pakicë i mazutit M-1 NS dhe do të kushtojë 28.333 denarë. Si arsye për rritje të çmimeve për shitje me pakicë i derivateve të naftës nga KRRE i theksojnë për 2,03 për qind çmimin e lartë mesatar të naftës së papërpunuar në tregun botëror në 14 ditët e kaluara dhe për 0.517 për qind kursin më të ulët të dollarit në krahasim me denarin.

Shkup, 33 aksidente me 12 të lënduar

Shkup, 11 dhjetor - Pesëmbëdhjetë persona janë lënduar më lehtë në 12 prej gjithsej 33 aksidenteve të trafikut të regjistruara gjatë katër viteve të fundit në rajonin e SPB Shkup. Në 21 aksidente është shkaktuar dëm material. Nga MPB-ja informojnë se dje policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundërvajtjeve. Njëqind e nëntëdhjetë shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, nëntë shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritën e kuqe të semaforit, dhe pesë shoferë për rreshtim jo të drejtë. Nga komunikacioni janë përjashtuar pesë shoferë të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit dhe 35 shoferë që kanë drejtuar automjetin pa e marrë të drejtën e drejtimit të automjetit motorik. Gjithashtu, nga komunikacioni janë përjashtuar 30 automjete me kalimin e afatit të lejes së qarkullimit dhe 30 automjet me defekte teknike. Është sanksionuar edhe një këmbësor i cili ka kaluar jashtë vijave të shënuara për këmbësorë. Janë hasur 226 automjete të parkuara në mënyrë të papërshtatshme. Me ndihmën e automjetit special karrotrec, janë larguar 121 automjete.

KREDITË ME GARANCI

NË MAQEDONI, 106.438 BANESA NËN HIPOTEKË

Në pjesën më të madhe hipotekat i mbajnë bankat, ndërsa ekzistojnë edhe raste shumë më të vogla të tyre që i mbajnë kompanitë apo personat privat. Banesat më së shpeshti lihen si garanci gjatë marrjes së kredisë, ndërsa vendosen nën hipotekë në periudha të ndryshme

Koha — Fisnik PASHOLLI

Shkup, 11 dhjetor - Në katër vitet e fundit në Maqedoni, është dyfishuar numri i banesave nën hipotekë. Të dhënat e Kadastrës tregojnë se në vitin 2013, nën hipotekë kanë qenë të vendosura 56.169 banesa, ndërsa katër vite më vonë, kjo shifër është rritur në 106.438 banesa. Gjysma e banesave në hipotekë gjenden në Shkup, ku si garanci për kredinë bankare janë 47.414 banesa që paraqet 15 përqindëshin e të gjithë banesave në kryeqendrën e Maqedonisë, ku në kadastër janë shënuar 301.853 banesa. Në Manastir, nën hipotekë janë vendosur 6670 banesa, ndërsa në vendin e tretë me 4872 banesa nën hipotekë gjendet Tetova. Strumica me 4688 banesa, Ohri me 4399, Kumanova me 4222, Shtipi me 3532, Prilepi me 3425, Kavadari me 3300 dhe Gjevgjelia me 3211 renditen në top dhjetë qytetet me më shumë banesa nën hipotekë. Numër të lartë të banesave nën hipotekë kanë edhe Gostivari me 2636 dhe Struga me 2156 banesa. Në pjesën më të madhe hipotekat i mbajnë bankat, ndërsa ekzistojnë edhe raste shumë më të vogla të tyre që i mbajnë kompanitë apo personat privat. Banesat më së shpeshti lihen si garanci gjatë marrjes së kredisë, ndërsa vendosen nën hipotekë në periudha të ndryshme. Tek disa prona të patundshme, hipotekat qëndrojnë edhe më shumë se dhjetë vite sa nevojitet të paguhet një kredi mesatare banesore. Qytetet me numrin më të vogël të banesave nën hipotekë janë Makedonski Brodi 105, Kratova me 119, Demir Hisari me 126, Krusheva me 225, Demir Hisari me 126 dhe Dibra me 369 banesa. Në vitet e fundit rritet huazimi i qytetarëve në banka për kredi banesore dhe, si rrjedhojë, edhe numri i banesave nën hipotekë. Gjithashtu, në totalin e kredive banesore hyjnë edhe objektet që janë në ndërtim e sipër, për të cilat investitorët kanë kërkuar kredi për ndërtim. Rritjen e kredive banesore e dëshmojnë edhe statistikat e Bankës Popullore të Maqedonisë. Sipas tyre, në tetor të këtij viti për qytetarët janë miratuar kredi banesore në vlerë prej 38,268 milionë denarë. Kjo shumë paraqet një rritje të konsiderueshme në raport me dhjetorin e vitit 2015 kur vlera e tyre ishte 30,287 milionë denarë. E shprehur në të holla, statistika tregon se në fund të vitit 2015, bankat kanë miratuar kredi banesore prej afër 500 milionë euro, që paraqet një dyfishim të vlerës së kredive banesore në raport me 260 milionë euro në vitin 2010. Njëherazi është rritur vlera e tyre prej 260 milionë euro para shtatë vitesh në afër 620 milionë euro në vitin 2017. Nga kompanitë ndërtimore thonë se shpesh banesat vendosen për lloje të ndryshme të borxheve bankare, por megjithatë shtojnë se kjo paraqet problem vetëm në rast të pamundësisë së kthimit të rregullt të kësteve mujore, kur ekziston mundësia që të aktivizohet hipoteka. Bile, në vitet e fundit rritet gjithnjë e më shumë numri i qytetarëve që i blejnë banesat me kredi, duke i vendosur ato njëherazi nën hipotekë. Pas kredive konsumatore, më të kërkuarit nga ana e konsumatorëve janë kreditë banesore. Ato shquhen me afat të gjatë të kthimit prej 10-30 vjet, shumën e lartë që lidhet me vlerën e pronës së patundshme dhe aftësisë së kërkuesit së kredisë për pagesën e rregullt mujore në bankë.

Publicitet

"Shpallje publike për themelim të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar në Sekretariatin për legjislacion të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25, 13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 167/15, 27/16 dhe 134/16), shpallja përfshinë punësim të 1 (një) personi për kohë të caktuar për periudhë deri më 31.12.2018 i cili do të punojë në Sekretariatin për legjislacion të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë edhe atë në vendin e punës **Bashkëpunëtor – asistent për mbështetje teknike-operative të Sekretariatit.**

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim të nevojshme për kryerje të detyrave:

1. Lloji i arsimit: së paku 180 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar nga sfera e shkencave ekonomike, shkencave juridike ose administratë publike;
2. Përvojë pune: së paku 1 vjet përvojë pune në profesion;
3. Kualitetet personale: njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë, kompetenca të tjera të posaçme të punës të përcaktuara në aktin për sistematizim të vendeve të punës për vendin përkatës të punës, si dhe njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropian të A2 nivelit të CEFR, gjegjësisht KET, IELTS me maksimum 3 pikë, BULATS, ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë, ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë, ose DELF, TCF, TEF, ose Gete Certifikatë.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, gjegjësisht më së voni deri më 19.12.2017, deri në ora 16:30, ndërsa zgjedhja e kandidatëve do të realizohet më së voni deri më 22.12.2017.

Orari javor i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte, 8 orë pune (08:30 – 16:30), ndërsa neto pagesa bazë është 22.593,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen krahas biografisë së shkurtë, kandidatët janë të obliguar që të parashtrojnë edhe dëshmi përkatëse në origjinal ose kopje, në pikëpamje të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme edhe atë:

- Diplomë për shkallë të mbaruar të arsimit që kërkohet për vendin e punës;
- Vërtetim për përvojën e punës që kërkohet për vendin e punës;
- Certifikatë për njohje të gjuhës angleze, frënge ose gjermane dhe aftësi kompjuterike;
- Shtetësi;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë gjyqësore për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Dokumentet e kërkuara parashtrohen me zarf të mbyllur me shenjë "Të mos hapet" në adresën në vijim: Sekretariati për legjislacion i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë bul. "Sv. Kiril i Metodi" nr 54, Shkup (me shenjë "Për shpallje").

Fletëparaqitja dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, jo i plotë dhe i pakompletuar nuk do të merret parasysh gjatë shqyrtimit. Kandidatët me dokumentacion të rregullt dhe të cilët i përmbushin kushtet e theksuara do të ftohen në intervistë në Sekretariatin për legjislacion.

Sekretariati për legjislacion i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë,
Kontakt telefoni 02/3228-203

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune Tekst i pastruar (Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15) dhe nenit 77, 80, 82, 83, 84 dhe 85 të Ligjit për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 14/14, 41/14 и 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16 dhe 67/17) dhe Pëlqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-14277/2 të datës 01.12.2017, u. d drejtori i SHFK "Tosho Arsov" – Shtip më datë 12.12.2017 publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për pranim të punëtorëve për kohë të caktuar të punës deri më
31.08.2018

1. Një mësimdhënës të etikës së religjioneve me 8 orë mësimore në javë, neto pagesa 8.257,00 den.
2. Një mësimdhënës praktikant të edukatës muzikore me 12 orë mësimore në javë në SHP Iagj. Makedonka, neto pagesa 12.386,00 den.
3. Një mësimdhënës të etikës me 4 orë mësimore në javë, neto pagesa 4.128,00 den.
4. Një mësimdhënës praktikant të gjuhës dhe kulturës vllehe me 6 orë mësimore në javë, neto pagesa 6.193,00 den.
5. Një mësimdhënës praktikant të gjuhës gjermane me 14 orë mësimore në javë, neto pagesa 14.450,00 den.
6. Një mësimdhënës praktikant të gjuhës maqedonase me 2 orë mësimore në javë në SHP f. Poçivallo, ku mësimi realizohet në paralele të kombinuara prej kasës së I deri në klasën e V m mësim në gjuhën turke, neto pagesa 2.064,00 den.
7. Një mësimdhënës praktikant të gjuhës angleze me 3 orë mësimore në javë në SHP f. Poçivallo, ku mësimi realizohet në paralele të kombinuara prej kasës së I deri në klasën e V m mësim në gjuhën turke, neto pagesa 3.096,00 den.
8. Një mësimdhënës të inovacioneve me 5 orë mësimore në javë, neto pagesa 5.161,00 den.
9. Një mësimdhënës të mësimit klasor në SHP f. Çardaklija me orar të plotë të punës 20 orë mësimore në javë, neto pagesa 20.644,00 den.
10. Një mësimdhënës praktikant të informatikës (informatikë 12 orë mësimore dhe projekte nga informatika 8 orë mësimore), me orar të plotë të punës 20 orë mësimore në javë, neto pagesa 20.644,00 den.
11. Një mësimdhënës të praktikant të biologjisë, kimisë dhe shkencave natyrore me orar të plotë të punës 20 orë mësimore në javë, neto pagesa 20.644,00 den.
12. Një mësimdhënës praktikant të arsimit teknik me 8 orë mësimore në javë, neto pagesa 8.257,00 den.
13. Një mësimdhënës të fizikës me 2 orë mësimore në javë, neto pagesa 2.064,00 den.
14. Një bibliotekist praktikant me orar të plotë të punës 40 orë pune në javë, neto pagesa 20.644,00 den.

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në pajtim me Ligjin për arsim fillor dhe normativin për kuadrin mësimor për shkollë fillore të sjellë nga Byroja për zhvillim të arsimit të Republikës së Maqedonisë si dhe kushtet e parapara në Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës.
Nëse për vendet e lartpërmendura të punës prej numrit 1 deri në numrin 14 nuk paraqitet kandidat me arsim përkatës sipas ligjit dhe normativit, do të pranohet kandidati i cili ka mbaruar arsimin jopërkatës sipëror, më së afërmi me normativin.
Shuma e neto pagesës për mësimdhënësin praktikant është 80% e pagesës së mësimdhënësit, bashkëpunëtorit profesional gjegjësisht edukatorit, duke konsideruar nga dita e emërimit të mentorit.
Orari i punës së mësimdhënësve4 prej klasës së I deri në klasën e IX është prej ditës së hënë deri ditën e premte, i organizuar në ndërrime, ndërrimi i parë prej ora 07.00 deri në ora 13.00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 13.00 deri në ora 19.00.
Kandidatët nga pika 1 të kenë të mbaruar Fakultetin teologjik ortodoks dhe të kenë të mbaruar Fakultetin pedagogjik, cikël të dytë të studimeve, program studimor metodikë të mësimit të arsimit religjioz (studime specialistike).
Kandidatët nga pika 2 të kenë të mbaruar Fakultetin e edukatës muzikore grupi për teori muzikore dhe pedagogji ose grup tjetër me përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike.
Kandidatët nga pika 3 të kenë të mbaruar Fakultetin filozofik – instituti filozofi.
Kandidatët nga pika 4 të kenë të mbaruar Fakultetin pedagogjik – mësimi klasor ose Fakultet të shkencave arsimore grupi mësimi klasor dhe të posedojnë Certifikatë për trajnim të mësimdhënësve në gjuhën vllehe dhe certifikatë – vërtetim për përcjellje të kursit të gjuhës, letërsisë dhe kulturës vllehe.
Kandidatët nga pika 5 të kenë të mbaruar Fakultetin filologjik – gjuhë dhe letërsi gjermane - drejtimi mësimor.
Kandidatët nga pika 6 të kenë të mbaruar Fakultetin filologjik – gjuhë dhe letërsi maqedonase – drejtimi mësimor.
Kandidatët nga pika 7 të kenë të mbaruar Fakultetin filologjik – gjuhë dhe letërsi angleze – drejtimi mësimor.
Kandidatët nga pika 8 të kenë të mbaruar PSP – studime të mbaruara për mësimdhënës dhe studime të tjera VII/1 gjegjësisht VIA (240) SETK me përgatitje përkatëse pedagogjike-psikologjike dhe metodike, me trajnim (certifikatë) të mbaruar për inovacione dhe sipërmarrësi.
Kandidatët nga pika 9 të kenë të mbaruar Fakultetin pedagogjik – mësimi klasor ose Fakultetin për shkenca arsimore grupi mësimi klasor.
Kandidatët nga pika 10 të kenë të mbaruar studime nga informatika drejtimi mësimor ose studime nga sfera e informatikës VII/1 gjegjësisht VIA (240) SETK, studime akademike katërvjeçare, me përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike me 30 SETK të arritura – (me pesë provime të dhëna).
Kandidatët nga pika 11 të kenë të mbaruar Fakultetin matematiko-natyror, programi studimor biologji dhe kimi me titull profesional profesor i biologjisë dhe kimisë në arsim fillor.
Kandidatët nga pika 12 të kenë të mbaruar Fakultetin pedagogjik profesor të informatikës dhe arsimit teknik, studime interdiciplinore profesor i arsimit teknik ose akademi pedagogjike mësimdhënës të arsimit teknik.
Kandidatët nga pika 13 të kenë të mbaruar Fakultetin matematiko-natyror studime nga fizika, studime nga fizika dhe matematika, studime nga fizika dhe kimia drejtimi mësimor ose studime të fizikës me përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike shkalla VII/1 gjegjësisht VIA (240) SETK.
Kandidatët nga pika 14 të jenë bibliotekistë të diplomuar me (240) SETK.
Kandidatët duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter.

- Lutje
- Diplomë ose certifikatë për arsim të mbaruar përkatës.
- Certifikatë të shtetësisë.
- Certifikatë për provim të dhënë profesional (vetëm për praktikantët).
- Certifikatë për përgatitje të arritur pedagogjike-psikologjike dhe metodike me 30 SETK të arritura – (me pesë provime të dhëna), për kandidatët që nuk janë në drejtimin mësimor.

Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
Shpallja zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 15 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.
Kontrollimi për njohje të gjuhës maqedonase për kandidatët të cilët konkurrojnë për vendin e punës prej numrit 1 deri në numrin 14 do të bëhet më datë 20.12.2017 në ora 12.00 në SHFK "Tosho Arsov" – Shtip.
Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohen deri në arkivin e shkollës ose në adresën SHFK "Tosho Arsov" – Shtip, rr. "BUL. JNA" pn.

SHFK "Tosho Arsov" – Shtip
U. D Drejtor Frosina Maxharova

KAOSI NË KOMUNIKACION

NUMËR ENORM I VETURAVE NË TETOVË

Nga policia e Tetovës jozyrtarisht kanë njoftuar se në Tetovë dhe rrethinë mesatarisht çdo shtëpi ka nga dy vetura dhe kjo i kontribuon në masë të madhe kaosit në komunikacion

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 11 dhjetor - Në këtë periudhë parafestive komunikacioni në qytetin e Tetovës pothuajse është paralizuar tërësisht. Kolona të gjata të veturave vërehen në rrugët kryesore të qytetit, ndërsa për të arritur nga njëri skaj i qytetit në tjetrin, nevojiten më shumë se 30 minuta. Bulevardet kryesore në qytet, në këtë periudhë janë të stërmbushura me vetura, kurse pritjet në kolona janë të gjata. Numri i lartë veturave nëpër këto rrugë, ka bërë që të krijohen tollovi, pritje të gjata dhe nervozizëm te shoferët. Ndërkaq, Policia e Tetovës ka njoftuar se këtyre ditëve ka shtuar prezencën e tyre nëpër rrugë për të tejkaluar këtë situatë.

"Ditëve të fundit kemi rritur prezencën e policëve nëpër rrugët e Tetovës, të cilët në mënyrë konkrete dhe profesionale marrin masa që komunikacioni të zhvillohet pa pengesa dhe të ketë një siguri më të madhe në rajonin qendror të qytetit dhe në udhëkryqe. "Por, për shkak të kapacitetit të kufizuar të rrugëve dhe të pamjaftueshëm për një numër kaq të madh të veturave dhe hapësirave të pakta për parkim, në këtë kohë krijohen tollovi, duke pasur parasysh se në këtë kohë vijnë një numër i madh i mërgimtarëve", thotë zëdhënësi i Policisë së Tetovës, Marjan Josifovski.

Së këndejmi, policia apelon tek drejtuesit e makinave që të respektojnë shenjat e komunikacionit dhe urdhrat e policëve që rregullojnë komunikacionin, të mos parkohen në vende ku nuk është lejuar parkimi dhe të tregojnë nivel të lartë të kulturës në komunikacion. Ndërkohë, kësaj situate me kaosin në komunikacion i ka ndihmuar edhe pastrimin i pjesërishëm i vendparkimeve nga bora dhe mungesa e parkingjeve në krahasim me numrin e veturave që qarkullojnë në ditë në Tetovë. Më keq situata është në bulevardin Ilinden dhe Marshall Tito, kurse tollovitë dhe pritjet e gjata prezent janë edhe në afërsi të udhëkryqit për në Bërvenicë. Aspak më mirë situata me kaosin në komunikacion, nuk është në pjesën tjetër të qytetit në afërsi të shkollës së muzikës në dalje të Tetovës për në rrugën regjionale që çon në vendkalimin kufitar Jazhincë. Me këtë kaos të komunikacionit rrugor në Tetovë përballen mijëra drejtues të makinave çdo ditë, kurse krahas policisë rrugore vërehet edhe automjeti i merimangës. Nga Sektori për komunikacion, rrugë dhe tokë ndërtimore, pohojnë se tollovitë në komunikacion janë pasojë e ardhjes së mërgimtarëve në vendlindje për këtë kohë feste. "Këtyre ditëve vërehet se ka më shumë automjete në rrugët e Tetovës të cilët krijojnë edhe tollovi. Kjo situatë është prezent dhe e zakonshme në këtë kohë, pasi që vijnë edhe mërgimtarët për pushimet festive. Automjeti i merimangës është në teren por kjo nuk mund të ndihmojë në këtë situatë. Ka shumë vetura të cilët parkohen në vende të palejuara përskaj trotuareve ku frekuentimi është tepër i madh dhe kaosi është i paevitueshëm", thonë nga Sektori për Komunikacion në Tetovë. Sipas policisë, ata që do të injorojnë këto apele do të përballen me dënime dhe padi për kundërvajtje. Nga policia e Tetovës jozyrtarisht kanë njoftuar se në Tetovë dhe rrethinë mesatarisht çdo shtëpi ka nga dy vetura dhe kjo i kontribuon në masë të madhe kaosit në komunikacion. Policia ka bërë të ditur se ka shtuar kontrollet nëpër rrugët e qytetit për të mbarëvajtur qarkullimin gjatë kësaj periudhe në rrugët më të frekuentuara të Tetovës.

UT ndan bursa për studentët e shkëlqyer

Tetovë, 11 dhjetor - Universiteti e Tetovës në mënyrë solemne studentëve ekselent të ciklit të dytë të studimeve të magjistraturës, ua ndau vendimet për lirim nga participimi. Studentët e ciklit të dytë të magjistraturës fillimisht u pritën në takim nga rektori i Universitetit të Tetovës, Vullnet Ameti, prorektori për Arsim, Reshat Qahili dhe përgjegjësi i Zyrës për arsim, Ibrahim Neziri. Rektori i Universitetit të Tetovës tha se në përputhje me Ligjin për arsim të lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe me vendim të Senatit, sot ndahen bursat universitare për studentë të ciklit të dytë të studimeve në vitin akademik 2017/18. "Universiteti i Tetovës edhe njëherë dëshmoi se është një ndër institucionet më serioze në Republikën e Maqedonisë dhe në rajon, duke respektuar Vendimin e Senatit të Universitetit të Tetovës, që e solli në vitin 2013 që studentët ekselentë universiteti t'i vlerësojë dhe t'i çmojë duke u dhënë bursa për studimet e ciklit të dytë, magjistraturës. Kjo është një vlerë e jona institucionale dhe akademike që në një të ardhme shumë të shpejtë këta ekselentë të bëhen promotor të lëvizjeve shoqërore dhe institucionale në Republikën e Maqedonisë. Dashtë zoti që këto së shpejti t'i bashkëngjiten klasës akademike, sektorit të biznesit dhe të jenë drejtues të institucioneve të ndryshme në vendin tonë. Universiteti i Tetovës edhe në të ardhmen do të vazhdoj që studentët ekselent t'i stimulojë dhe t'i mbështes në realizimin e ideve dhe projekteve inovative të tyre", tha Vullnet Ameti. Studentët ekselentë shprehen falënderime dhe mirënjohje ndaj rektorit Vullnet Ameti dhe udhëheqjes së Universitetit të Tetovës për mbështetjen e tyre që i kanë dhënë këtij akti që studentët më të dalluar në mesatare, të lirohen nga pagesa e participimit të semestrit. *(U.H.)*

Të premten hapet Zyra për mërgimtarët

Gostivar, 11 dhjetor - Më 15 dhjetor (e premte), do të hapet Zyra për mërgimtarët pranë Komunës së Gostivarit. Kjo zyrë do të funksionojë në formën e një sporteli, ndërsa orari i punës do të zgjasë prej orës 08:00 deri në orën 20:00. Hapja e kësaj zyre bëhet me qëllim që të lehtësojmë për të gjithë mërgimtarët tanë në maksimumin e mundshëm procedurat administrative pranë Komunës, Policisë apo Gjykatës. Kjo zyrë do të qëndrojë e hapur deri më 15 janar të vitit 2018 për t'u rihapur sërish në kohën e verës kur është sezoni i fluksit të mërgimtarëve.
Zyra do gjendet pranë Qendrës Informative të Komunës.

Shqiptarët pas 40 vitesh kërkojnë hisen e vetë

Manastir, 11 dhjetor - Në kuadër të ndryshimeve kadrovike nëpër institucionet shtetërore, e në këtë kontekst edhe në shkollat fillore dhe ato të mesme, në Manastir zhvillohen me ritëm të ngadalësuar. Kjo bëhet me qëllim që pushtetarët lokal t'i shmangen etiketimit me epitetin më të papëlqyer "revanshizëm". Pas katër dekadash, shqiptarët definitivisht ngritën zërin e arsyes që pas plotë dyzet vitesh të kërkojnë hisen e vete në këtë shkollë, në të cilën dekada me radhë veprojnë edhe shumë paralele me mësim në gjuhën shqipe. Drejtori i fundit shqiptarë ka qenë para 40 vitesh kur shkolla shqipe mbante emrin "Nikolla Teslla". Asaj kohe drejtoresha ka qenë profesoresha e gjuhës shqipe, Shahe Sulejmani. Pensionimi i saj ishte edhe fundi i arsimit shqip, nga shkolla, për shkak të pengimit të indoktrinimit të nxënësve me nacionalizëm dhe separatizëm shqiptarë, u integrua me shkollën aktuale. Që të përfshihet periudha që nga integrimi e deri në ditët e sotme, nevojitet hapësirë dhe kohë të pakufizuar. Thjeshtë, edhe nxënësit edhe arsimtarët kanë përjetuar golgotën më të madhe.

Paralajmërimi i barazisë së plotë nga ana e kryeministrit Zaev dhe, si pasojë e këtij premtimi, numër i madh i votave të votuesve shqiptarë, edhe në Manastir u derdhën në skonton e LSDM-së. Ky edhe është shkaku i vërtetë që arsimtarët shqiptarë, por edhe prindërit e nxënësve ngritën zërin që në këtë shkollë, më në fund, të emërohet një shqiptar. Për momentin, punët kanë mbetur status kuo. Në lojë, sipas rrëfimeve të arsimtarit të matematikës Izet Jusufi dhe njëri nga pretendentët për postin e drejtorit i favorizuar nga arsimtarët shqiptarë, kanë mbetur dy kandidatë, ndërmjet të cilëve edhe zhvillohet gara e madhe. Të dy palët nuk lëshojnë pe, por sipas parashikimeve të Izetit, epilogu me siguri se do ishte kandidati maqedonas të jetë drejtor, kurse kandidati shqiptarë të pozicionohet në pozicionin e zëvendësdrejtorit me të gjitha ingerencat e drejtorit. Ky do të ishte kompromisi më objektiv, konstaton edhe Izet Jusufi. *(Q.H.)*

Labirintet e ëndrrave të zotit Daçiç

Nga **Leonidha MËRTIRI**

Njohja e shtetit të pavarur të Kosovës nga Madagaskari, këto ditë u shoqërua nga deklarata e insinuata, copy-paste, sikurse është bërë zakon tashmë, të zotit Ivica Daçiç. Sikur ato të ishin të vetmet e tij, ndoshta nuk do t'u ktheheshim në këtë shkrim. Është vijimësia e tyre e njohur, linja e njëjtë që ato ruajnë. Ish-ministri i djeshëm i garniturës së Millosheviçit, aktualisht zëvendëskryeministër i parë dhe ministër i Punëve të Jashtme të Serbisë, këtë radhë me një ton edhe më të prerë, përsëriti se shteti i Kosovës nuk ekziston. Duke shkuar dhe më tej, sipas tij, shqiptarët e Kosovës duhet të ikin në vendin e tyre në Shqipëri, se ata janë një pakicë brenda Serbisë. Duket se është po ajo ambicie, po ai admirim, ndjekës i zellshëm i politikës së Millosheviçit, kryeministri i viteve të fundit, sot numri dy i qeverisë dhe kryediplomat i Beogradit, si dhe lideri kryesor i Partisë Socialiste Serbe. Ndryshimi i vetëm i sotëm: make up-i apo shtirja e tij, tani si europian. Duket, Daçiç nuk mund të ndahet nga betimi i kolegut tjetër të tij, ministër i Mbrojtjes në po këtë qeveri, sipas deklaratës publike të të cilit "sa të jetë gjallë, do të vazhdojë këtë rrugë". Edhe më tej, për shefin e diplomacisë serbe, vetëm tanket mund t'i detyrojnë serbët të njohin pavarësinë e Kosovës. Por si mund të integrohesh në familjen e madhe europiane, pa pasur marrëdhënie të mira, në radhë të parë me fqinjët? Anëtarësimi në BE nuk mund të kuptohet pa këtë, përkundrazi.

Ndërkohë, Marrëveshja midis Kosovës dhe Serbisë, e muajit prill 2013, i shërben normalizimit të marrëdhënieve mes tyre. Një qëndrim i hapur dyfaqesh, standardesh të dyfishta, shoqëruar nga një histeri e jashtëzakonshme për mospranimin e Kosovës, si shtet sovran dhe i pavarur, nuk mund ta inkurajojë dialogun e filluar dhe, për rrjedhojë, të jetësojë Marrëveshjen e mësipërme. Ecejaket e Ivica Daçiç, me labirintet e ëndrrave të tij, janë shtuar kohët e fundit, sidomos në vendet që e kanë njohur Kosovën, me të vetmen ëndërr, për të rishqyrtuar vendimet që kanë marrë. Edhe në një takim të ditëve të fundit me kryeministrin e Guinea-Bissau në Beograd, u përsërit ky qëndrim, madje Daçiç nuk ngurroi t'i bëjë jehonë mosnjohjes së Kosovës nga ky vend, duke e tërhequr atë, kur Guinea- Bissau është shteti i 74-t që e ka njohur atë mbi gjashtë vjet më parë. Ai flet dhe merr përsipër në emër të pesë vendeve anëtare të Bashkimit Europian që nuk e kanë njohur Kosovën, se ato kurrë nuk kanë për ta njohur atë. Ndaj dhe prania e tij në Greqi, Qipro, Spanjë, Sllovaki, Rumani do të jetë edhe më e shpeshtë dhe që flet për raporte të mira të Serbisë me këto vende. Në këtë mënyrë, qëndrimet e Daçiç vazhdojnë të bëhen objekt i propagandës së tij kundër shqiptarëve, të evokuara herë pas here të njëjtat gjëra, madje, deri në rrugët e vjetra të absurdit, që dhe më tej të shërbejnë si narkotikë për të mbajtur ndezur nacionalizmin primitiv të serbëve. Ato synojnë gjithashtu të retushojnë momente të caktuara të realiteteve të njohura të kësaj politike.

Ëndrrat e stisura të Daçiç, sikurse duket, marrin krah, së pari, nga qëndrimet e njohura të Rusisë, që mbajnë dhe zgjerojnë në të njëjtën kohë, frymëmarrjen e forcave ultranacionaliste në vend, me ambicien gjithashtu për një zë të fuqishëm të interesave të saj politike dhe strategjike, por edhe të Serbisë në Ballkan. Kësaj politike i bën jehonë dhe intervista e këtyre ditëve e ambasadorit rus në Beograd, kur pohon se "për sa i përket Kosovës, sipas të gjitha ligjeve dhe rregullave ndërkombëtare, Kosova mbetet pjesë e Serbisë dhe ne e mbështetim integritetin serb". Qëndrime, si këto të ministrit të Jashtëm të Serbisë, Ivica Daçiç, dhe të politikës serbe në përgjithësi, dashur pa dashur, sikur inkurajohen çuditërisht dhe nga disa aleanca të tjera. Kështu, pas tri ditësh, në Beograd do të mblidhen kryeministrat e katër vendeve, tre prej të cilëve anëtarë të BE-së: Serbisë, Bullgarisë, Greqisë dhe Rumanisë, takim, për të cilin u vendos vetëm dy muaj më parë në Varna, me të njëjtin format, ku nismëtare ishte Greqia, për të mos mbetur prapa afishimit të rolit të saj parësor në rajon.

Një takim ky, i ngarkuar jo me pak pikëpyetje, që, për habi, lihen përsëri mënjanë vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Por dhe që të krijon përshtypjen e një gare, të veprimit në të njëjtën pistë me Takimin e Berlinit, pas të cilit janë zhvilluar dhe tri takime të tjera për integrimin europian të rajonit tonë. Përballë qëndrimeve të mësipërme, mendojmë që Bashkimi Europian nuk duhet të flasë me gjysmë zëri, duke mos e zgjatur tolerancën e tij të tepruar ndaj veprimeve të Serbisë.

> **Një qëndrim i hapur dyfaqesh, standardesh të dyfishta, shoqëruar nga një histeri e jashtëzakonshme për mospranimin e Kosovës, si shtet sovran dhe i pavarur, nuk mund ta inkurajojë dialogun e filluar dhe, për rrjedhojë, të jetësojë**

Ndryshe nuk shpjegohet ky lloj qëndrimi, teksa Daçiç e shikon BE-në si të tillë ndaj Kosovës, që nuk mund të përcaktojë pavarësinë e saj dhe as atë që Serbia të njohë këtë pavarësi. Shteti shqiptar nga ana e vet, diplomacia e tij nuk mund të jenë vakët para këtij realiteti, nga droja se mos na zbehen marrëdhëniet. Kjo nuk e pengon aspak dëshirën, synimin e mirë për marrëdhënie sa më të mira me vendet fqinje dhe ato të rajonit në tërësi. Inferioriteti, mungesa e guximit, në të vërtetë, do t'i topitnin ato. Të mos harrojmë, është fjala për Kosovën, për interesat e saj, të kombit tonë në tërësi.

(panorama)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS

Koha
E përditshme informative
www.koha.mk

Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhesë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi:"Adria Media Ballkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 11 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: **Lirim DULLOVI** | Kryeredaktor: **Vedat MEMEDALIU** | Ndihmëskryeredaktor: **Evis HALILI** | Redaktorë: **Shkëlzen HALIMI** | Redaktor teknik: **Halil BERISHA**
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: **Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221**
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve **Inter Partes** - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

E pamundur ta bashkosh apo ta ndash. Fati i qytetit-botë



Nga **Wlodek GOLDKORN**

E pamundur ta bashkosh, e pamundur ta ndash. Mbetet vetëm të shpresojmë për ndërhyrjen e të Plotfuqishmit, por edhe ai mund të hiqet mënjanë, për shkak të tepricës së emocioneve dhe interpretimeve të njerëzve. Thuhet se në qershor të vitit 1967, Moshe Dayan, ministri i atëhershëm i Mbrojtjes i Izraelit, u bëri kolegëve në qeveri pyetjen: "A kemi vërtet nevojë për këtë Vatikan?" Ai e kishte fjalën për Qytetin e Vjetër dhe kilometrin katror, ku vendet e shenjta të tre monoteizmave janë të përqendruara në Jerusalem. Vetë kryeministri Levi Eshkol hezitoi para se të jepte urdhrin për të pushtuar atë pjesë toke. Atë që ndodhi e dimë: është histori. Por edhe në vitin 1993, Shimon Peres, atëherë ministër i jashtëm dhe arkitekt i marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, mes Izraelit dhe Organizatës Çlirimtare të Palestinës, i pyetur nga reporteri i "L'Espresso" se çfarë duhej bërë me kilometrin katror, ku ndodhen Mali i Tempullit, Murit i Lotëve dhe kisha e Varrit të Shenjtë, tha: "Ne duhet t'ia transferojmë sovranitetin Perëndisë." Ai donte të thoshte: ndonjëherë arsyeja duhet t'i dorëzohet simboleve.

E lehtë ta thuash, vetëm se njerëzit, pothuaj 900 mijë banorët e atij që Donald Trumpi ka njohur si kryeqytet të shtetit hebraik, duke u vënë kundër botës mbarë, jetojnë jo vetëm me simbole dhe ëndra shpengimi (viti i ardhshëm në Jerusalem do të thotë viti i ardhshëm i Mesias). Realiteti i qytetit të zgjedhur si banesë e Zotit është i përbërë nga ndarje dhe konflikte. Që nga struktura e tij Jerusalemi, më shumë se një aglomerat urban (një shesh, një qendër pushteti shekullore dhe një spirituale, rrugë tregtare dhe vendbanime), është jë tërësi ishujsh dhe enklavash: secila me zakonet e veta dhe në luftë me të tjerat. Nuk është vetëm faji i pushtimit ushtarak. Qyteti ishte i ndarë që nga gjysma e dytë e Tetëqindës, kohë kur fuqitë evropiane rizbuluan në zemër të Perandorisë dekadente otomane, vlerën e tij simbolike dhe gjeopolitike. Investuan para dhe kulturë, dërguan misionarë dhe arkeologë, spiunë dhe tregtarë, ndërtuan kisha dhe vendbanime. Secila, Rusia dhe Gjermania, Austro-Hungaria dhe Britania e Madhe, për llogari të vet dhe kundër të tjerëve; kaq shumë enklava të vogla. Dhe sipas librit të Vincent Lemire, "Jerusalemi: Historia e qytetit-botë", edhe gjatë luftës së vitit 1948, si udhëheqësit hebrenj, ashtu edhe ata arabë synonin ndarjen e qytetit, dhe jo pushtet mbi gjithë Jerusalemin. Përfundoi me dëbimin e hebrenjve nga lagja e tyre në Qytetin e Vjetër, dhe me eksodin e palestinezëve nga pjesa perëndimore. Nëntëmbëdhjetë vjet pas atij konflikti, në vitin 1967, izraelitët pushtuan të gjithë qytetin. Zgjeruan kufijtë, përfshinë mbi njëzetë fshatra dhe qyteza palestineze. Rrafshuan shtëpitë përpara Murit të Lotëve, për ta bërë atë vend të denjë për statusin e qendrës së eksperiencës spirituale hebraike. Gjithë këto duken të mirëqena e të qarta, por nuk ishte dhe nuk është: për sionistët nga fundi i Tetëqindës dhe deri në vitet shtatëdhjetë të Nëntëqindës, Jerusalemi ishte një thirrje romantike; praktika spirituale ishte tjetërkund, në kubbutz-e dhe në brigjet e Mesdheut, në Tel Avivin e ri dhe modern. E dinin që Jerusalemi ndan dhe nuk bashkon, sepse ai flet për të kaluarën dhe jo për të ardhmen. E thoshte Meron Benvenisti, nënkryetar bashkie, njeri i paqes, i ngarkuar në vitet gjashtëdhjetë për të integruar dy pjesët kryesore, dhe deri atëherë të ndara të qytetit, atë Perëndimore të banuar nga izraelitët dhe atë Lindore të populluar nga palestinezët.

Që nga struktura e tij Jerusalemi, më shumë se një aglomerat urban (një shesh, një qendër pushteti shekullore dhe një spirituale, rrugë tregtare dhe vendbanime), është një tërësi ishujsh dhe enklavash: secila me zakonet e veta dhe në luftë me të tjerat

Por konflikti nuk ka vetëm karakter kombëtar; edhe shumica hebraike (dy të tretat e popullsisë) është e ndarë në brendësi të saj. Ka lagje ku ortodoksia është ligj: burra të ndarë nga gratë; nuk ka veshje të shkurtra; rrugë ku një zonjë laike rrezikon të fyhet rëndë. Dhe për pjesën tjetër – një tjetër anomali e qytetit – në politikën lokale shumë njerëz të majtë mbështesin kryebashkiakun aktual, Nir Barakat, i cili është i djathtë. E bëjnë për të frenuar ofensivën e fondamentalistëve fetarë hebrenj. Pastaj janë banorët palestinezë: të lirë të lëvizin në Shtetin e Izraelit, por pa nënshtetësi. Atmosfera në lagjet e tyre nuk është e ndryshme nga ajo në Ramallah apo në Nablus, zemra e Cisjordanisë. Jerusalemi lindor mund të jetë ndoshta pjesë e Shtetit hebraik, por i ngjan më shumë një qyteti të Autonomisë palestineze. Dhe për të kuptuar se sa ndan Jerusalemi, mjafton të mendojmë se çelësat e Kishës së Varrit të Shenjtë janë në duart e një familje myslimane; një masë për të bërë të padëmshëm një tjetër konflikt; atë mes emërtimeve të krishtera për kontrollin e vendit ku u varros Jezusi.*(bota.al)*



Nga **Mit'hat FRASHËRI**

Këndonjësit

Përparimi i një kombi varetë nga përmirësimi dhe naltësimi i çdo njeriu që formon këtë komb: duke ecur dhe duke u naltësuar gjithë së bashku, del në shpëtim shoqëria dhe zë një vend të ndershëm

NË SHRITIN E KOHËS

Çdo gjë me shpirt në këtë jetë ka me vet'he fuqinë që të përparojë dhe të mirësohetë. Histori e dheut, që nga bimët e kafshët dhe gjer te njeriu, nuk është veçse ecja e madhe në udhë të gjerë të përparimit.

Organizmat që nukë përparojnë, janë të dënuara për humbje dhe fikje, se duhet që të ecin në përparim ose të shuhenë. Nukë rron dot asnjë gjë duke qëndruar në shkallën që është.

Përparimi i një kombi varetë nga përmirësimi dhe naltësimi i çdo njeriu që formon këtë komb: duke ecur dhe duke u naltësuar gjithë së bashku, del në shpëtim shoqëria dhe zë një vend të ndershëm. Kur është një komb me njerëz të zgjuarë dhe të ngriturë, një frymë e ngrohtë dhe e shëndoshë shkon në shpirt të çdo njeriu, i shtyn që të ecin dhe të përparojnë, ujep një fuqi dhe një forcë të re. Ideja dhe vullneti, qëllimi dhe ideali i një kombi, janë më të fortat e fuqive në botë...

Po e shkruaj këtë libër të vogël për ty, këndonjës, dhe aqë më tepër nëse je i ri. Se mbi ty dhe mbi shokët e tu, do të mbështetet fuqia përparimtare dhe ju do të jini punëtorët e veprës së madhe.

Njihni vet'hen tuaj dhe duajeni. Dini cilëtjini, ku rroni dhe si gjëndeni. Në këtë njohje dhe dituri, merrni një kurajo për udhën e përparimit, punoni pa reshtur në veprën e bekuarë, sado e vogël dhe cilado që të jetë pjesajuaj. Dhe shpresa e gëzimi do të vijnë nga puna.

(Botuar më 1915)

Rubrika "Forum" është krijuar si hapësirë për të botuar letrat, opinionet, reflektimet dhe reagimet e lexuesve dhe qytetarëve.
Redaksia mban të drejtën për të redaktuar e shkurtuar, si dhe mos botuar ato shkrime që nuk i përmbahen etikës.

Historia e Leif Erikson, lundërtari viking që arriti në kontinentin amerikan rreth vitit 1000, pothuajse pesë shekuj para Kolombit dhe e të afërmve të tij, eksploruesit protagonistë të "pushtimit të Perëndimit" në ujërat e Veriut

FAMILJA QË ZBULOI AMERIKËN

Familja e Leif Erikson ishte protagoniste e vërtetë e "pushtimit të Perëndimit", që kulmoi me arritjen në Amerikë. I ati ishte Eriku i Kuq, i cili kishte arritur të kolonizonte Groenlandën, ose një pjesë të Amerikës, meqenëse gjeografikisht është pjesë e këtij kontinenti

Ishte një lundërtar i madh nga një familje kolonizatorësh të tokave të shkreta. Vendosi t'i drejtohej Perëndimit, derisa u gjend në një tokë ku asnjë evropian nuk kishte shkelur më parë: ai kishte zbuluar një kontinent të ri, që sërish pas 500 vjetësh do të rizbulohej nga një lundërtar tjetër, Kristofor Kolombi. Lundërtari nga Evropa quhej Leif Erikson dhe ishte një eksplorues viking që sot historianët e konsiderojnë evropianin e parë që ka shkelur në kontinentin amerikan. Ja cila është historia e Leifit dhe e familjes së tij aventuriere.

NË PERËNDIM. "I lindur në Islandë rreth vitit 970, Leif vinte nga një botë e populluar prej aventurierëve, tregtarëve dhe luftëtarët skandinavë të njohur ndryshe si 'Vikingët'", shpjegon Francesco Surdich, docent në universitetin "Xhenova". "Me këtë emër (që vinte nga fjala skandinave 'vik', gji) thërriteshin të gjithë ata që të motivuar nga dëshira për të pushtuar konfliktet e brendshme ose presionet demografike, mes shekujve VIII-XI, lundruan nga Skandinavia duke arritur në brigjet evropiane dhe më pas në ato afrikano-veriore e mesdhetare". Familja e Leif Erikson ishte protagoniste e vërtetë e "pushtimit të Perëndimit", që kulmoi me arritjen në Amerikë. I ati ishte Eriku i Kuq, i cili kishte arritur të kolonizonte Groenlandën, ose një pjesë të Amerikës, meqenëse gjeografikisht është pjesë e këtij kontinenti. Pas një vrasjeje, Erik ishte larguar nga Norvegjia bashkë me të atin dhe kishte ikur në Islandë (ku lindi edhe Leif). Pas pak kohësh, i përfshirë në një betejë të përgjakshme, i ishte drejtuar detit duke u vendosur më në veri. Mes viteve 982-985 kishte eksploruar një tokë pothuajse të pashkelur nga të tjerët. Ai e pagëzoi këtë vend me emrin "toka e gjelbër" "Greenland" (Groenlanda) për të tërhequr sa më shumë koloni. Krijoji dy koloni dhe qëndroi në njërën prej tyre duke krijuar "pronën" e tij, Brattahlid. Skandinavët qëndruan në Groenlandë deri në shekullin XV kur vendbanimet u braktisën.

TREGIME. Ashtu si i ati edhe i biri Leif u nis në kërkim të tokave të reja. Ai që e nxiti ishte tregimi i tregtarit Bjarni Herjolfsson, i zbritur në Brattahlid. Tregtari i habiti të gjithë duke u treguar se kishte parë toka të panjohura. Ndërsa lundronte mes Islandës dhe Groenlandës, u devijua papritur nga rruga për shkak të mjegullës dhe rrymave dhe si pasojë u gjend para një toke të mbushur me pyje, pastaj para një ishulli prej akulli dhe në fund arriti të prekte brigjet groenlandeze. Ju do të pyesni se nga i dimë ne udhëtimet e Bjarnit dhe Leifit? "Për të gjitha këto shkencëtarët janë të mirinformuar falë një sage të shkruar nga islandezët, që titullohet 'Saga e Groenlandezëve', edhe pse ka shumë vepra të tjera që e rrethojnë si 'Saga e Erikut të Kuq'", shpjegon Surdich. "Këto janë burimet kryesore rreth eksplorimeve vikinge, si dhe pjesë e të ashtuquajturave 'sagat e islandezëve'". Leif, që ndër të tjera ishte konvertuar në i krishterë dhe e kishte çuar këtë besim edhe në Groenlandë, në këmbim të paganizmit nordik, bleu anijen e Bjarnit dhe u përgatit që të fillonte lundrimin e tij (aty rreth vitit 1000) së bashku me 35 burra të tjerë. Sipas "Sagës së Groenlandezëve" në krye të udhëtimit duhej të kishte qenë baba Eriku, por në momentin e arritjes në port ra nga kali dhe vendosi të mos shkonte. Ai iu drejtua të birit duke i thënë: "Kjo nënkupton që fati nuk më ka rezervuar mua zbulimin e tokave të reja, si kjo ku po jetojmë tani".

AKULL. Nga Groenlanda, Leif lundroi drejt tokave të panjohura. Fillimisht u përball me një tokë të shkretë dhe shkëmbore që e quajti Helluland "toka e gurit", e identifikuar me ishullin Baffin në Kanada. Pastaj iu drejtua jugut dhe arriti në një zonë të pyllëzuar "me plazhe të mëdha të bardha dhe një bregdet të butë me pjerrësi". Ishte bregdeti lindor i Kanadasë, i pagëzuar Markland, "toka e pyjeve". Në fund duke lundruar për dy ditë të tjera drejt jugut, arriti në një territor më komod. "Leif dhe ekuipazhi i tij kaloi në një ngushticë, ku anija e tyre ngeci në rërë, kur arritën në cekëtirë. Ata arritën ta shpëtonin anijen përmes baticës dhe ta shpinin atë në mes të një lumi; më pas vendosën që ta kalonin dimrin në ato rrethina, meqenëse në pyjet ngjitur kishte drurë të mirë për të ndërtuar barake". Kështu e ka rindërtuar Johannes Brondsted ardhjen e Leif në librin "Vikingët".

FLORIDA . Në atë vend nuk kishte akull dhe bari nuk thahej, kështu që Leif dhe njerëzit e tij vendosën që të dimëronin aty, për t'u rikthyer më pas në Groenlandë. Ata zbuluan se zona ishte e pasur me hardhi të egra prandaj e quajtën Vinland, "toka e verës" (ose sipas disa interpretimeve "toka e pashkëve"). Po ku ndodhej Vinlandi? "Rreth pozicionit të këtij territori nuk ka siguri absolute, por me shumë gjasa në veri të Terranovës", shpjegon profesor Surdich. Kjo është prova e mbërritjes së vikingëve në Amerikë. "Këtu, në 1960-n arkeologët gjetën gjurmët e tetë ndërtesave dhe shumë objekteve, që të shpien te kultura vikinge dhe datojnë pikërisht në periudhën mes shekullit X dhe fillimit të XI". Prania e këtyre mbetjeve prej hekuri dhe druri, na bën të mendojmë se disa ndërtesa përdoreshin nga zdrukthëtarët dhe farkëtarët, ndërkohë që zbulimi i mjeteve të qepjes, si gjilpërat prej kocke, vërtetoi që në Vinland jetonin edhe gra.

REFUGJATËT, SKLLEVËRIT MODERNË

Fushat e Italisë gëlojnë prej mëditësve nga Afrika. Ata janë skllevër modernë të shfrytëzuar prej fermerëve pa skrupuj



Në Itali po krijohen pa rënë në sy gjithnjë e më tepër geto ilegale, si "Getoja e madhe" në Rignano afër Foggia-s. Gjatë periudhës së të korrave këtu jetojnë rreth 1.500 vetë. Por fjala jetojnë është në këtë kontekst e gabuar. Sepse mëditësit nga Afrika vegjetojnë në kushte tejet të vështira. Mëditja e tyre prej maksimalisht 20 euro në ditë nuk mjafton as për të marrë një shtëpi me qira, e jo më për të nisur një jetë të re. Edhe pse kushtet janë të vështira emigrantët qëndrojnë, sepse me rrogën e tyre të ulët ata furnizojnë dhe familjet. "Po të mos punoj unë këtu, kush do t'i ushqejë fëmijët e mi në Afrikë? Ndonjëherë dërgoj 200 euro, ndonjëherë 150. Kur fitoj 200 euro, 100 i mbaj për vete dhe 100 i dërgoj në Afrikë", tregon një grua.

PADI PËR SKLLAVËRIM

Në Nardó të Pulias policia arrestoi para disa kohësh 20 shfrytëzues me padi për skllavërim. 11 syresh u dënuan në korrik të këtij viti me heqje lirie deri në 11 vjet. Kjo vepër penale ka disa vjet që është përfshirë në kodin penal italian. Shumë prej punëtorëve me mëditje nuk kishin marrë rrogë prej muajsh. Prokurorja Elsa Valeria Mignone thotë: "Ishte brigadieri që vendoste se kur dhe çfarë duhet të hanin, nëse u lejohej të pinin dhe se çfarë. Dhe ai ua shiste të gjitha me çmime të larta. Një shishe e vogël ujë mineral 3 euro, një panine 3.5 euro. Po ashtu edhe nëse në ndonjë kamion hipnin për të shkuar në punë 25 vetë, secili duhet të paguante nga 5 euro." Por viktimat deri tani nuk kanë marrë dëmshpërblim.

NJË FSHAT VETËM PËR EMIGRANTËT?

Getoja pranë qytezës Borgo Mezzanone në jug të Italisë është më e madhja në vend. Këtu e ka pushtetin mafia nigeriane. Banorët e zonës e ndjejnë veten të lënë në baltë prej politikës. 500 italianë pranë mijëra skllevërve afrikanë. "Zezakët nuk blejnë asgjë. Ndoshta diçka për pesëdhjetë ose tridhjetë cent. Ata thjesht na marrin paratë, dhe nuk u sjellin asgjë. Ata u morën punën të gjithë atyre që punonin në fusha. Ose në fabrika. Kudo tani punojnë vetëm të zinjtë" - thotë një shitës. Çdo ditë, getoja i afrohet edhe më tepër Borgo Mezzanones. Autoritetet italiane janë të mbingarkuara me problemin, fermerët janë të lumtur për krahun e lirë të punës, po qytetarët? Ata janë të dëshpëruar. Dhe të zemëruar. "Gjithçka ka ndryshuar, dikur vinin makinat për të mbledhur plehrat dhe për të pastruar, tani askush nuk vjen. Na kanë lënë vetëm për fat të keq dhe ne nuk mund të bëjmë asgjë", thotë një grua. "Unë nuk mund të shkoj dikur tjetër, edhe po desha të largohem nga Borgo Mezzanone. Sepse askush nuk do ta blejë shtëpinë time. Të paktën jo sa çmimi i arsyeshëm i tregut. Unë do t'i bëja një propozim shtetit: Pse nuk e blen shtëpinë time? Dhe shtëpitë e të gjithë atyre që duan të largohen. Dhe shteti të bëjë atë që dëshiron këtu, gjë që e bën gjithsesi. Kështu shteti mund t'u ofrojë emigrantëve fshatin. Le të krijojmë një fshat vetëm për emigrantët", thotë një burrë.

SHFRYTËZIMI I REFUGJATËVE GJË NORMALE

Fenomeni shtrihet në të gjithë jugun. Në Kalabri ka nisur këto ditë vjelja e portokalleve. Një pjesë e bujqësisë këtu është në duart e N'drangetës dhe mafies. Shfrytëzimi i refugjatëve afrikanë këtu është gjë normale. Dhe një arsye pse gazetarët nuk janë të mirëpritur në fusha. Një punëtor na shpjegon se si fermerët ulin mëditjet e rregulluara me ligj: Kjo arkë me mandarina kushton një euro. Po mbushëm dhjetë arka, marrim dhjetë euro. Ditët e vetme që ne punojmë përgjatë rrugës janë e shtuna dhe e diela, sepse në këto ditë kontrollorët nuk punojnë. Ne vjelim gjithçka gjejmë kurse të hënën na largojnë, sepse ka kontrolle. Dhe njerëzit këtu vërtet kanë kontrata, por sigurisht që nuk janë të rregullta.

PROBLEME MJEKËSORE

Meqenëse shumë prej punëtorëve emigrantë nuk kanë dokumente të vlefshme identiteti dhe kontrata, ata nuk mbulohen as nga sigurimi shëndetësor. Prandaj, mjekët e organizatës humanitare „Emergency" i trajtojnë ata pa pagesë. Diagnoza më shpeshtë: kequshqyerja. Pothuajse si në Afrikë. Alessia Perrotti, mjeke tregon: "Në shtëpi ose në çadra, shpesh flenë shtatë ose tetë vetë. Nëse njëri prej tyre ka një infeksion, p.sh. të traktit gastrointestinal ose respirator, ka shumë gjasa që t'ua ngjisë të tjerëve."

VALA E REFUGJATËVE VAZHDON

E megjithatë njerëz nga rajonet e varfra të krizave në Afrikë do të vijnë përsëri në Evropë. Arsyeja është tepër e hidhur. "Gjithkush dëshiron të vijë e të jetojë këtu. Sepse ne bëjmë vazhdimisht fotografi të bukura në Venecia, Milano, Torino, Romë. Ne u tregojmë shokëve vetëm gjërat e bukura. Kur dikush shkon në Afrikë, ju sillni rroba dhe të gjithë miqtë mendojnë se ka diçka për t'u gjetur këtu. Por kjo ka mbaruar", thotë një emigrant. Që nga fillimi i vitit në bregdetin italian kanë arritur mbi njëqind mijë emigrantë. Numri i të kthyerve është i panjohur.

TË LUFTOHET KORRUPSIONI

"Ka ardhur koha që të kaloj ligji për prokurorinë disiplinor. Ky do të jetë një hap i vazhdueshëm për të siguruar kontrollin e pushtetit, transparencën dhe llogaridhënien në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Dhe për të siguruar që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, sepse kjo është e domosdoshme për luftimin e korrupsionit dhe për ndërtimin e besimit të opinionit publik në institucionet e drejtësisë dhe institucionet kosovare...", ka thënë Delawie



RAMUSH HARADINAJ

Ajo që mendoj me rëndësi është se Kosova ka me rrit koeficientin e menaxhimit të përgjegjshëm të parasë së publikut. Dhe njëkohësisht ka me rrit koeficientin e menaxhimit të përgjegjshëm të gjitha donacioneve që i menaxhojmë së bashku në Kosovë. Me theks të veçantë, luftimin e korrupsionit, i cili e ka përcjell Kosovën në vazhdimësi

Kryeministri Ramush Haradinaj në takimin e Forumit të Nivelit të Lartë, organizuar nga Ministria e Integrimit Evropian tha se qëllimi i Qeverisë që ai udhëheq është një Kosovë e qëndrueshme, një Kosovë që zhvillohet, e që ka qëllime jo vetëm ekonomike por dhe politike, e që janë integrimi në Bashkimin Evropian e në NATO. Haradinaj falënderoi donatorët për përkrahjen dhe miqësinë e treguar ndaj popullit të Kosovës. "Qeveria që e udhëheq është e sfidume. Ka plot sfida. Janë të shumta. Përballja me këto sfida është efikase, është e sigurt e garantuar, nëse mbesim ekip së bashku për kohën që vjen. Të gjitha këto investime të çmuara, donacionet e taksapaguesve të vendeve të respektume, të qeverive, jam thellë i bindur që kanë me e dhanë rezultatin përfundimtar, kur Kosova do të jetë partnere e mirëfilltë për vendet, për popujt e juaj dhe do të bëhemi ta quaj ashtu jo vetëm absorbues të përkrahjes por më në fund dhe të jemi partner për regjionin dhe me gjerë. Ajo që mendoj me rëndësi është se Kosova ka me rrit koeficientin e menaxhimit të përgjegjshëm të parasë së publikut. Dhe njëkohësisht ka me rrit koeficientin e menaxhimit të përgjegjshëm të gjitha donacioneve që i menaxhojmë së bashku në Kosovë. Me theks të veçantë, luftimin e korrupsionit, i cili e ka përcjell Kosovën në vazhdimësi. Mirëpo korrupsion, i cili e ka rrit dhe reagimin e qytetarëve dhe reagimin politik dhe reagimin e të gjithëve", tha ai. Ndërkaq shefja e zyrës së BE-së në Kosovë Anatalya Apostolova, tha se janë të gatshëm të mbështesin planin për drejtësinë për vitin 2018. "Fokusi do të mbetet në amendamentet kundër procedurës penale, që kanë të bëjnë me suspendimin dhe shkarkimin e zyrtarëve të cilët janë të ndëshkuar për veprat penale. Miratimi i ligjit kundër konfliktit të interesit. Miratimi i ligjit për prokurorinë shtetërore, për të forcuar zyrën e Prokurorisë speciale. Miratimi i Ligjit për përgjegjësinë e gjykatëseve dhe ndryshimi i ligjit që ka të bëjë me konfiskimin. Sa i përket suspendimit apo shkarkimit të zyrtarëve publik për korrupsion, do tu rekomandoj fuqimisht që këto ndryshime të jenë të miratuara ndaras. Do të kërkoj një përshpejtim më të shpejtë të zbatimit të kësaj, që të veproj kundër zyrtarëve të korruptuar. Kjo është arritja më e madhe e Kosovës", tha Apostolova. Apostolova po ashtu ka folur dhe për arsimin në Kosovë, për të cilin tha se duhet fuqizohet MASHT me qëllim të zbatimit të reformave të duhura dhe se fokusi duhet të jenë në cilësi. . Ndërkaq ambasadori i SHBA-ve në Kosovë, Greg Delawie tha se duhet të ndërmerren vendime të rëndësishme për reformën e trupave kundër korrupsionit dhe sektorit të drejtësisë. Ndërsa tha se arsimi duhet të depolitizohet. "Ka ardhur koha që të kaloj ligji për prokurorinë disiplinor. Ky do të jetë një hap i vazhdueshëm për të siguruar kontrollin e pushtetit, transparencën dhe llogaridhënien në sistemin e drejtësisë së Kosovës. Dhe për të siguruar që të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, sepse kjo është e domosdoshme për luftimin e korrupsionit dhe për ndërtimin e besimit të opinionit publik në institucionet e drejtësisë dhe institucionet kosovare. Fundja asnjë rritje e zhvillim ekonomik nuk mund të mendohet pa këtë. Tash duhet që të vazhdojmë me punën tonë të njëmendshme që integrimi në veri të bëhet sa më i përshtatshëm dhe funksional. Kjo nënkupton që stafi të ketë trajnimin e duhur, përkthimi i dokumenteve të bëhet siç duhet dhe të kemi një integrim të njëmend në këtë sektor. Po ashtu duhet të kemi dhe projekte të tjera që ka duhet të vazhdojmë reforma në sektorin e edukimit, ashtu që të rinjtë e Kosovës të marrin vendin e duhur në ekonominë e Kosovës. E para duhet të bëhet depolitizimi i rekrutimit të të gjithë përfshirë dhe drejtorëve të arsimit nëpër komuna", tha Delawie.

Haga kërkon 28 vjet burgim për Sheshelin ose rigjykim

Gjyqi Ndërkombëtar i Hagës të mërkurën, më 13 dhjetor, do të debatojë për ankesën e prokurorëve rreth aktgjykimit lirues të shkallë së parë për liderin e radikalëve të Serbisë (SRS) Vojislav Sheshelit. Me shumicë votash, Tribunali i Hagës më 31 mars të vitit të shkuar, Sheshelin e kishte liruar nga fajësia për krime ndaj në Kroaci, Vojvodinë dhe B e H në vitin 1991-93. Prokuroria me ankesë ka kërkuar që aktgjykimi lirues të anulohet dhe Sheshesh të shpallet fajtor për të gjitha pikat e aktakuzës dhe të dënohet me 28 vjet burgim. Siç njofton beta e Beogradit, si alternativë, prokurorët kanë kërkuar që Sheshel të rigjykohet. Lideri i radikalëve përgjigjen për ankesë kishte thënë se "vetëm i vdekur mund të kthehet në Hagë në shqyrtimin e paralajmëruar për në mars.

Publicitet

Në bazë të nenit 89-a të Ligjit për arsim të mesëm (Gazeta zyrtare e RM nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 78/03 US, 67/04, 51/05 US, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13), neni 121 paragrafi 1 alineja 6 i Statutit të SHMK "Mavrovë-Rostushë" – Rostushë, Vendimit të Kryetarit të Komunës Mavrovë dhe Rostushë për publikim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit të numër 09-287/8 të datës 06.12.2017 dhe Vendimit të Këshillit të Shkollës për publikim të shpalljes për zgjedhje të drejtorit të sjellë në mbledhjen e mbajtur më datë 07.12.2017, Këshilli i shkollës së SHMK "Mavrovë-Rostushë" – Rostushë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

1. **Kandidatët për drejtor përveç kushteve të përgjithshme të parapara me Ligj, duhet t'i plotësojë këto kushtet në vijim**:
- Të ketë shkollim të lartë;
- T'i plotësojë kushtet për arsimtar, pedagog dhe psikolog në shkollë të mesme;
- Të ketë minimum 5 (pesë) vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimor të vërtetuar nga Ministria e arsimit dhe shkencës;
- Të ketë dhënë provimin për drejtor për shkollë e mesme;

2. **Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:**
- Fletëparaqitje me biografi;
- Program pune të drejtorit të shkollës për periudhë 4 (katër) vjeçare;
- Diplomë arsim të mbaruar;
- Vërtetim për përvojën e punës në procesin edukativo-arsimor, të dhënë nga institucionet e verifikuara të Ministrisë së arsimit dhe shkencës për kryerje të punës edukativo-arsimore;
- Certifikatë të shtetësisë së RM;
- Certifikatë për provim të dhënë për drejtor;

Afati për dorëzimin e dokumenteve është 8 (tetë) ditë dhe fillon të rrjedhë ditën e ardhshme nga dita e publikimit.
Zgjedhja e kandidatëve të paraqitur do të realizohet në afatin e paraparë me Ligjin për arsim të mesëm.
Pagesa bazë parashihet me matjet dhe kriteret e caktuara me Marrëveshjen kolektive për arsim të mesëm me koeficient të vështirësisë 3.083 dhe me neto shumë prej 26.038,00 denarë + shtesë për punë të kaluar në shumë prej 0.5% për çdo vit të stazhit të punës me 40 (dyzet) orë pune në javë.
Fletëparaqitjet me dokumentet përkatëse, kandidatët duhet ti dorëzojnë në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter, në arkivin e shkollës ose përmes postës me shenjë:
Deri te Këshilli i shkollës së SHMK "Mavrovë-Rostushë" – Rostushë për shpallje për zgjedhje të drejtorit, 1254 f. Rostushë.
Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh.
Me kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet do të realizohet intervistë për çka enkas do të informohen të gjithë kandidatët.

Kryetari i Këshillit të shkollës
Radmilla Zdravkoviq

Në bazë të nenit 19 të Rregullores për mënyrën dhe realizimin e ekskursioneve për nxënësit nga shkollat e mesme nr. 07-999/3 të datës 05.06.2014 SHMK "Goce Dellçev" – Vallandovë publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për grumbullimin e ofertave për realizim të ekskursioneve të nxënësve në vitin 2017/2018

SHMK "Goce Dellçev" – Vallandovë në pajtim me Rregulloren për realizim të ekskursioneve dhe mendimit të marrë nga Këshilli i prindërve dhe Byroja për zhvillim të arsimit, organizon ekskursion ndërkombëtar përfundimtar me kohëzgjatje prej pesë ditë (tri bujtje) për nxënësit e vitit të III (tretë) në relacionin:

VALLANDOVË – VENECIE – TRIESTË – OPATI – MAGJISTRALEN E ADRIATIKUT – DUBROVNIK - VALLANDOVË

Në ofertë të theksohet:
- Emri i subjektit juridik, nënshkrimi i subjektit përgjegjës dhe vula
- Kushtet për akomodim (akomodim në hotel me së paku 3*), mëngjes dhe darkë dhe transport
- Në çmim futet edhe sigurimi rrugor dhe shëndetësor i nxënësve dhe mësimdhënësve
- Mënyra e pagesës (me këste)
- Numri i shërbimeve falas për nxënësit e prekur social
- Udhërrëfyes, numri i mësimdhënësve dhe mjekë
- Në çmim duhet të përfshihet TVSH
- Në çmim të përfshihen shpenzimet për rrugë, ushqim, akomodim, vizita të muzeve, diskotekave dhe vendeve tjera interesante.

Pagesa të realizohet në 5 (pesë) këste të barabarta mujore, ndërsa ekskursioni të realizohet në gjysmën e dytë të muajit prill/gjysma e parë e muajit maj në kohë prej 6 (gjashtë) ditë me 3 (tri) bujtje në Lido di Jesolo, Opati dhe Dubrovnik.

Si ofertues më i volitshëm shkolla do të zgjedhë ofertuesin i cili plotëson edhe kriteret minimale në vijim:
- Të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM për realizimin e veprimtarisë përkatëse turistike
- Të ketë të organizuara në mënyrë të suksesshme së paku tre ekskursione për nxënës dhe aktivitete tjera të lira gjatë tre viteve të fundit
- Plotëson kushtet për transport të grupit të fëmijëve, në pajtim me ligjin për Siguri të komunikacionit rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat transportohen grupet e fëmijëve

Kriteri për zgjedhje të ofertës më të volitshme është: Çmimi më i ulët

Çmimet në ofertë janë fikse, gjegjësisht nuk lejohet korrigjimi i çmimeve gjatë realizimit të marrëveshjes. Garancia bankare për realizim kualitativ të marrëveshjes është 15% nga vlera e përgjithshme e marrëveshjes.

Ofertat të dorëzohen personalisht ose përmes postës në adresën rr. "Prvomajska" nr. 3 Vallandovë në zarf të mbyllur me shenjë Komisioni për grumbullim të ofertave për ekskursion në afat prej 5 (pesë) ditëve duke llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor. Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

SHMK "Goce Dellçev" – Vallandovë
Komisioni për grumbullimin e ofertave

JERUSALEMI: NGA LOBI SIONIST, TEK DHËNDRI JARED KUSHNER

ÇFARË MERR NË KËMBIM PRESIDENTI?

Në plan të parë spikat manjati i kazinove të Las Vegasit, Sheldon Adelson, dhe shoku i tij Morton Klein, i cili kryeson Organizatën Sioniste të Amerikës, një grup konservator pro-Izrael. Hetimi i New York Times rindërton një rrjet takimesh dhe telefonatash, mes këtyre të dyve dhe Trumpit

Ditën pas njohjes së Jerusalemit si kryeqytet, Trumpi mori atë që pritej: protesta të dhunshme palestineze. Gjithçka e parashikuar? Ose ndoshta jo. Diçka duket se mungon. Për shembull, një gjest i Benjamin Netanjahut, që i përgjigjet dhuratës historike të Amerikës me një ofertë njësoj bujare. Një lëvizje izraelite që e bën të besueshëm, premtimin e Trumpit për procesin e paqes. Nuk ka as hije, për momentin. Pra, lëvizja e Trumpit, a mos është pjesë e një plani të paracaktuar, në të cilin të tjerët duhet të bëjnë pjesën e tyre?

Mungesa e një kundërpale izraelite duket se justifikon sfondin, ashtu si ai i Mark Landler në New York Times, i cili rindërton vendimin e Trumpit në aspektin e politikës së brendshme. "Presidenti që i mban premtimet e tij", është një mesazh drejtuar një hapësire elektorale amerikane, që e solli atë në Shtëpinë e Bardhë. Në plan të parë spikat manjati i kazinove të Las Vegasit, Sheldon Adelson, dhe shoku i tij Morton Klein, i cili kryeson Organizatën Sioniste të Amerikës, një grup konservator pro-Izrael. Hetimi i New York Times rindërton një rrjet takimesh dhe telefonatash, mes këtyre të dyve dhe Trumpit. Adelson kontribuoi në fushatën elektorale dhe tani merr mbrapsht realizimin e premtimit, që e kishte më shumë për zemër. Përveç krahut të djathtë të bashkësisë hebraike amerikane (të pasur dhe bujarë por pakicë, duhet të mos harrohet: shumica e votuesve hebrenj-amerikanë janë demokratë, shpesh ultra-progresistë), ekziston bota e evangjelistëve. Fundamentalistët mbështesin Netannjahun, që me rreshtimin e tyre me të djathtën izraelite, që nga koha e Bushit. Mbetet për t'u kuptuar Jared Kushner. Çuditërisht, dhëndrri i parë është renditur ndër mbështetësit e lëvizjes në kryeqytetin e Jerusalemit, bashkë me Steve Bannon; kundër kësaj, deri në fund, ishin Sekretari i Shtetit dhe ai i Mbrojtjes, gjenerali Mattis. Roli i Kushnerit është enigmatik duke marrë parasysh marrëdhëniet e shkëlqyera me Arabinë Saudite të princit Mohammed bin Salman. Teoria më e guximshme pohon se sauditët protestojnë sa për sy e faqe, por tani kanë lënë mënjanë dosjen Palestinë, përpara problemit numër një, që është Irani. Përllogaritja djallëzore e Kushnerit do të mund të ishte kështu: të përdorim shpalljen për Jerusalemin, për të treguar se sa i holluar është fronti arab dhe sa i rëndë është izolimi i palestinezëve. *(La Repubblica)*

NUK E BRAKTISIM KUDSIN NË MËSHIRËN E NJË VENDI VRASËS TË FËMIJËVE

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, në një fjalim në kongresin e 6-të të zakonshëm të AK Partisë në qytetin Sivas, është shprehur se "Kudsi është drita e syve tanë, ne nuk do ta braktisim Kudsin në mëshirën e një vendi vrasës të fëmijëve. Ne Kudsin nuk do ta lëmë në ndërgjegjen e një shteti që nuk ka asnjë vlerë tjetër veçse të pushtojë dhe plaçkitë. Ne do ta vazhdojmë luftën tonë të vendosur brenda kuadrit të ligjit dhe demokracisë". Presidenti i Turqisë ka shtuar më tej se "dëshirojnë që ne të qëndrojmë të heshtur përballë kësaj tabloje, të qëndrojmë të tërhequr, të ulim kokën përballë padrejtësisë dhe presin që ne të pranojmë rendin e persekutimit që ata kanë ndërtuar mbi gjakun e fëmijëve, dhe gjithashtu kërkojnë që ne të zgjedhim rrugën e dorëzimit duke përdhosur vlerat tona". "Për ne nuk ka rëndësi se kush është persekutuesi apo ai që persekutohet. Ne qëndrimin tonë nuk përcaktojmë sipas identitetit, gjuhës, fesë apo forcës së bashkëbiseduesve tanë, por ne e përcaktojmë atë duke vërejtur se kush është në të drejtë apo të gabuar. Ne nuk do të hezitojmë të qëndrojmë përballë mizorit edhe sikur ai të jetë vëllai ynë", është shprehur Erdogan.

Ëndrra evropiane e Macronit

Nderimi me Çmimin e Karlit të Madh tregon se "ëndrra evropiane" e Macronit është një shans i rëndësishëm për BE për t'i dhënë historisë së tij një drejtim të ri

Dhënia e Çmimit Karli i Madh Presidentit francez tregon se angazhimi i tij për bashkimin e Evropës nuk kalon krejt i padëgjuar në Gjermani. Të paktën në Ahen e kanë kuptuar, se fitorja e Macronit nuk është në radhë të parë kërcënim për takspaguesin gjerman, por një shans për t'i dhënë BE në fazën e tij më të vështirë të historisë së tij një drejtim të ri. Macroni është me të vërtetë një politikan, e cili dëshiron ta përtërijë "ëndrrën evropiane", siç thuhet në argumentimin për dhënien e Çmimit. Pa një sasi entuziazmi Evropa nuk çohet më përpara, këtë e dinte që Kohli. Shpirti shtegtues i tij te francezi i ri e kombinon atë me realizëm politik, gjë që në fakt është bazë e mirë për një bashkëpunim të ri gjermano-francez. Por gjithçka që dëgjon nga Gjermania aktualisht janë fantazi utopike dhe ndarëse të një mbajtësi të mëparshëm të Çmimit Karli i Madh, i cili ende nuk e di nëse dëshiron të qeverisë, megjithëse kjo do të ishte e nevojshme, për të patur mundësi që të vësh në lëvizje gjëra në Bashkimin Evropian.

TURQIA, VENDI LIDER NË BOTË PËR RRITJEN EKONOMIKE

Turqia në tremujorin e tretë të këtij viti, periudha (korrikshtator) e ka çuar në 11.1 për qind rritjen e saj

Ekonomia e Turqisë në tremujorin e tretë të vitit, duke arritur normën e një rritjeje me dy shifra ka vendosur një distancë me vendet e Bashkimit Evropian (BE), G20 dhe OECD. Ekonomia e Turqisë e cila është rritur katër herë më shumë se vendet e BE-së të cilat mesatarisht kanë një rritje me 2.5 për qind, ajo ka lënë prapa edhe Kinën dhe Indinë, që tërheqin vëmendjen me normat e tyre të rritje në G20. Sipas informacioneve të mbledhura nga AA, nga të dhënat e Institutit të Statistikave të Turqisë (TÜİK), Zyra e Statistikave Evropiane (Eurostat) dhe OECD, bëhet e ditur se Turqia në tremujorin e tretë të këtij viti, periudha (korrikshtator) e ka çuar në 11.1 për qind rritjen e saj ekonomike, duke rritur dy herë më shumë rritjen me 5.2 për qind të arritur në tremujorin e dytë të vitit. Për periudhën në fjalë me normat e rritjes Turqia është radhitur e para në mesin e vendeve të BE-së, G20 dhe OECD. Vendet e Evropës në tremujorin e dytë të vitit kanë treguar një rritje me 2.1 për qind, në tremujorin e tretë 2.5 për qind, ku dhe në këtë mënyrë Turqia ka treguar një rritje 4 herë më shumë se mesatarja e Evropës. Ndërkohë, theksohet se vendi që ka shënuar më shumë rritje në tremujorin e tretë të vitit në Evropë është Rumania, e cila për periudhën në fjalë ka arritur një rritje me 8.8 për qind. Ky vend ndiqet nga Malta me 7.2 për qind, Letonia me 5.8 për qind. Ndërsa vendet kryesuese të ekonomisë së Evropës, Holanda këtë periudhë ka arritur një rritje me 3 për qind, Gjermania me 2.3 për qind, Britania me 2.1 për qind dhe Franca me 2 për qind. Ndërkohë që Kina, një nga ekonomitë më të mëdha të botës në G20 ka arritur një rritje me 6.8 për qind, dhe India me 6.1 për qind. Turqia me normat e rritjes që ka arritur ka shënuar një distancë edhe me këto vende.

SHËNIME TË KOHËS

BRANKO MERXHANI NË DITARIN E DHIMITËR SHUTERIQIT

Revista "Përpjekja" u mbyll me të shkelur fashizmi italian vendin, Brankoja vajti në Turqi, bashkë me ndonjë intelektual tjetër përparimtar të vendit, si arkitekti Qemal Butka. Nuk e qasi pushtimin fashist

Ai u bë i njohur si publicist aty nga fundi i viteve '20, po sidomos në vitet '30. Ishte çam i mërguar me kohë në Turqi, ndofta me gjithë familjen. Ishte i krishterë. Se nga i vinte ai emër sllav, Branko, nuk e di. Kur erdhi në Shqipëri, – në vitet '20, – shqipen gati e kishte harruar, më kanë thënë. Kur e kam njohur, më 1936, ai ende fliste me një theks turk dhe, shpesh, kur s'e gjente fjalën shqip, e thoshte në turqisht, në mos frëngjisht apo në ndonjë gjuhë tjetër. Studimet e larta i kishte bërë në Gjermani. Studime filozofie. Njihte pra mirë filozofinë gjermane, edhe rrymat bashkëkohëse të niçeizmit e të frojdizmit me të tjera. Po admirimin e madh e kishte për filozofinë pozitiviste franceze të August Komtit e të Dyrkenhajmit me shokë; ishte admirues i Spenserit e i Stjuart Millit, njihte pragmatizmin amerikan të Xhejmsit. Di se pozitivizmi, në pjesën e dytë të shek. XIX, ishte doktrina që ndikoi më shumë mbi inteligjencën përparimtare turke dhe e kanë admiruar edhe rilindasit tanë që studjuan ose punuan atje. Diç kam lexuar për këtë çështje, kur flitet për Samiun. Do parë "Kamusi" i këtij. Kam përshtypjen se poeti dhe mendimtari turk i kohës së Samiut, Teufik Fikret, ishte pozitivist, në mos pranë pozitivizmit.

REVISTA E BRANKOS

Branko Merxhanin e kam takuar së pari në Tiranë më 1936, në fund të shtatorit, kur do të nisesha për studime në Francë. Pastaj në verë 1938, pata përsëri në Tiranë një takim; më vonë nuk u takuam dot më. Më njohu me Brankon Petro Markoja, i cili punonte me të për të nxjerrë revistën "Përpjekja shqiptare". Aty, pjesa më e madhe e lëndës është e Brankos vetë. Ishte një revistë nga më seriozet e kohës në Shqipëri. Për nga cilësia, ajo ua kaloi revistave të klerit katolik; sipas përshtypjes së përgjithëshme. Për nga qëndrimi, revista e Brankos ishte një organ i përparuar për kohën, le të kem pasur edhe unë vetë rezerva për të dhe të jem shprehur ndonjëherë jo në mënyrë vërtet objektive, sigurisht pas Luftës, kur nisëm të jemi të ngurtë në gjykimin e së kaluarës sonë kulturore, veçanërisht të asaj të periudhës së Zogut dhe të intelektualëve të kohës. Të paktën ne që merremi me historinë e letërsisë dhe ndonjë që është marrë me mendimin e kohës, si Viron Koka, i cili ka mbrojtur edhe tezë aspiranture për atë mendim, duke mos e kuptuar mirë periudhën, duke dashur që të ishte kushedi sa i avancuar mendimi në Shqipëri, kur dhe marksizmi sapo kishte filluar të njihej. Përpjekja e Brankos u lexua nga rinia dhe e çmua, sigurisht jo aq sa "Bota e re" e Korçës, që tërhoqi më mirë e më shumë të rinjtë antifashistë.

Revista "Përpjekja" u mbyll me të shkelur fashizmi italian vendin, Brankoja vajti në Turqi, bashkë me ndonjë intelektual tjetër përparimtar të vendit, si arkitekti Qemal Butka. Nuk e qasi pushtimin fashist. Në Shqipëri ishte beqar, në Turqi kam marrë vesh se u martua dhe se u bë me dy vajza, njëra prej të cilave rronte në Danimarkë. Nuk di me se merrej Brankoja tani. Nuk afrohej në ambasadën tonë të Ankarasë apo në konsullatën e Stambollit. S'e di kur ka vdekur, po, me sa duket, nga fundi i viteve '70 ose fillimi i viteve '80, pra i moshuar.

Më 1936, kur e njoha unë, ai nuk më dukej më pak se 45 vjeç. Por ishte i drobitur, si shfaqet edhe në një fotografi që kam pasur prej tij. I dobët në fytyrë, me dy sy si të çakaritur, me flokë të rrallë. S'e kam parë të veshur mirë. Nuk i kam pas vajtur në shtëpi, por në fotografinë që përmenda e që duhet të jetë bërë në oborrin e asaj shtëpie, duket se jetonte varfërisht. Hante në një restorant të mirë, prapa Hotel "Çajupit", pranë Bashkisë së Tiranës të asaj kohe. Shteti revistën e tij e subvencionontе me 35 napolona në muaj, po zor se i nxirrte harxhet dhe Brankos duhej t'i mbeteshin pak për të jetuar. Ai ishte dhe hovarda, xhepin e kishte "të shpuar", si thosh. Në redaksi pata vajtur. (kishte një dhomë të varfër) Më përmendet se ishte në Rrugën Mbretërore (sot e Barrikadave), ku ishin dhe redaksi të tjera, si të gazetës "Arbënia", që nxirrte Nebil Çika me Ismet Toton, të "Vatrës", që nxirrte Timo Diloja, dhe ndonjë tjetër, jo larg librarisë së Lumo Skëndos, po nga ana lindore e rrugës. Kjo rrugë ishte arteria kryesore e qytetit, ndonëse ishte çelur (pjesërisht) Bulevardi i Madh, ekzistonte Bd. Musolini (sot Rr. e Pezës) dhe Rr. e Durrësit, që të dyja më të paraqitshme.

KOÇA, NJERIU MË I AFËRT I BRANKOS

Brankoja ishte një ndër intelektualët e mëdhenj të kohës në Shqipëri. Shokë të afërt në moshë kishte Vangjel Koçën, Ismet Toton, Tajar Zavalanin, Skënder Luarasin, Ernest Koliqin, Lazgush Poradecin, Et'hem Haxhiademin, Odhise Paskalin, dhe të tjerë. Më shumë bëhej me dy të parët e me jugorë të tjerë, si Nebil Çika, Koçën, – Vangjel Nirvanën, e kishte shok të ngushtë dhe më të afërmin në mendime. Në shoqëri të tij e kam njohur dhe unë Nirvanën, që kishte shkruar një recension të mirë për librin tim të parë më 1935, tek "Illyria", duke shkruar dhe për të tjerë, po së fundi për mua, duke e nisur kështu recensionin: "The last but not the least". Vangjeli ishte një njeri i butë, me dy sy të veckël e të mprehtë pas syzesh të forta, gati i imët si Brankoja, me kuvendimin të ëmbël e të mençur, me theksin gjirokastrit. Tregonin se kishte një bibliotekë të madhe, e cila e pësoi pas Çlirimit dhe nuk hyri e tëra në Bibliotekën Kombëtare, për fat të keq. Ka vdekur në një bombardim aleat, që fundosi vaporin me të cilin kthehej nga Italia më 1942 apo 1943. E kishin bërë zv.kryefederal fashist të Shqipërisë. Ishte demokrat në shpirt dhe mjaft i emancipuar, pra ajo s'i shkonte. Fashistët e përkëdhelën dhe ai u lidh me ta. Thoshin se në kohë të Zogut i kishin dhënë italianët doktoratin, se nuk kishte studime të larta (punonte si noter në Gjirokastër dhe më kanë folur mirë për të ata që e kanë njohur në atë funksion). Kishte një grua që dallohej si mësuese. E pra, Vangjel Koça ishte njeriu më i afërt i Brankos.

Pas tij vinte Petro Markoja, të cilin ai e donte. Brankoja i afronte të rinjtë dhe këta shkruan në revistën e tij. Afroi Shevqet Musaranë, Nexhat Hakiun e ndonjë tjetër. Nga takimet që kam pasur në Tiranë me Brankon, më përmendet se i erdhi mirë që isha iniciuar në filozofi, – unë kisha bërë klasën e filozofisë për të mbaruar Liceun e Korçës. I erdhi edhe më mirë, kur kuptoi se anoja nga pozitivizmi, – nga anonte profesori ynë Majeri (Mayer), veçanërisht edhe manuali i filozofit Kyvilje (Cuvillier), që përdornim. Kisha nisur të lexoja Kontin dhe Dyrkhajmin, – fragmentarisht, kuptohet; – dija për Uilljam Xhejmsin, bile dhe për Xhon Djunë, për Stuart Killin diçka; admiroja, – me të dëgjuar, – Herbert Spencerin. Kisha dëgjuar për Niçe dhe Frojd, por zor se kisha lexuar gjë. Kisha shfletuar disa libra marksiste (August Bebel, Trocki, – "Historia e revolucionit", – Bukarin, ndonjë artikull të Leninit mbi fenë dhe mbi Marksin), kisha përkthyer nga frëngjishtja, për grupin e Korçës, në të cilin bëra pjesë, "Manifestin Komunist". Pra mund të hyja në bisedën filizofike,

sado me drojë, – po mosha më jepte dhe guxime. Sidoqoftë, më shumë dëgjoja. Brankoja paraqitej me kulturë jo të zakonshme. Ishte edhe më enciklopedist se Vangjeli, që edhe ai kishte shumë kulturë. E vuri re Brankoja se tepër pak dija nga filozofia gjermane dhe më rekomandoi të futem në të, se përndryshe do të kisha një boshllëk të madh, po duke më rekomanduar nxehtësisht që të mos nisesha nga Shopenhaueri ("mos e le pa kënduar, nuk thashë, po ka rrezik të shkruash dhe ti një 'Pse?' si ai i riu i Korçës, që Vangjoja sikur na e përkëdheli vjet...", – Nirvana kishte shkruar një artikull inkurajues, po dhe kritik, në tërë një faqe të "Illyrisë" së Tiranës, për romanin e Sterio Spasses më 1935, – dhe Brankoja, edhe në vjershat e mia "bodlerjane", si dhe Nirvana vetë, gjente pesimizëm ose ndikime të papërbluajtura, si ç'qe e vërtetë). Në Itali, atje tani "ishte vetëm një filozof, Kroçeja, për të mos i ngrënë hakën dhe... Musolinit", tallej Brankoja. Kroçen e çmonte mbi të tjerë Vangjeli.

NA MERRTE PËR UTOPISTË

Sikundër shihet, Brankoja fliste pak a shumë hapët dhe me mua nuk i kursente thumbat për Duçen, ndërsa regjimin e Zogut e quante "xhahil". Nuk e shpjegoj, për këtë demokrat, se si u afrua më 1934-35 me disa mendime të Anton Logorecit e të ndonjë tjetri, – Ashim Gjakova, – që patën marrë pjesë si të ftuar në manifestimin e madh të rinisë naziste në Nurenberg më 1933; po ndofta si "dojçkultur", që pati iluzione të çastit edhe për Rajhun III. Shkroi në atë drejtim tek "Illyria", që ishte më shumë në duart e Ernest Koliqit. Nuk kam kujtimin që artikujt e tij të më kenë bërë përshtypje kur u botuan, po pas Çlirimit, duke rilexuar të përjavshmen "Illyria" për shkrimet e Migjenit, prej të cilit ribotova disa nga prozat te revista "Literatura jonë", duke mbajtur edhe një konferencë për të, – ka qenë më 1948, – u irritova. Në botimin që i bëra konferencës, e qortoja rëndë Brankon, siguristi se ai shkruante edhe mbi "bolshevizmin në Shqipëri"; e quaja "profashist", që nuk ishte në thelb, duke mos qenë marksist. Brankoja si pozitivist ishte demokrat, edhe në pastë pasur ndonjë iluzion që përmenda. Mendimet e tij nuk ishin pa takime me ato të Ismet Totos, që u orvat fort për një "diktaturë të ndritur" me mbretin Zog, apo të Nirvanës, që do të bëhej zv.federal. Sidoqoftë, nuk e kam rilexuar më Brankon në tërësinë e shkrimeve të përndara të tij, që të mund të them sot një mendim vërtet të pjekur për të. Ai afrohej me Petro Markon, Shevqet Musaranë, mua, që kishim ide më revolucionare. Na merrte për utopistë. Për të, socializmi për Shqipërinë ishte një utopi, posa tek ne nuk kishte proletariat.

Brankoja më tha fjalë të mira për vjershat që kisha botuar e për ndonjë kritikë letrare, po gjatë nuk folëm. Ai e donte bashkëpunimin tim. Sa kohë isha në Francë, botova te "Përpjekja shqiptare", ndonëse rrallë. Kështu kam botuar artikullin me rastin e vdekjes së Migjenit, të cilin aty e quajta "prijësin" e një rryme letrare që kishte të ardhme. Kam botuar një artikull mbi "Drejtimet e reja letrare", ku polemizoja me Vangjo Nirvanën, se pranonte pikërisht pikëpamjen e Benedeto Kroçes, sipas të cilit ndryshimet në fushën e artit ngjasin për arsye individuale dhe jo shoqërore. Ky artikull nuk duhet t'i ketë pëlqyer Brankos, se ma qethi dhe për këtë iu qava. Iu qava, kur e takova më 1938, edhe për botimin e një vjershë timen, "Himni kombëtar", ku më kishin futur emrin e mbretit pa më pyetur! Në fakt, këtë e kishte bërë im atë, i cili dhe ia dërgoi vjershën për botim revistës. Unë kisha marrë pjesë në konkursin për himnin, me rastin e 25-vjetorit të pavarësisë, konkurs që e fitoi Beqir Çela, me sa kujtohem. Ky ishte një ndër intelektualët pak a shumë të njohur të kohës. Te "Përpjekja" kam botuar edhe ndonjë vjershë e diçka tjetër, për shembull nga Dyrkhajmi për shkollën. Jam ngrënë veçanërisht me Brankon se ai botoi aty një artikull me titullin "Pse nuk jam marksist" dhe pse polemizoi me "Botën e re" të Korçës. I shkruajta se nuk e prisja nga ai që "të mos kishte besim në shkencat shoqërore". E kam uruar veçanërisht për botimin e "Fjalës së metodës" së Dekartit, përkthyer shqip nga Vangjo Nirvana, me rastin e 300-vjetorit të filozofit, duke shënuar në letrën time, se kjo duhej të bëhej shkak për "efuzione filozofike". E kisha fjalën tek idealizmi filozofik që vija re në shkrimet e Nirvanës, po dhe te pozitivizmi i Brankos.

PERPJEKJA SHQIPTARE

REVISTË KULTURALE E PËRMUAJSHME

PËRMBAJTJA:

Branko MERXHANI . . . . . Nieriu dhe Komb
ASDREN . . . . . riamurit Arbënor
Selmon RIZA . . . . . Dilettantizmi dhe Zanati
Taiar ZAVALANI . . . . Problemi demografik shqiptar
Stefon TRESKA . . . . . Biologjia dhe Edukata
Sotir PAPARISTO . . . . . Ç'është Sugjestioni?
Mithat ARANITI . . . Një interview me Prof. Skok
Dr. A. CARREL . . . . Nieriu, ky i panjohur
E. DERMENGHEM . . . Eplopati dhe Idetë panarabe

ARKIVE KOMBËTAR: Komiteti shqiptar i Manastirit (Fehim Zavalani); Harroftumb Kristo Kiçi (Milto Sotiri Gurra).

MUAJI SHQIPTAR: Fejesa Mbretërore (p. eb.); Shkodra (Asdren); Një institut Albanologjik (redak.); Koncerti Teatrho-Alkai (ts.); Dr. Gj. Pekmezi (red.) etj.

MUAJI NDËRKOMBËTAR: Eremiti i Gardona-s (Vangjel Koça); Baronesha Izimoto (Olga Plumbi); Alfred Adler (np.) etj...

JETA DHE LIBRAT: Cilti e rrënuan qytetrimin romak: Gjermanët apo Arabët? (hm); Libra dhe revista shqipe, etj...

NOTA MUZIKORE: Kur m'u rite, vogëlushe (Ljetu: Lasgush Poradeci; muzika: K. Kruo).

KLISHETE: Dy brezat letrorë (P. Gjergj Fishta, Asdren – Lasgush Poradeci, Ernest Koliqi) ■ Gabriele d'Annunzio.

● Nr. 14-15 SHKURT-MARS 1938

ÇMIMI: 5 Lekë copa

DREJTOR-PRONAR BRANKO MERXHANI

PËRQAFIMI

Në fillim të vitit 1939, nga Brankoja mora një letër dhe një autorizim që të shkoja në këmbë të tij në Kongresin Botëror të Gazetarëve, që do të mbahej në Nicë të Francës në muajin mars. Vajta atje dhe fola për temën që ishte në rend të ditës, "Lufta kundër lajmeve të rreme". Ndër gazetarët që jepnin lajme të tilla, një shumicë ishte në sallë, me sa më thoshte më se njëri me të cilin u miqësova. Pra dhe unë, me një farë ironie, nuk lashë pa bërë aluzion te ky fakt. Kongresi kishte një arsye kryesore, që ishte tjetër: ai duhet të përgatiste Kongresin eukaristik katolik, i planifikuar të mbahej në Nicë pas një viti dhe të cilit një mbledhje e tillë paraprake e gazetarëve mund t'i shërbente fort. Në krye të punimeve të Kongresit, mund të thuhet se ishte vetë peshkopi i Nicës. Ishte përhapur lajmi se Musolini përgatiste agresionin kundër Shqipërisë. Këtë lajm e pati dhënë në shtypin e Parisit një gazetare shumë e njohur, Zhënëvjevë Tabui (Tabouys), e lidhur me qarqet diplomatike. E solli në Kongres një gazetar zviceran që punonte për revistën "Illustration", për të cilën kishte mbledhur në Itali një numër të mirë fotografish nga jeta e kardinal Paçelit, që sapo u zgjodh Papë, Piu XII. Ishin një hidhërim tepër i rëndë për mua gjithë ato ditë të Kongresit, aq sa nuk doja t'i besoja atij gazetari (e quanin Lui Robert, në se nuk gabohem); ai, në fakt, tregoi për mua shumë dhëmshuri.

Agresioni ngjau, ashtu siç u përhapën me kohë lajmet. Unë nuk përmendem t'i kem shkruar Brankos për zhvillimet e Kongresit të Nicës dhe s'kam këmbyer më letër me të. Po ja që një ditë të asaj pjese të parë të vitit 1939, marr me postë një pako, nga Greqia apo nga Turqia, ku gjej numrin e fundit të "Përpjekjes shqiptare", që nuk kishte mundur të qarkullonte. Ma dërgonte Brankoja! Ishte një lloj përqafimi që më bënte në ato ditë zie që na kishte pllakosur për atdheun e rënë në robëri. Në atë numër, – të cilit Brankoja s'kishte mundur t'i shtypte kapakun, pra e kishte marrë nga shtypshkronja, siguristi në pak kopje, për disa miq të vetët, – ishte një vjershë e Shevqet Musarait, ku qante për fatin që e priste "kasollen" e tij, vjersha "Vajto vëllla", një nga më të qëlluarat e tij dhe që u shkrua në prag të 7 prillit. Kam ngashëryer duke e lexuar atë vjershë e duke lexuar "Përpjekjen shqiptare". Nuk e dija se Brankoja ishte larguar nga atdheu, duhet ta kem mësuar shumë vonë, por e merrja me mend. *(30 tetor 2011)*

ALBUMI

NJË FOTOGRAFI E RRALLË E JERONIM DE RADËS

Qerim VRIONI

Kjo fotografi e veçantë me shënimin "Jeronim De Rada me fshatarë arbëreshë", të shkruar me dorë nga prof. Dhimitër Shuteriqi në paspartimin prej kartoni, ndoshta ka shërbyer si burim kryesor i imazhit të De Radës, poetit të madh të Rilindjes Kombëtare, për portrete në pikturë dhe skulpturë. Fotoja është pjesë e arkivit të madh fotografik të mbledhur nga prof. Shuteriqi, i cili ndër të tjera, njihte mirë mjaft fotografë shqiptarë të gjysmës së parë të shekullit XX. Këtë e ka mësuar autori i këtyre rreshtave nga një bisedë e gjatë që ka pasur me profesorin erudit në vitin 2002. Foton, për të cilën po shkruajmë, na e mundësoi me fisnikëri të veçantë (edhe pse në kushte jo shumë të mira shëndetësore), z.Mynever Shuteriqi, Zonja e Profesorit. Sipas z.Mynever, fotoja është gjetur në Kalabri (Itali) në vitet '30 nga Simon Shuteriqi, studiues dhe pjesëmarrës në Kongresin e Alfabetit të Manastrit (1911), i ati i profesor Dhimitrit. Po ashtu, Zonja e nderuar shtoi se De Rada ka qënë autor shumë i pëlqyer për të shoqin dhe se ai, është marrë mjaft në studimet e tij me Arbëreshin e Madh . Në fotografi paraqitet Jeronim De Rada, autori i poemës së njohur, "Milosao", midis fshatarëve arbëreshë. Emri i tij është i shkruar edhe drejtpërdrejtë në foto me dorë nga ndonjë pronar i hershëm arbëresh i saj. Ndoshta poeti ishte në rrugëtim e sipër, kur ka takuar bashkëkombasit e tij, të cilët mbase e kanë ftuar të fotografohet me ata, dhe ai e ka pranuar me kënaqësi kërkesën e tyre. Nga fotoja duket që poeti qëndron i qetë para aparatit duke u mbështetur te një shkop i gjatë (që e ndihmonte në ecje) dhe me kapelen në dorën e majtë, ndërsa nga supi i tij i djathtë i varet një çantë e madhe (ndoshta me libra). Dy fshatarët përanash poetit janë fotografuar kokëzbuluar, ai majtas, kapelen e hequr e mban poshtë me dorën e majtë, ndërsa i djathti është përngrirë duke e hequr atë (është vonuar ai, ose shpejtuar fotografi). Ndoshta heqja e kapeles ishte shenjë tradicionale respekti e krahinës dhe kohës ndaj fotografimit... ndoshta. Poeti mban rreth qafës edhe një kravatë modeste, e cila krijon një farë diference statusi ndërmjet tij dhe të tjerëve, ndonëse njihen mirë marrëdhëniet e ngrohta të tij me bashkatdhetarët arbëreshë, pavarësisht rangut shoqëror dhe ekonomik. Fotografia është realizuar para një ndërtese në murin e së cilës duket një pjesë e një dritareje të vogël rrethore. Gjithashtu, mesa dijmë, botimi këtu, përbën paraqitjen e parë të kësaj fotografie në shtypin shqiptar. Fotografia ka mbërritur në ditët tona me përmasa relativisht të vogla, pa emrin e autorit, pa përcaktimin e vendit të fotografimit dhe pa shënuar as vitin e shkrepjes, por këto ulin fare pak vlerat e kësaj fotografie të rrallë dokumentare, ndoshta si imazhi më i vërtetë i Poetit të madh të Rilindjes që paraqitet tani, në mbyllje të vitit 2014, Vitit të Madh të De Radës.



Fotoja është pjesë e arkivit të madh fotografik të mbledhur nga prof. Shuteriqi, i cili ndër të tjera, njihte mirë mjaft fotografë shqiptarë të gjysmës së parë të shekullit XX

DIKUR NJERËZIT LEXONIN ME ZË TË LARTË

NDRYSHIMI QË KRIJOI JETËN E BRENDSHME



Në shekullin e 17-të, shoqëria e leximit në Europë ndryshoi në mënyrë drastike. Teknologjia e teksteve, si ajo e llojit të lëvizshëm, dhe rritja e kopjeve të librave ndihmuan në ardhjen e asaj praktike që ne shijojmë sot: përtypja e fjalëve pa i thënë ato me zë të lartë

Njerëzit e mendojnë të lexuarit si një aktivitet privat të njeriut: një kënaqësi e qetë për një person të cilit i pëlqen heshtja, përveçse zërave në kokën e tij. Por në pak a shumë 5 mijë vjet gjatë të cilave njerëzit kanë qenë duke shkruar apo lexuar ashtu si ne e konceptojmë këtë, aktiviteti asocial i njeriut me librin është relativisht formë e re argëtimi apo mbushje e kohës. Për shekuj me radhë, europianët që mund të lexonin, e bënin këtë vetëm me zë të lartë.

TRANZICIONI

Grekët e lashtë i lexonin tekstet e tyre me zë të lartë. Kështu bënin edhe murgjërit e Mesjetës së Europës. Por në shekullin e 17-të, shoqëria e leximit në Europë ndryshoi në mënyrë drastike. Teknologjia e teksteve, si ajo e llojit të lëvizshëm, dhe rritja e kopjeve të librave ndihmuan në ardhjen e asaj praktike që ne shijojmë sot: përtypja e fjalëve pa i thënë ato me zë të lartë, kuptimi i tyre për të ndërtuar botë më vete në kokën tonë. Midis akademikëve, ka një debat habitshëm të ashpër rreth kohës kur shoqëria europiane kaloi tranzicionin nga leximi kryesisht me zë të lartë, tek leximi kryesisht në heshtje – disa madje, thonë se të lashtët lexonin në heshtje po aq sa lexonin edhe me zë – por ka një skenë në letërsi për të cilën pajtohen të gjithë se është thelbësore. Në Pohimet e Shën Augustit, ai përshkruan zakonet e të lexuarit të Ambrozit, peshkopit të Milanos: "Por, kur Ambrozi lexonte, sytë e tij shkonin poshtë e lart faqeve, ndërsa zemra e tij kërkonte për kuptimin e tyre; sidoqoftë, zëri dhe gjuha e tij ishin të heshtura. Shpesh kur ne ishim të pranishëm- pasi secili mund t'i afrohej dhe nuk ishte zakon që vizitorët t'i komunikoheshin – ne e shihnim duke lexuar në këtë mënyrë, në heshtje,

dhe asnjëherë ndryshe".

Fakti që kjo ishte ngjarje kaq e dallueshme për Agustinin, argumentojnë disa akademikë, është për shkak se në vitet 400, leximi në heshtje nuk ishte diçka që ndodhte. Kërkues të tjerë thonë se ky pasazh u shkrua për të nxjerrë më shumë në pah vrazhdësinë e Ambrozit. "Ka të bëjë në të vërtetë me faktin që Ambrozi do të vazhdonte leximin në heshtje ndërkohë që ata ishin atje, sikur dikush të vazhdojë të dërgojë mesazhe ndërsa ti përpiqesh të flasësh me të", thotë D. Vance Smith, historian për Mesjetën në departamentin e Anglishtes së Princeton. "Augustini është i habitur nga vrazhdësia e tij që nuk lexon me zë të lartë për ta ndarë me të".

"Pohimi i zakonshëm në periudhën klasike, është që nëse lexon me zë të lartë mes njerëzve të tjerë është pasi kërkon ta ndash me ta, përmbajtjen", thotë Smith. "Për ne, zakoni është që ne lexojmë në heshtje për ta mbajtur për vete". Nëse leximi në heshtje ishte një fakt i rrallë apo i vrazhdë në kohët e lashta, në një farë pike pritshmëria e lexuesve në shoqëri ndryshoi. Pothuajse në fund të viteve 1700, historiani Robert Darnton shkruan: "Për njerëzit e zakonshëm në fillim të Europës moderne, leximi ishte një aktivitet social. Ndodhte në dyqane, hangare apo taverna. Ishte pothuajse gjithmonë me zë, por jo domosdoshmërisht si leksion".

MARRËDHËNIA E RE

Në kohën që Marsel Prusti shkruante në fund të viteve 1800, me rrëfimtarin e tij që shpresonte të kishte kohë për të lexuar dhe menduar i vetëm në shtrat, leximi në mënyrë private ishte shndërruar më shumë në një normë për njerëzit e pasur dhe të arsimuar të cilët mund të përballonin librat dhe kohën e të menduarit lirshëm në shtrat. Kjo erdhi me përhapjen e arsimimit dhe llojeve të ndryshme të materialeve për lexim. Darnton me të dhëna të hershme deri prej vitit 1750, tregoi se njerëzit që mund të lexonin kishin vetëm pak libra: ndoshta Biblën, një almanak dhe disa shkrime të cilat ata i lexonin dhe rilexonin. Por në vitet 1800, shkruan ai, njerëzit po lexonin më vrullshëm – gazeta dhe revista periodike – dhe deri në fund të shekullit, letërsia kishte krijuar edhe degën për fëmijë dhe romanet. Ndërsa leximi ndryshoi drejtim duke i ikur një aktiviteti social, siç perceptohej, ka kërkues që besojnë se kjo ndihmoi në krijimin e asaj që ne e quajmë sot botë e brendshme. Ashtu si shkruan Alberto Manguel në librin e tij të vitit 1996 "Histori e të lexuarit". Por me të lexuarin në heshtje, lexuesi ishte më në fund në gjendje të vendoste një marrëdhënie të pakufizuar me librin dhe fjalët. Fjalët nuk merrnin më kohën e domosdoshme për t'i artikuluar. Ato mund të ekzistonin në hapësirën e brendshme, të nxitonin apo të mbeteshin aty, të deshifruara plotësisht ose gjysmë-të thëna, ndërkohë që mendimet e lexuesit i inspektonin me rehati, duke marrë kuptime prej tyre, duke lejuar krahasime nga kujtimet apo leksime të mëparshme, duke nxjerrë kuptime të reja. Dhe teksti në vetvete, mbrojtur nga të jashtmit prej kopertinës, u shndërrua në posesion të lexuesit, njohuria intime e lexuesit, kudo ku ata të ndodheshin në një sallon të populluar, në treg apo në shtëpi. "Psikologjikisht, leximi në heshtje e përfshin lexuesin për shkak se e vendos burimin e kuriozitetit të tij tërësisht nën kontroll personal", shkruan bibliotekari Paul Saenger në librin e vitit 1997, "Hapësira midis fjalëve". "Në botën më të gjerë të të folurit të shekullit të nëntë, nëse spekulimet intelektuale të dikujt ishin heretike, ato ishin subjekte të korrektimit të të tjerëve dhe të kontrolluara në çdo moment, që nga formulimi deri tek publikimi apo pritja nga lexuesi". Ashtu si shkruan Saenger, të lexuarit asocial ndihmon fuqinë intelektuale, vështrimin e brendshëm, kriticizmin ndaj qeverisë dhe fesë, madje ironinë dhe cinizmin që do të ishte i pakëndshëm nëse lexohej me zë të lartë. Ky trend i ri i çuditshëm i të lexuarit për veten, natyrisht kishte edhe kundërshtarët e vet. Skeptikët mendonin se të lexuarit në heshtje tërheq ëndërrimtarët me sy hapur dhe mëkatin e plogështisë, siç shkruan Manguel. Madje edhe më keq: "Lejon njerëzit të mësojnë dhe të reflektojnë pa drejtim fetar apo censurë. Leximi në heshtje deri në fund të shekullit të 19-të ishte kaq popullor saqë njerëzit druheshin se gratë në veçanti, duke lexuar të vetme në shtrat, nxiteshin nga mendime të rrezikshme.

FUNDI

Nuk ka shumë konsensus midis historianëve përse njerëzit nisën të lexojnë në heshtje. Saenger ngre hipotezën se ndryshimi në mënyrën sesi fjalët rreshtoheshin në faqe, lehtësoi kalimin. Saenger argumenton se murgjit irlandezë, duke përkthyer nga latinishtja në shekullin e shtatë, shtuan hapësirën midis fjalëve, gjë që do i ndihmonte ata për të kuptuar gjuhën më mirë. Ky ndryshim kyç në dizenjim, thotë ai, lehtësoi rritjen e të lexuarit në heshtje. B. Parkes, në librin e vitit 1992 "Pauza dhe ndikimi: shenjat e pikësimit në Perëndim", argumenton se "lexueshmëria e gramatikës – ndryshimet vizuale që u bënë në tekste, si pikësimi dhe ndarja e fjalëve – ndryshuan mënyrën sesi ne lexojmë. Kjo teknologji në librat e parë u bë me idenë se shkrimtarët apo ata që shkruanin tekstet e të tjerëve, nuk e dinin se kush do të ishin lexuesit apo sesa lehtësisht mund të lexonin ata latinisht, kështu që duhej të gjenin një mënyrë të standardizuar sesi t'u tregonin atyre si të lexonin: pusho këtu, ka dy fjalë të ndara, kjo është një a e gjatë etj. Kjo njohuri aplikohet për pjesën më të madhe të të shkruarit dhe të të lexuarit me bazë latinishten në Europë. Në kultura të tjera të mëdha të botës si ajo kineze, tekstet e së cilës nuk kanë hapësirë mes fjalëve, dhe letërsia e së cilës varet rëndësishëm nga ritmi, të lexuarit e heshtur mund të jetë zhvilluar ndryshe. Rrëfime të pranuara historike do të na bënin të besojmë se fundi i të lexuarit me zë në Mesjetë ishte pjesë e Rilindjes, një lëvizjeje të re europiane që merrej me individin. Por, është e mundshme që dëshira e njerëzve për privatësi, dëshira për pak hapësirë ku të mund të arratiseshe së bashku me librin, të ishin po aq të forta.

(tesheshi.com)

PESË LOJTARËVE TË RENOVËS U PËRFUNDOI KONTRATA

KLUBI DËSHIRON TI MBAJË, PRITET TË FILLOJNË BISEDIMET

Emran Ramadanit, Saimir Fetahit, Burim Sadikit, Bashkim Veliut dhe Filip Petkovskit u kanë skaduar kontratat, ndërsa drejtuesit e klubit me të gjithë pritet të fillojë bisedimet për të vazhduar bashkëpunimin me ata

Koha — Bujar KURTAJ

Shkup, 11 dhjetor - Pas përfundimit të sezonit vjeshtor në përjashtim të Shkupit, Vardarit dhe Rabotniçkit, të gjitha skuadrat tjera kanë shkuar në pushim të merituar. Si rezultat i kësaj skuadrat kanë filluar të projektojnë goditjet për sezonin pranveror por edhe bisedimet me ata lojtar që u kanë skaduar kontratat respektive. Njëra nga këto skuadra është edhe KF Renova, e cila pritet të filloi bisedimet me pesë futbollistë të cilëve u ka skaduar kontrata, ndërsa ata janë Emran Ramadani, Saimir Fetahi, Burim Sadiki, Bashkim Veliu dhe Filip Petkovski. Sipas ndihmëstrajnerit Dashmir Beari, drejtuesit e klubit dëshirojnë që të gjithë këta, të jenë pjesë e Renovës edhe në të ardhmen. Pesë futbollistëve si Emran Ramadanit, Saimir Fetahit, Burim Sadikit, Bashkim Veliut dhe Filip Petkovskit u kanë skaduar kontratat, ndërsa drejtuesit e klubit me të gjithë pritet të fillojë bisedimet për të vazhduar bashkëpunimin me ata. Mbetet që të shihet se si do të përfundojnë bisedimet pasi kjo varet edhe nga futbollistët, të cilët siguristh se i kanë kërkesat e tyre për vazhdimin e bashkëpunimit", shprehet për gazetën KOHA, Beari. Ndryshe, Beari tha se deri më tani askush nuk është larguar nga klubi, ndërsa pranoi se klubi ka nevojë së paku për pesë apo gjashtë përforcime. "Deri më tani askush nuk ka paralajmëruar se do të largohet nga klubi në përjashtim të atyre që përmendem se u kanë skaduar kontratat. Kemi nevojë së paku për pesë apo gjashtë futbollist të ri. Deri më tani asgjë nuk ka zyrtare, gjithçka pritet të ndodh gjatë ditëve në vijim", nënvizoi më tej ndihmstrajneri i bardhebluve. Beari gjithashtu foli edhe për sezonin vjeshtor, ndërsa pranon se nuk është i kënaqur me rezultatet e arritura, derisa ndikim kanë pasur edhe referat. "Pozita e tetë nuk mund të jetë rezultat i mirë, por mos të harrojmë se në katër apo pesë ndeshje kemi qenë të dëmtuar nga referat. Nuk e di pse kjo po i bëhet Renovës, por në rezultatin e përgjithshëm kanë ndikim të madh edhe ata. Në të kundërtën nuk do të ishim aty ku jemi tani, pozitën e tetë në tabelën e klasifikimit. Shpresojmë se në sezonin pranveror kjo dukuri e keqe do të ndryshojë dhe do të kemi referim real", thotë ndihmësi i Kostovit, i cili në fund shpalosi synimin kryesor të Renovës, pos mbijetesës. "Në pranverë ne do të tentojmë të ngjitemi në kreun e tabelës, ndërsa synimi jonë mbetet edhe Kupa e Maqedonisë ku jemi në gjysmëfinale. Vetëm nëpërmjet këtij kompeticioni ne mund të dalim në Evropë, andaj do të tentojmë që ta fitojmë dhe të realizojmë objektivin", përfundoi Dashmir Beari, ndihmëstrajneri i KF Renova.

• Saimir Fetai

• Filip Petkosvki

• Emran Ramadani


• Bashkim Veliu

• Burim Sadiki

Dashmi Beari

Pozita e tetë nuk mund të jetë rezultat i mirë, por mos të harrojmë se në katër apo pesë ndeshje kemi qenë të dëmtuar nga referat. Nuk e di pse kjo po i bëhet Renovës, por në rezultatin e përgjithshëm kanë ndikim të madh edhe ata. Në të kundërtën nuk do të ishim aty ku jemi tani, pozitën e tetë në tabelën e klasifikimit

PAS ÇELLSIT, LACIOS E NAPOLIT

Njukasëll shfaq interesim për Rashicën

Trajneri spanjoll i Njukasëll, Rafa Benitez po konsideron një sulm në janar në kampionatin holandez, Eredivisie, tek lojtari i Përfaqësueses së Kosovës, Milot Rashica. Mesfushori me tipare sulmues i Viteze Arnhem, Rashica, thuhet se i është ofruar Benitezit nga skautët e Too-it për zbulimin e talenteve. Rashica, 21 vjeç, është një reprezentues i Kosovës, ndërsa më parë ka qenë edhe pjesë e Kombëtares së Shqipërisë dhe kjo ka rritur interesimin për shërbimet e tij. Djaloshi nga Vushtrria është konsideruar lartë për paraqitjet e tij në Holandë dhe Njukasëll është një destinacion interesant për të. Megjithatë, planet e transferimeve të Benitezit thuhet se po komplikohen nga negociatat e marrjes së klubit nga pronarët e rinj. Gjithashtu në këto tratativa po krijohen vështirësi nga skuadra e madhe angleze, Çellsi, të cilat gëzojnë një partneritet formal me Vitezen. Çdo shitje e madhe nga klubi holandez duhet të drejtohet nga Çellsi para se të miratohet. Përveç Njukasëll, interesim për yllin e Kosovës thuhet se ka shprehur edhe skuadrat e mëdha italiane, Napoli dhe Lazio.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune–tekst i spastruar (,,Gazeta zyrtare e RM,, nr. 74/2015) dhe neni 80 dhe 82 të Ligjit për arsim fillor (,,Gazeta zyrtare e RM,, nr. 103/2008, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/2016 dhe 67/2017) dhe pëlqimi i marrë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Drejtori i shkollës fillore komunale "Përparimi" f. Reçicë e Madhe, Tetovë, publikon këtë:

SH PA LL J E

Përplotësimin e vendeve të lira të punës në kohë të CAKTUAR deri me 31.08.2018
MËSIMI ZHVILLOHET NË GJUHËN SHQIPE për vitin shkollor 2017/18

1. Një arsimtar për fizikë me fond 14 orë në javë, orari i punës paradite prej ora 07^{00} deri ora 13^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 14.462,00 denarë, shkollim i kryer studime nga fizika- drejtimi mësimor VII/1 Te 240 kredi; studime dy lëndore, grupi matematiko-fizikë, fizik-kimi,VII/1 Te 240 kredi.
2. Një arsimtar të shkencave natyrore me 8 orë në javë orari i punës para dite prej ora 07^{00} deri 13^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 8.356,00 denarë, shkollim i kryer studime në biologji; studime në kimi,studime në fizik,drejtimi mësimor ,VII/1 kryesisht 240 kredi;
3. Një arsimtar për arsim qytetar me fond 7 orë në javë orari i punës para dite prej ora 07^{00} deri 13^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 7.406,00 denarë, shkollim i kryer arsimtare që i ka kryer studimet nga sociologjia.
4. Një arsimtar për etikë me fond 4 orë në javë orari i punës para dite prej ora 07^{00} deri 13^{00} prej të hënës deri të premten,,me neto rrogë 4.218,00 denarë, shkollim i kryer ,fakulteti i filozofisë, me titull profesor i diplomuar i filozofisë.
5. Një arsimtar për inovacion me fond 3 orë në javë orari i punës para dite prej ora 07^{00} deri 13^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 3.097,00 denarë, shkollim i kryer studime te mbaruara të ekonomisë, shkalla VII/1 me përgatitje adekuate pedagogjike-psikologjike, studime të mbaruara për arsimtarë, studime tjera VII/1 apo(240 EKTS) me përgatitje pedagogjike-psikologjike.
6. Një arsimtar për etika në religjion me fond 8 orë në javë, orari i punës para dite prej ora 07^{00} deri 13^{00} prej të hënës deri të premten,me neto rrogë 8.356,00denarë, shkollim i kryer profesor-specialist i metodikës për mësimin dhe arsimin religjioz.
7. Një arsimtar për gjeografi me fond 8 orë në javë, orari i punës para dite prej ora 07^{00} deri 13^{00} të hënën deri të premten, me neto rrogë 8.356,00 denarë, shkollim i kryer studimet e përfunduara nga gjeografia, drejtimi mësimor,VII/1kryesisht 240 kredi
8. Një arsimtar për grup klasor me fond 20 orë në javë,(deri në kthim të punëtorit nga funksioni) , orari i punës pas dite prej ora 12 ^{00}deri 19 ^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 20.657,00 denarë, shkollim i kryer fakulteti pedagogjik-profesor për mësimdhënie në klasat e ulëta, përkohësisht profesor për edukim parashkollorë, fakultetin filozofik-instituti i pedagogjisë-pedagog i diplomuar.
9. Një arsimtar për grup klasor me fond 20 orë në javë, orari i punës pas dite prej ora 12 ^{00}deri 19 ^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 20.657,00 denarë, shkollim i kryer fakulteti pedagogjik-profesor për mësimdhënie në klasat e ulëta, përkatësisht profesor për edukim parashkollorë, fakultetin filozofik-instituti i pedagogjisë-pedagog i diplomuar.
10. Një arsimtar për grup klasor me fond 20 orë në javë,(deri në kthim të punëtorit nga pushim i lindjes) , orari i punës pas dite prej ora 12 ^{00}deri 19 ^{00} prej të hënës deri të premten, me neto rrogë 20.657,00 denarë, shkollim i kryer fakulteti pedagogjik-profesor për mësimdhënie në klasat e ulta, përkohësisht profesor për edukim parashkollorë, fakultetin filozofik-instituti i pedagogjisë-pedagog i diplomuar.

KUSHTET :

Krahas kushteve të përgjithshme sipas Ligjit për marrëdhënie pune kandidati duhet ti plotësoj edhe kushtet e parapara nga Ligji për arsim fillor.
Kandidatët duhet të dorëzojnë:Lutje për themelim të marrëdhënies së punës; diplomë për arsimin e kryer;certifikatë e shtetësisë; vërtetim se nuk janë nën hetime dhe të gjykuar; certifikatën e lindje; certifikatë mjekësore. Dokumentet të dorëzohen ne forme origjinale ose te noterizuar.
Konkursi mbetet i hapur **5** (pesë) ditë pune nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit, zgjedhja do të bëhet në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së të shpalljes.
Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen pranë shkollës fillore komunale,,Përparimi,, në fsh. Reçicë e Madhe,Tetovë, telefon 044/481-352.
Dokumentet e pakompletuara dhe ato të dërguara jashtë afatit, nuk do të shqyrtohen.
Drejtor i shkollës

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015) dhe nenit 71 të Statutit të SHFK "Todor Janev" – Çashka, ndërsa në lidhje me vendimin e Komunës Çashka me nr. 04-1308/2 të datës 22.11.2017, Këshilli drejtues i shkollës publikon:

SHPALLJE PUBLIKE PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT

Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:
- të kenë të mbaruara arsimin sipëror;
- të kenë së paku 5 vjet përvojë pune në institucion edukativo-arsimor të verifikuar nga MASH;
- të përmbushë kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në arsim fillor;
- të ketë të dhënë provim për drejtor;
- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- të mos jetë i dënuar për vepra penale, të cilat e bëjnë të papërshtatshëm për kryerje të punës edukativo-arsimore.
- të jetë i shëndoshë psikofizikisht dhe i aftë për punë

Kandidatët të cilët do të paraqiten në konkurs duhet të parashtrojnë dokumentet në vijim:
- CV me Letër motivimi;
- Dëshmi për arsim sipëror të mbaruar;
- Vërtetim për përvojë pune në institucion edukativo-arsimor
- Vërtetim se nuk është i dënuar për vepra penale të cilat e bëjnë të papërshtatshëm për punë edukativo-arsimore;
-Vërtetim mjekësor me të cilën do të dëshmojë se është i shëndoshë psikofizikisht
- Dëshmi për provim të dhënë për drejtor;
- Certifikatë të shtetësisë;
- Program për punë për periudhë prej 4 vjet.
- Vërtetime të tjera dhe dokumente për kualifikime të arritura

Shpallja publike zgjatë tetë (8) ditë pune duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor, ndërsa zgjedhja do të realizohet në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të së njëjtës.
Lutja me dokumentet e bashkëngjitur parashtrohet deri në Këshillin e shkollës në SHFK "Todor Janev" – Çashka, personalisht në adresën 8-mi Septemvri numër 1, Çashka.
Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

KËSHILLI I SHKOLLËS SË SHFK "Todor Janev" – Çashka

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup, me propozim të Dekanit të Fakultetit për art muzikor në Shkup, publikon

K O N K U R S

për zgjedhje të:
- ➢ një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:
- *Llojet e instrumenteve (violina),* për lëndët: Violina, Pjesa orkestrale për violinë, Muzikë kamertale për instrumente me tela dhe Metodika e mësimit për instrumente me tela;

- ➢ një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:
- *Llojet e instrumenteve (tub, trombone),* për lëndët: Tub, Trombone, Pjesa orkestrale për tub dhe trombone, dhe Muzikë kamertale për instrumente frymore pa themelim të marrëdhënies së punës.

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.
Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.
Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.
Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.
Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.
Dokumentet dorëzohen në Fakultetin për art muzikor në Shkup, rr. Pitu Guli nr. 1, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup

Në bazë të nenit 131 paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 135 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/08.....127/16); nenit 40 të Rregullores për marrëdhëniet e brendshme dhe të punës së Fakultetit Pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup, në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 287/2014), dhe nenit 34 paragrafi 1 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare 274/2013), Këshilli mësimor-shkencor i Fakultetit pedagogjik "Shën Kliment Ohridski" në Shkup, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 6.11.2017 ka sjell Vendim për publikimin e:

K O N K U R S
Për zgjedhje të një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor:

1. Të bëhet zgjedhje e një realizuesi në të gjitha titujt mësimor-shkencor nga sferat:

1.1. Metodika edukimit figurativ, për lëndët:
- Bazat e edukimit figurativ dhe Edukim figurativ me metodikë (lëndë obligative për grupin studimor Edukim parashkollor për mësimin në gjuhën shqipe) dhe
- Bazat e edukimit figurativ dhe Edukim figurativ me metodikë (lëndë obligative për grupin studimor mësimi klasor për mësimin në gjuhën shqipe);

1.2. Teatrologjia për lëndën:
- Kukullat dhe skenografia (lëndë zgjedhore për grupet studimore Edukim parashkollor dhe Mësimi klasor për mësimin në gjuhën shqipe);

1.3. Pikturim dhe vizatim, për lëndën:
- Teknikat e pikturimit dhe vizatimit në art figurativ (lëndë zgjedhore për grupet studimore Edukim parashkollor dhe Mësimi klasor për mësimin në gjuhën shqipe) dhe

1.4. Krijime, për lëndën:
- - Punëtori kreative e artit figurativ (lëndë zgjedhore për grupet studimore Mësimi klasor dhe Edukim parashkollor për mësimin në gjuhën shqipe).

Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs, krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet nga Ligji për arsim sipëror, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë duhet të parashtrojnë:
- fletëparaqitje;
- biografi të shkurtë;
- diplomë për arritje të shkallës shkencore doktor i shkencave nga sfera shkencore për të cilën zgjidhet;
- formular të plotësuar ndaj raportit për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues, që mund të merren në arkivin e Fakultetit
- Deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe
- certifikatë të shtetësisë.

Fletëparaqitjet e kandidatëve parashtrohen përmes postës në arkivin e Fakultetit, në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor.

Kandidati i zgjedhur do të lidhë marrëdhënie pune për kohën që do të zgjidhet.

Dekan
Prof. d-r Emil Sulejmani

Në bazë të nenit 135, paragrafi 1 e Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e RM nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/09, 115/2010, 17/2011, 51/2011, 123/2012, 15/2013, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 130/2014, 10/15, 20/2015, 98/2015, 145/2015, 154/2015, 30/2016, 120/2016, 127/2016), nenit 34 paragrafi 1 e Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/2009, 140/2009, 173/2011, 194/2011, 250/2013 dhe 274/13), dhe vendimit të Këshillit mësimor-shkencor, dekani i Fakultetit të edukatës fizike, sportit dhe shëndetit në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

Për zgjedhje të

- Një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore - shkencore: kinezologjia aplikative, për lëndët: sportet luftarake 1 (boks, mundje), kik-boks, teoria dhe metodika e boksit, teknika dhe taktika e boksit, përgatitja fizike e boksit, praktika pedagogjike me përpilim të punës diplomike në boks.
(zgjedhja është për kohë prej pesë vite)

- Një mësimdhënës në thirrjen titullare në sferën mësimore-shkencore: kinezologjia fundamentale, për lëndën didaktika e edukatës fizike dhe sportit.
(zgjedhja është për kohë prej pesë vite)

Kushtet: Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.
Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrojnë: biografi të shkurtë, dëshmi për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, certifikatë të shtetësisë.
Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror, Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.
Orari i punës së mësimdhënësit është për kohë të caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.
Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.
Fletëparaqitja së bashku me dokumentacionin e nevojshëm të dorëzohen në adresën: Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet në Shkup, rr. Dimçe Mirçev nr. 3, 1000 Shkup, Fahu P. 681

Fakulteti për arsim fizik, sport dhe shëndet – Shkup

Në bazë të nenit 135 paragrafi 1 të Ligjit për arsim të lartë ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 35/2008; 103/2008; 26/2009; 83/2009; 99/2009; 115/2010; 17/2011; 51/2011; 123/2012; 15/2013; 24/2013; 41/2014; 116/2014; 130/2014; 10/2015; 20/2015; 98/2015; 145/2015; 154/2015, 30/2016, 120/2016 dhe 127/2016) dhe nenit 34 paragrafi 2 i Rregullores për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional, bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 138/09, 140/09, 173/11, 194/11, 250/2013 dhe 274/2013), rektori i Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup, me propozim të u. d Dekanit të Fakultetit të Stomatologjisë në Shkup, publikon

K O N K U R S

për zgjedhje të:
- ➢ Katër (4) mësimdhënësve në të gjitha titujt mësimor-shkencor, për grupin e lëndëve, në sferën mësimore-shkencore:
- *protetika;*
- ➢ Një (1) mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, për grupin e lëndëve, në sferën mësimore-shkencore:
- *ortodontia;*
- ➢ Katër (4) mësimdhënësve në të gjitha titujt mësimor-shkencor, për grupin e lëndëve, në sferën mësimore-shkencore:
- *patologjia orale;*
-*parodontologjia;*
- ➢ Tre (3) mësimdhënësve në të gjitha titujt mësimor-shkencor, për grupin e lëndëve, në sferën mësimore-shkencore:
- *stomatologjia për fëmijë;*
-*stomatologjia preventive;*
- ➢ Dy (2) mësimdhënësve në të gjitha titujt mësimor-shkencor, për grupin e lëndëve, në sferën mësimore-shkencore:
-*patologjia dentale;*
- ➢ Një (1) mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor, për grupin e lëndëve, në sferën mësimore-shkencore:
- *kirurgjia orale.*

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme, kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe aktet tjera të Universitetit.
Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë edhe: biografi të shkurtër, deklaratë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës dhe certifikatë të shtetësisë.
Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurat për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë - doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.
Orari i punës së mësimdhënësit është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.
Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit.
Dokumentet dorëzohen në Fakultetin për art muzikor në Shkup, rr. Nëna Terezë nr. 43, 1000 Shkup.

Universiteti "Shën. Kirili dhe Metodij" në Shkup

NËSE DËSHMOHEN PRETENDIMET E SHTETIT

RONALDO MUND TË DËNOHET ME 30 MLN EURO

Një prej armëve më të forta në favor, do të jetë deklarata në datë 22 dhjetor, në sallën numër 1 të gjykatës, e Pozuelo de Alarkon, teknikut të firmës së avokatisë "Garrigues", që bëri edhe akuzat e mashtrimit. Si rezultat i këtyre akuzave, Agjencia e Taksave hartoi një ankesë kundër Kristiano Ronaldo për katër krime që pretendohet të jenë bërë për të çuar mashtrimin në shumën totale prej 14 768 897 euro

Dëshmitari dhe eksperti i Thesarit konfirmoi të enjten e kaluar përpara prokurores Monika Gomez Ferrer, në lidhje me akuzën kundër yllit të Real Madridit, Kristiano Ronaldo, ndaj të cilit Agjencia e Taksave ka ngritur pretendimin për 14.8 milionë euro evazion fiskal. Referuar gazetës së madhe spanjolle "AS", Eva GM është inspektorja që mori disa minuta kohë nga Hoze Murinjo dhe Angel Di Maria, respektivisht ish-trajnerit dhe ish-lojtarit të Real Madrid, që gjithashtu raportoi në zyrën e prokurorit. Ky ekspert do të dëshmojë si dëshmitar në çështjen "Cristiano Ronaldo" më datë 22 dhjetor. Zyra e Prokurorit Publik mban ankesën dhe parashikohet se vlera që do të duhet të paguhet nga Kristiano Ronaldo, në rast se do të dëshmohet se pretendimet e Shtetit qëndrojnë dhe gjykohen të sakta, nuk do të zbres poshtë 30 milionë euro, mes shumës së evazionit plus gjobës dhe interesave të përllogaritur. Avokati i KR7, José Antonio Çoklan, deklaroi se futbollisti i Real Madrid ka bërë gjithçka shumë mirë dhe në komfor me ligjet, dhe se do të fitojë çështjen. Një prej armëve më të forta në favor, do të jetë deklarata në datë 22 dhjetor, në sallën numër 1 të gjykatës, e Pozuelo de Alarkon, teknikut të firmës së avokatisë "Garrigues", që bëri edhe akuzat e mashtrimit. Si rezultat i këtyre akuzave, Agjencia e Taksave hartoi një ankesë kundër Kristiano Ronaldo për katër krime që pretendohet të jenë bërë për të çuar mashtrimin në shumën totale prej 14 768 897 euro. Të hënën, më 22 dhjetor, një tjetër avokat i KR7, Osorio de Kastro do të dëshmojë gjithashtu.

Publicitet

Në bazë të nenit 3 të Rregullores për kriteret, kushtet dhe procedurën për "Zgjedhje të sportisteve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit", organizatori "Lidhja e federatave sportive të Maqedonisë", publikon:

KONKURS
Për ndarjen e çmimeve dhe mirënjohjeve në zgjedhjen e sportisteve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit për vitin 2017

1. "Lidhja e federatave sportive të Maqedonisë" ngritë procedurë për Zgjedhje të sportisteve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit për vitin 2017.

2. Zgjedhja e sportisteve dhe sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit, ndahet për rezultate të arritura në sport individual dhe ekipor gjatë vitit aktual, të sportistëve dhe trajnerëve të cilët marrin pjesë për ekipe sportive, selia e të cilave është në Shkup.

3. Të drejtë për propozimin e kandidatëve për Zgjedhje të më të suksesshmëve, kanë ekipet sportive, dhe anëtarët e tyre, selia e të cilave është në Shkup.

4. Propozimet për Zgjedhje të sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit, janë për kategoritë në vijim:

- 10 sportistët më të suksesshëm në kategorinë e seniorëve (meshkuj dhe femra);
- 5 sportistët më të suksesshëm në kategorinë e të rinjve (meshkuj dhe femra);
- Trajneri më i suksesshëm;
- Ekipi më i suksesshëm sportiv nga Shkupi;
- Sportisti/ja më i/e suksesshëm/e – i huaj i cili luan në ekip nga Shkupi dhe
- Sportisti/ja më i/e suksesshëm/e në kategorinë e personave me nevoja të posaçme.

5. Kriter për realizimet sportive janë rezultatet e arritura në kampionatet olimpike, botërore, evropiane dhe gara të tjera ndërkombëtare.
Në garat përkatëse ku është realizuar rezultati sportiv, kushtet për nominim të sportistëve në sportet individuale në zgjedhjen e sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve më të suksesshme sportive të Qytetit të Shkupit janë:

- Në Kampionat botëror ku marrin pjesë minimum 30 vende dhe në të njëjtën marrin pjesë së paku 8 garues në konkurrencë individuale dhe kanë realizuar së paku dy fitore;
- Në Kampionat evropian ku marrin pjesë minimum 15 vende dhe në të njëjtën marrin pjesë së paku 8 garues në konkurrencë individuale dhe kanë realizuar së paku dy fitore.

6. Klubet dhe anëtarët nga ekipet sportive radhiten përmes pjesëmarrjeve në garat e mëdha, të cilët marrin pjesë më herët në gara në kualifikime dhe grupe në ligë evropiane të kampionëve, euro ligat, kupat evropiane dhe gara të tjera rajonale.

7. Nominimet për kategoritë e lartpërmendura sportive i dorëzojnë klubet sportive dhe anëtarët e tyre të cilat gravitojnë në rajonin e Qytetit të Shkupit, me dokumentacion të rregulluar: kopje të regjistrimit të subjektit me seli në Shkup, kopje të librezës së regjistrimit të sportistit të nominuar për pjesëmarrje në gara gjatë vitit aktual, dokument zyrtar për rezultatet e arritura sportive të publikuara në buletine, ueb faqe, kod sisteme etj.

8. Shpallja publike zgjatë shtatë (7) ditë duke llogaritur nga dita e publikimit.
(prej më 12.12 deri më 18.12.2017 deri në ora 15.00)
Propozimet dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të vulosur, çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 15:00 në hapësirat e Lidhjes së federatave sportive të Maqedonisë në hapësirën e galerive me sallën Parku i Qytetit në rrugën nr. 1732 Shkup, me shenjë "Departamenti për sport" për "Zgjedhje të sportistes dhe sportistit, trajnerit, ekipit sportiv më të suksesshëm të Qytetit të Shkupit për vitin 2017".

Lidhja e federatave sportive të Maqedonisë
- Qyteti i Shkupit, "Departamenti për sport"
- Komisioni për zgjedhje të sportistëve, trajnerëve dhe ekipeve sportive më të suksesshëm të Qytetit të Shkupit,
dhe ndarja e çmimeve dhe mirënjohjeve"

I lumtur te Valencia

Geofrej Kondogbia ka thënë se është i lumtur te Valencia. Francezi nuk pranoi të flet për titullin edhe pse është vetëm pesë pikë nga Barcelona që vazhdon në vendin e parë. "Në futboll nuk i dihet kurrë", tha Kondogbia. "Jam mirë dhe i rehatshëm këtu. Trajneri dhe bashkëlojtarët po më ndihmojë. Jam i lumtur, por më duhet të fokusohem në punën time në mënyrë që të bëjë më të mirën për Valencian.
Do të shikojmë se çfarë do të ndodh këtu. Nuk po shikoni tabelën? Mendoj se tani është ashtu. Janë dy ekipe më të mira se ne, duhet të jemi të përulur. Megjithatë, jemi të sigurt dhe duam të fitojmë lojëra, Kemi ambicie", deklaroi francezi. Kondogbia u huaza te Valencia gjatë verën nga Interi, por klubi spanjoll ka të drejtën e blerjes për 25 milionë euro.

Publicitet

I nr. 1958/2016

SHPALLJE PUBLIKE
Sipas nenit 46-b të Ligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për përmbarim Gazeta Zyrtare e RM nr. 8 të datës 17.01.2008 ndërsa në lidhje me nenin 265 të LP Gazeta Zyrtare e RM nr. 72/2016 të datës 12.04.2016

Përmbaruesi **Aleksandar Kuzmanovski** nga **Gostivari** në bazë të kërkesës për realizim të përmbarimit nga kreditori Hallk Bank SHA Shkup nga Shkupi me seli në rr. "Sv. Kiril i Metodi" nr. 54, bazuar në dokumentin për përmbarim Aktit noterial ODU nr. 121/2015 të datës 20.02.2015 të Noterit Përparim Rexhepi, Gostivar, kundër borxhliut Ardijan Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë dhe debitorit të pengut Qemal Ramadani nga Gostivari me seli në f. Bellovishtë, për realizim të përmbarimit në vlerë prej 1.216.747,00 denarë për lëndën përmbaruese të regjistruar nën **I nr. 1958/2016** të datës 06.12.2017:

FTON
1. Borxhliun Ardijan Ramadani dhe debitorin e pengut Qemal Ramadani të dy nga Gostivari me seli në f. Bellovishte, për shkak të dorëzimit të:
-Konkluzionit për mënyrën e shitjes së patundshmërisë I nr. 1958/2016 të datës 14.07.2017.
-Konkluzion për përcaktim të vlerës së patundshmërisë në bazë nenit 165 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017.
-Konkluzion për Shitjen publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017 të gjitha të Përmbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gotivari.
-Raport për vlerën e realizuar të vlerës së tregut të pronës së patundshme nr. 0802-355/2 të datës 20.11.2017 të Shoqërisë për shërbime MEDIUS TERRA SHPKNJP Shkup.
2. Personin Zhivka Ançevska nga Shkupi me banim në bul. Ilinden 9-4 për shkak të dorëzimit të:
- Lajmërimit nga data 29.11.2017.
- Konkluzion për Shitjen publike me gojë në bazë të nenit 169, nenit 169, nenit 170 të LP I nr. 1958/2016 të datës 23.11.2017 të gjitha të Përmbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gotivari.
Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në shtypin ditor.
PARALAJMËROHEN borxhliu **Ardijan Ramadani**, debitori i pengut **Qemal Ramadani** dhe personi **Zhivka Ançevska** se mënyra e këtillë e dorëzimit konsiderohet si e rregullt dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i bartë vetë pala.
Kjo shpallje paraqet SHPALLJEN E DYTË.

Përmbarues
Aleksandar Kuzmanovski

Lajmërim

NBI Lidia Dimkovska – Lide Farm nga Kumanova me seli në rr. ZH. J. Shpanac 2/30 Kumanovë, ka ndërprerë punën.

LIGA E KAMPIONEVE, HEDHET SHORTI PËR 1/8 E FINALES

SHORT I VËSHTIRË PËR REALIN DHE BARCELONËN

Është hedh shorti i Ligës së Kampionëve në Nion të Zvicrës. Përballja më interesante do të jetë ajo mes fituesit aktual të Çampions Real Madridit dhe Paris Sen Zhermenit, si dhe ajo mes Çellsit dhe Barcelonës

Shorti i hedhur dje në Nion të Zvicrës, i vlefshëm për 1/8 finale të Çampionsit, ka përvijuar, mes të tjerash, edhe një finale të parakohshme, sikurse është Real Madrid-PSZH. Galaktikët e trajnerit Zinedin Zidan do të sfidojnë "sheikët" e PSZH-së, me në krye "tridentin" Kavani-Nejmar-Mbappe. Në stolat respektive të dy skuadrave janë "ndërruar kombësitë": Te Reali drejton një francez, ndërsa te PSZH-ja një spanjoll. Derisa, shorti i Ligës së Kampionëve ka qenë shumë i veçantë, por për dikë edhe i padëshirueshëm. I tillë ka mundur të jetë për Lionel Messin, i cili do të ketë përballë kundërshtarin më të padëshiruar – Çellsin. Barca luan ndaj Çellsit në ndeshjen e parë të fazës së eliminimit direkt dhe Messi do të hyjë në këtë duel duke mos shënuar kurrë gol ndaj klubit londinez. Në tetë përballjet e kaluara, Messi ka dështuar të shënojë ndaj Çellsit. Ky është rekordi më i keq i Messit ndaj një klubi në karrierën e tij, dhe mbetet të shihet nëse ai do ta thyejë tabunë në dy ndeshjet e ardhshme ndaj gjigantit anglez. Ai ka realizuar 29 goditje ndaj Bluve në karrierën e tij – por madje huqi edhe penalti ndaj Petr Çeh. Lionel Messi do të tentojë të dëshmojë se është më i miri dhe pa dyshim të thyejë tabunë e tij të vetme në karrierë – Çellsin. Ndërkohë, përballja e cila zgjon interesim është edhe ajo mes Juventusit dhe Totenhemit dhe Seviljës me Mançester Junajtedin. Ndeshjet e para zhvillohet më datë 13/14 dhe 20/21 shkurt 2017, ndërsa ato të kthimit me 6/7 dhe 13/14 mars.

Massimiliano Allegri

Kush nuk do ta priste 'Wembleyn', një prej tempujve të shenjtë të sportit. Totenhemi ka skuadër të re me talent, por nëse ne jemi Juve do t'ia dalim

DYSHET:
JUVENTUS – TOTENHEM
BAZEL - MANÇESTER S.
PORTO – LIVERPUL
SEVILLA - MANÇESTER J.
REAL MADRID – PSZH
SHAKHTAR D. – ROMA
ÇELLSI – BARCELONA
BESHIKTASH - BAJERN M.

Guillermo Amor

E dinim se gjasat ishin të mëdha të na binte Çellsi dhe kështu ndodhi, e mirëpresim. Nëse doni të fitoni, duhet t'i mposhtni të gjithë. Do t'i futemi këtij dueli me optimizëm, vetëbesim dhe dëshirë të madhe për të kaluar tutje

DYSHET, LIGA EVROPË
BORUSSIA D. – ATALANTA
NICA – LOKOMOTIV M.
KOBENHAVN – ATLETIKO M.
SPARTAK M. – ATLETIK B.
AEK – DINAMO KIEV
SELTIK – ZENIT
NAPOLI – LAIPZIG
CRVENA ZVEZDA – CSKA M.
LION – VILARREAL
REAL S. – SALZBURG
PARTIZAN – VITORIA PLZEN
STEAUA – LACIO
LUDOGORETS – MILAN
ASTANA – SPORTING
OSTERSUND – ARSENAL
MARSEJ – BRAGA

Unai Emeri

Nuk mendoj se është shorti më i keq i mundshëm. Është një mundësi e mirë, sepse tashmë e kemi një nivel për të luajtur kundër Real Madridit. Nëse doni të bëni diçka të rëndësishme në Çampions, atëherë ju duhet të luani kundër Real Madridit. Për të mposhtur "Los Blancos", ne do të duhet të luajmë me personalitetin dhe talentin tonë, sepse loja do të jetë qendra e botës së futbollit. E përsëris, skuadra ime është e gatshme ta luajë këtë raund. Ne do të punojmë që gjërat të jenë të përsosura kur të vijë dita e ndeshjeve

Emilio Butraguenjo

Ky ballafaqim mund të jetë, mund të kishte qenë finalja e Çampionsit për potencialin e të dyja ekipeve. Sidoqoftë, ky është shorti, fati, gjithashtu, luan rolin e vet në kësi rastesh. Ne duhet ta kalojmë me sukses raundin e radhës në Çampions, por besojmë se është pak herët kjo përplasje, sepse të dy jemi kandidatë për titullin. PSZH-ja ka potencial të madh në përbërje, me Nejmar dhe Mbappe, që kanë fituar shumë. Do të luhen dy ndeshje finale. Për publikun do të jetë një duel emocionues. Natyrisht, ne duhet të luajmë në nivelin tonë. Mos harroni se jemi ekipi që e ka fituar Ligën e Kampionëve dy herë rresht dhe e di se duhen përgatitur e përballur ky lloj kompeticioni

DASHI 21. mars - 20. prill

Do futeni ne një faze te re sot ne jetën tuaj ne çift. Marrëdhënia me partnerin do ketë goxha përmirësime. Mundohuni te përfitoni sa te mundni! Për beqaret dita do jete mjaft e favorshme dhe e mbushur me premtime. Do jete gabim i pafalshëm nëse ju nuk përfitoni deri ne maksimum. Do bëni investime te mira te cilat do ua rritin te ardhurat. Do zgjidhni edhe një problem.

DEMI 21. prill - 21. maj

Nëse jeni ne çift partneri do iu surprizoje dhe do ua ndryshoje tërësisht jetën. Ndihmojeni edhe ju me imagjinatën tuaj. Me ne fund do shpëtoni nga rutina! Beqaret do jene ne kërkim te emocioneve te forta dhe drithëruese, por kur t'iu jepet rasti do e keni te vështirë te angazhoheni. Sektori i financave nuk do jete shume i mire por ka mundësi te merrni një kompensim nga një pune e bere.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Mos mendoni se jeta juaj ne çift është e shkëlqyer dhe asgjë nuk mund ta prishe ambientin e krijuar. Tregohuni pak me dyshues dhe do e shihni qe gjerat do shkojnë me mire. Nëse jeni vete, do futeni ne një etape te re me perspektiva te reja. Venusi do iu beje me tërheqës dhe joshës. Marsi do iu nxite te shmangni shpenzimet e mëdha. Nëse do iu duhet te bëni investime bëjini me kujdes.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Për shkak se do flirtoni me shume sesa duhet me dike dhe partneri do iu shohë, do lindin mjaft debate. Kujdes sepse gjerat mund te shkojnë edhe me keq sesa mendoni. Beqaret do e kenë me te vështirë te ndërtojnë një lidhje gjate kësaj dite. Dielli do iu beje te keni një rritje te konsiderueshme te financave, por ju nuk do dini t'i mbani duke shpenzuar pa limit. Kujdes!

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Urani do iu beje me te paduruar sot dhe me humor te keq. Beni kujdes,sepse me shume se kurrë duhet te vendosni bashkëpunimin me partnerin. Beqaret, shume te zënë me punën, familjen dhe aktivitete te tjera nuk do kenë fare energji dhe dëshirë për te filluar një romance. Probleme financiare nuk do keni dhe do e jetoni qetësisht këtë te hënë. Kujdes vetëm me shpenzimet.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Meqë asnjë planet nuk prek drejtpërdrejt lidhjen tuaj, pritet një përmirësim dhe ngrohje e ambientit. Do ndiheni me mire pranë atij qe doni. Disa do bëjnë çmos te largojnë edhe rutinën! Beqaret do kenë shume mundësi për takime dhe tek njeri prej tyre do takoni dashurinë e vërtetë. Përfitoni nga dita e sotme për te blere diçka qe iu ka pëlqyer. Financat do jene te mira.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Persë i përket dashurisë ne çift, ajo nuk do iu mungoje aspak. Partneri juaj do kujdeset mjaft për ju dhe do iu ledhatoje se tepërmi. Beqaret nga ana tjetër do jene paksa te ndikuar negativisht nga influenca e Plutonit. Gjithsesi mos i humbi shpresat sepse pas pak do linde serish dielli. Ekuilibri financiar rrezikon te tronditet mjaft nga Saturni.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Beqaret qe kërkojnë aventura do jene te favorizuar. Mjafton qe ju ta doni te bëni për vete dike dhe ai do shtrihet ne shtratin tuaj. Nëse jeni ne çift, kjo dite nuk do jete dhe aq e qete. Kujdes nga takimet qe do bëni sepse mund te tentoni edhe tradhtitë. Jupiteri do iu sjelle fat ne sektorin financiar dhe do bëni një riorganizim te buxhetit.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ju qe keni një lidhje dhe ndiheni te lumtur për këtë, Plutoni do iu sjelle një fllad romantizmi. Nga ana tjetër, nëse marrëdhënia juaj me partnerin është nuk po shkon si duhet, mund te ketë edhe ndonjë ndarje. Beqaret duhet te përfitojnë nga mundësitë qe do iu jepen për te bere takime. Do njiheni me dike serioz por te mrekullueshëm.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Për shkak te mungesës se ndikimit te planetëve qe sillnin probleme ne jetën tuaj ne çift, pjesa me e madhe prej jush do kalojnë një dite te këndshme. Edhe nëse keni pasur probleme me komunikimin gjerat do te zgjidhen. Ju beqare qe po kërkoni me ngulm ndjenjat e forta do keni fat. Me financat do keni probleme, por pa pasoja te renda.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Lumturi e garantuar ne çift sot. Ata qe kohet e fundit kane pasur zënka duhet te përfitojnë për t'u pajtuar. Ata qe janë lidhur rishtas do jene me te qete. Beqaret fale mbështetjes qe do iu japë Venusi do enden ne një det te ngrohte dashurie. Mos shkoni shume thelle qe tani sepse ka rrezik te mbyteni. Problemet financiare do te zgjidhen një nga një, por e keqja me e madhe është se ju shpenzoni tepër.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Mjedis i sotëm do jete mjaft i përshtatshëm për dashurinë e çifteve. Marrëdhënia me atë qe dashuroni do te përforcohet dhe ndjenjat do jene me te thella. Beqaret do e kuptojnë me mire se jeta është shume e bukur sepse do takojnë personin qe aq shume kishin ëndërruar. Nëse keni probleme me financat gjeni me pare arsyen qe me pas te merrni masat e duhura.



KOHA	GOMË	FLORIRI	TITULL MBRETI NË EGJIPTIN E LASHTË	**KOHA**	SHKRIMTARI YNË, GRAMENO / KALIUMI						
FJALË (BISED.)				QË LIDHET ME KINEN / KRASIT							
QYTET NË IRAK (SULTAN ABAD)					LUMË NË ANGLI / PJESË LIRIKE					GJERMANIA / ORGANIZATA E MUSTAFA NANOS, ... PUBLICA	
SHTET NË AZI						PREFIKS PËR GJËRAT QË LIDHEN ME AVIACIONIN / OFFICE OF NAVAL RESEARCH					
TEMPERATURA		HERO STRIPASH I MAREL COMICS / TETOVA									
REVOLUC.JAPONEZ, HIROBUMI / VENDLINDJA E FUTBOLLISTI NË FOTO				BANORI I INDISË / 500 ROMAK							
S										AUSTRIA	

Mensur Mamuti	FUTB. KOSOVARO - FINLANDEZ NË FOTO / KLUBI I FUTB. NË FOTO	P	LAKMITË, RESAT	LUNDËR E MADHE				
PAGESË NË AFATE, RATË								
KËNGËTARJA JONË, LIBOHOVA								
KRIJUES I VEPRAVE EPIKE								
ÇEKAN I MADH PREJ METALI								
KËNGËTARJA JONË, RITA				SKOCIA E SOTME (EMËRTIMI LATIN I ROMAKËVE)				
KOHA	INUIT TAPIRIIT KANATAMI (ORGANIIZ. KANAD.) / NËNSHTETËSIA E FUTB. NËFOTO							
FERID MURAT / AKTORJA AMERIKANE, FAROU			AUSTRIA / ABDULLAH ZENELI					

ZGJIDHJET: P, KËST, IRMA, EPIK, VARE, ORA, ITK, FM, A, MIHAL, LLAF, KINEZE, ARAK, ALT, D, SIRIA, AERO, T, AJRON MEN, ITO, INDASI, SKËNDERAJ, A.

Sudoku

shumë i lehtë

			1	9	8		3	
	1					5	9	
		4						
1				4				8
5			6		9			1
6				3				9
	9					7		
4	7						1	
			4	6	7			

mesatar

			7					4
		4		1	6	2		3
		8	4		3			
	8	7				4		6
	2						5	
5		6				7	3	
	6		3		5	8		
			1	9		3		
8	1				4			

Shumë i lehtë: 765198432, 318274596, 924356187, 139742658, 542689371, 687531249, 293815764, 476923815, 851467923. **Mesatar:** 631782594, 754916283, 298453617, 187539426, 329647158, 546821739, 962375841, 475198362, 813264975.

FOSHNJAT MUND TA DALLOJNË FRIKËN NË SYTË TUAJ

Foshnjat që shtatë muajshe mund të lexojnë shprehjet njerëzore duke parë beben e syrit të tyre, në të qindtën e një sekonde. Shkencëtarët vendosën elektroda në kokat e 24 bebeve dhe u treguan atyre pamje të syve, për vetëm 50 milisekonda për secilin.

Aktiviteti në trurin e bebeve ndryshonte më shumë si reagim ndaj frikës, se sa lumturisë, që ata mund ta pikasnin për shkak se bebet e syve të të rriturve zmadhoheshin.

Me Trumpin në kokë

Ndoshta ka modelin më të famshëm të flokëve në botë, por që nuk bën pjesë në shijet e shumicës së njerëzve. Megjithatë, një i ri në Tajvan nuk bën pjesë tek shumica. Duke shfrytëzuar talentin e një berberi që "pikturon" imazhe të ndryshime për klientët e tij në pjesën e pasme të kokës, i riu tajvanez arriti që të realizonte ëndrrën duke vendosur portretin e idhullit të tij, Donald Trump.

KUJDES ME KARIKUESIN E IPHONE!

Nëse jeni një përdorues i iPhone, atëherë duhet të kontrolloni karikuesin e celularit tuaj. Një studim ka zbuluar se 98% e karikuesve fals të iPhone janë shkaktarë të masave elektrike apo të zjarreve në shtëpi. Studiuesit u bëjnë thirrje përdoruesve që të bëjnë kujdes dhe të mos përdorin karikuesit fals të iPhone për shkak të rrezikshmërisë së tyre. Hulumtuesit blenë disa karikues dhe zhvilluan testime. Rezultatet e tyre treguan dukshëm se karikuesit jo origjinalë të iPhone kanë potencial për të shkaktuar goditje elektrike vdekjeprurëse. Gjatë testimeve duke shkarkuar rrymë elektrike, më shumë se gjysma e tyre dështuan. Ekzaminimi i pjesëve të brendshme tregoi se komponentët janë të një cilësie të ulët dhe nuk kanë aspak elemente sigurie. Këta karikues fals shiten kudo në dyqane apo në internet. Për këto arsye, përdoruesit e iPhone duhet të bëjnë kujdes kur blejnë karikues të tillë.

PICA NAPOLITANE BËHET PJESË E UNESCO-S

Arti i përgatitjes së picave napolitane shpallet pasuri kulturore botërore e UNESKO-s. Konfirmimi vjen nga autoritetet e Romës. Zyrtarët, theksojnë se biznesi i picerisë gjeneron një shumë të ardhurash prej 12 miliardë eurosh në Itali. Të punësuarit në këtë sektor janë 100 mijë me kohë të plotë dhe 50 mijë me kohët të pjesshme në fundjave. Çdo ditë vetëm në Itali, sipas zyrtarëve italianë përgatiten rreth 5 milionë pica nga 63 mijë piceri, lokale dhe transporti në shtëpi. Organizata e OKB-së në këtë mënyrë ka shpërblyer punën e gjatë të autoriteteve Italiane që nga viti 2009 për përgatitjen e dosjeve për kandidaturën, së bashku me mbështetjen e shoqatës së picajoleve të komunës së Kampanias.

KALENDARI HISTORIK 12 DHJETOR

1408 - Rendi i Dragoit: Rendi i Dragoit për herë të parë është krijuar më 12 dhjetor të vitit 1408 nga Perandori Sigismund dhe pastaj Mbret i Hungarisë dhe gruas së tij Mbretëresha Barbara e Celjes e përcjellë me betejën për posedimin e Bosnjës.

1677 - Ushtria e Brandenburgëve okupon Stetinin.

1791 - Hapet Banka e SHBA.

1800 - Uashington DC përcaktohet kryeqytet i SHBA.

1822 - Meksiko zyrtarisht njihet e pavarur nga SHBA.

1911 - Delhi zëvendëson Kalkutën si kryeqytet i Indisë.

1932 - BRSS dhe Kina rifillojnë marrëdhëniet diplomatike.

1961 - Martin Luther King Jr dhe 700 demonstrues arrestohen në Albeni të Gjorgjisë në SHBA.

1963 - Kenia shpallet e pavarur nga Britania e Madhe.

1991 - Aktori Richard Gere martohet me modelen Cindy Crawford.

A E DINI SE...

Monedha më e përdorur në botë? Padyshim Dollari. Ndiqet nga Euroja, Stërlina Angleze, Juani kinez, dhe Jeni japonez.

Kur ishte fëmijë, Ajnshtajni fliste rrallë. Kur e bënte, fliste shumë ngadalë. E mendonte të gjithë fjalinë në kokë dhe e pëshpëriste para se ta thoshte. Këtë e bëri rregullisht deri në moshën 9-vjeçare.



Prezervativët e parë në botë u prodhuan në vitet 1640, dhe ato bëheshin me zorrët e kafshëve dhe peshqve.

BARSOLETA

PO FLE ME LIBRA

Më tha: Po fle me libër ndoshta e marrë notën 10!
I thash: Fli me profesorin e merr më sigurt!

THËNIA E DITËS

Synimi im është të harroj dhimbjet në jetë.
Harrojini dhimbjet, talluni me to, reduktojini dhe qeshni.
(Jim Carrey)